

INTERVISTË ME ZYRAFETE MURIQI LAJÇIN

Vitomiricë | Data: 22 janar, 2024

Kohëzgjatja: 192 minuta

Të pranishëm:

- Zyrafete Muriqi Lajçi (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e parë

Anita Susuri: Zonja Zyrafete, nëse mundeni me u prezantu, me na tregu diçka për kujtimet e para, për familjen?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Unë jom Zyrafete Lajçi, me mbiemër të vajzërisë Muriqi. Jam e lindur në fshatin Koshutan të Rugovës, ni lagje shumë t'bukur. Familja jeme ka qenë familje e thjeshtë fshatare që kanë jetu me punë. Domethonë, gjithë historia e familjes mundet m'u përshkru me faktin se kanë mbijetu prej krahëve t'vet. Domethonë, si vllazni e gjanë kështu familja jem i takon familjes së patriotëve të Lidhjes së Prizrenit, Kadri Bajri dhe Hysen Bajri. Por ajo vazhdimësi ka zgjatë deri në Luftën e Dytë Botërore edhe ma vonë pastaj. Ku në Luftën e Dytë Botërore, baba jem, edhe pse i ri ka qenë shumë, ka marrë pjesë me ni betejë në Livadh të Gjakut në Smilovicë.

Ma vonë pastaj edhe mas Luftës së Dytë Botërore, meniherë pas lufte, ni rast lidhet me historinë e babës tim, rasti i vrasjes së Hasan Rizës, djalit të Rizë Zymerit që ka qenë shok i ngushtë i babës. Domethonë këto janë si dy momente që m'lidhen me babën prej asaj periudhe. Ma vonë, në historinë e gjanë të familjes kështu osht' dëshmorë Qerim Muriqi që osht' i vllaznisë të familjes tonë. Bash në familjen e ngushtë jemi domethonë njerëz që kemi jetu thjeshtë me punë, familje bujare, mikëpritëse. Osht' njoftë si familje bujare në Rugovë dhe ni familje e madhe. Domethonë kur jemi nda jemi kanë ma shumë se 54 anëtarë (qeshë)...

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për babën, a ju ka tregu ndonjëherë për shembull si ka ndodh ky, kjo pjesëmarrje e tij? A ka pasë ndonjë thirrje apo ai vet ka qenë vullnetar?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, tash mua kur m'ka vdekë baba unë jom konë e vogël, n'klasë t'katërt dhetë vjeç. Por, tregojnë anëtarët e tjerë të familjes, kanë tregu nana edhe mixhallarët ma vonë edhe këta djemtë ma t'rritun t'familjes që kanë nejt ma shumë nëpër oda dhe i dijnë historitë familjare kështu. Po, ai ka qenë pjesëmarrje vullnetare e rugovasve për me mbrojtë kufinin prej Malit të Zi.

Sulmi ka qenë prej brigadave partizane, të ashtuquajtura partizane dhe organizimi ka qenë prej Isa Fazlisë në katunin tonë që osht' ni patriot i njohur që është edhe i përshkruar në histori. Kjo ka qenë pjesëmarrje vullnetare, domethonë, n'luftë. Edhe pse ka qenë t'armatosur edhe t'gatshëm sa herë që

osht' nevoja me dalë, me mbrojtë kufinin kryesisht. Se ashtu nëpër fshatra nuk osht' që ka pasë sulme e beteja, po në vijën kufitare që e ndan Rugovën me Malin e Zi.

Anita Susuri: A ka pasë pastaj pas luftës përndjekje t'babës t'juj?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po kështu konkretisht përndjekje të babës nuk ka pasë deri n'aksionin e mbledhjes t'armëve që ka qenë aksion i Rankoviqit¹. Kur normal sikur n'krejt Rugovën edhe n'fshatin tonë edhe në vllaznin ma të ngusht ia kanë mbledhë edhe krejt armët. Baba u kanë i ri atëherë kur... edhe u kanë pak me probleme shëndetësore po gjyshi që ka qenë gjallë e mixhollarët e ata, domethonë, u dashtë me ble armë me dorëzu. Se qashtu ka qenë, domethonë, presioni jashtëzakonisht i madh prej pushtetit në kohën e Rankoviqit.

Anita Susuri: Çfarë gjenerate ka qenë baba ju?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Baba osht' '29.

Anita Susuri: Më tregut edhe për ni histori të familjes nanës...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, prej nanës historia e familjes osht' shumë e bujshme. Nana jeme rrjedh prej familjes Bralaj. Ata kanë prejardhjen prej Rugoves po jetojnë tash në territorin e Malit të Zi, osht' ni fshat i vogël në komunën e Rozhajës. Por stërgjyshi im e gjyshi kanë qenë kaçak². 30 vjet ata janë detyru me lëshu vendin e vet, kanë dalë në Shqipni.

Bile ni kohë t'gjatë kanë nejt në Tropojë pastaj kanë shku në Murac ku atëherë ka qenë Ahmet Zogu, mbreti i Shqipërisë. Ju ka ofru toka kosovarëve, toka, si me thanë, të djerra, të papërpunuara po që ata vet i kanë punu pastaj i kanë bo toka të bukës. Aty kanë ndërtu shtëpinë dhe kanë nejt disa vite deri në pushtimin e Shqipërisë prej Italisë. Qat' ditë thotë nana bile kur tregojke, 'Kur kanë fluturu aeroplanat italian mbi Shqipërinë ata qat' ditë kanë vendosë edhe janë kthy për Kosovë'.

Daja bile e ka kry shkollën fillore atje, nana u kanë e vogël edhe tezja shumë e vogël, pesë-gjashtë muj sa ka qenë e lindur. Janë kthy për Kosovë. 30 vjet që i kanë bo atje, domethonë, janë kanë kaçak ai gjyshi ka ardhë kanihere me kaçakët në Rugovë e kahdo që u kanë nevoja. Se u kanë pastaj edhe i angazhun në çetën e Bajram Currit. Po familja jo. Domethonë, me vite e vite gjyshja jeme nuk i ka pa familjarët e vet.

¹ Aleksandar Rankoviq (1909-1983) ishte hero partizan serb i cili mori pozitën e Ministrit të Punëve të Brendshme në Jugosllavi dhe ishte udhëheqës i Inteligjencës Ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore. Ai krijoi një sistem terrori në Kosovë, pasi që e konsideronte atë si rrezik për sigurinë e Jugosllavisë nga 1945-1966, kur dhe ai u largua nga Lidhja Komuniste.

² Njësitë të jashtëligjshme, banditë, të njohur edhe në rajone të tjera të Ballkanit si hajduk apo uskok, të konsideruar nga shteti si kriminelë të thjeshtë, por shpeshherë ithtarë të një agjende politike të çlirimit kombëtar.

Tregojke nana, “Kur jom ardhë për herë t’parë...”, se ajo dajhtë vet i ka pasë në Pështirë, tha, “kur shkum ma s’pari atje, dul gjyshja”, e nanës tash, Gala, “kur dul me na tesh”, tha, “dhe i hapi krahët e tha ‘Lumja une kush m’ka ardhë’, na u gzum se menojsim që ktu në Kosovë kërkush nuk flet shqip. Se menojsim na që mbahet me atje, tash po vijmë në Kosovë po hupim”. Qishtu. Domethonë ata pastaj edhe daja u kanë partizan.

Osht’ ni fakt interesant, daja u kanë partizan, mixha i nanës u kanë xhandar, babgjyshi u kanë kaçak. Domethonë prej ni familje... se dajën e kanë marrë e kanë angazhu, ai s’ka mujtë me rezistu se edhe u kanë i ri edhe u kanë e pamundur. Gjyshi ka mbetë m’u kujdesë për familje, kur i kanë sulmu qata partizanët e ashtuqytur me ato brigadat çetnike³, që m’u mshef pas brigadave partizane.

Thojke nana, “S’kem pasë mundësi as me marrë diçka veç”, tha për gjyshin, “shkoj baba i derdhi tinarët me djath e me t’lyn e çka ka pasë, ‘Bile qito mos t’i marrin shkijet e na ku t’shkojmë shkojmë”. Atëherë ata janë ardhë në Kosovë, e kanë pasë hallën e ka pasë nana në Kosovë, në Buqan te Gashanët, te Sefa Beqa. Ka nejt aty ni kohë të gjatë derisa u ba zhvendosja prap diku tjetër e derisa janë kthy atje.

Po vazhdimisht gjatë Luftës së Dytë Botërore, familja e dajve, si me thanë, janë kanë herë diku herë diku, nuk kanë mujtë me zanë vend për arsye se përndjekjen e kanë pasë t’veçantë prej pushtetit. Dajhtë e mi, Bralajt domethonë njihen se për shkak të konfliktit që e kanë pasë me serbët që e kanë pasë afër aty, nantë vet kanë mbetë burgjeve. Dikush ka vdekë, dikush u kanë i dënun shumë gjatë. Kështu domethonë e kanë ni histori të veçantë familjare kështu.

Anita Susuri: E ju thatë që keni qenë dhetë fmi?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po.

Anita Susuri: Prej nanës e babës...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po na kemi qenë dhetë fmi.

Anita Susuri: Qysh keni jetu ju si fmi? Qysh e kujtoni ju atë kohë?

³ Lëvizja serbe e lindur në fillim të Luftës së Dytë Botërore, nën udhëheqjen e Draža Mihailoviqit. Emri i saj rrjedh nga “četa”, bandat guerile anti-osmane. Kjo lëvizje adoptoi një program të Serbisë së Madhe dhe për një periudhë të kufizuar ishte një guerile anti-pushtuese, por më së shumti e angazhuar në bashkëpunim me Gjermaninë naziste, qëllimi i saj kryesor mbetet bashkimi i të gjithë serbëve. Lëvizja ishte përgjegjëse për një strategji terrori kundër joserbëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe u ndalua pas vitit 1945. Mihailoviq u kap, u gjykua dhe u ekzekutua në vitin 1946.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Unë kohën e fëmijërisë edhe pse prindërit sigurisht kanë hjekë keq me na rritë, po e kujtoj si lumturinë ma të madhe. Se na jemi kanë shpi e madhe dhe jemi kanë shumë fmi. Baba i ka pasë tre vllazën, hallat [motrat] i kanë dekë të vogla. Se atëherë thojshin në Rugovë, vakti i ujs. Atëherë gjyshja jeme u mundu sa ka mujt për me mbijetu atë smundje që u kanë. Tash mendoj ndonjë gripi, a gripi spanjoll a çka ka mujt me kanë atëherë...

Anita Susuri: Ndonji fruth a.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Fruth a. Por ato të katërtat i kanë dekë motrat. E këta për m'i shpëtu djemtë pastaj që janë kanë të vegjël, se kanë jetu ni kohë Nabërgjan, te qita të afërmit që i kem pasë të Kadri Bajrit, a din, afër me ta se këta kanë pasë sigurisht naj pjesë të vetën aty. Janë tërhejkë në Rugovë. E në Rugovë e kanë fillu gjithçka prej zeros. Gjyshja me vekë t'u punu, gjyshi normal me lopë e me dhenë e me çkado që ka mujtë edhe këta djemtë masanej janë rritë. Prej katër vllazneve që janë kanë, na jem kanë tanë janë kanë, dikush dhetë fmi, dikush, njani mixhë i ka pasë 13, na krejt kah dhetë. E janë kanë familje e madhe.

Kështu që kur jemi kanë fmi t'vegjël na jemi kanë shumë edhe dita jonë u kanë si bor, si shi, si verë, si dimër gjithmonë jashtë, lojë, argëtim. Kur jemi shku në shkollë jemi kanë shumë edhe u kanë atmosferë me shku deri te shkolla. Domethonë lojë, aheng me shku deri në shkollë edhe pastaj m'u kthye. Domethonë u kanë familje e lumtur edhe pse kushtet në cilat jem rritë na për prindërit patjetër se janë kanë shumë të vështira. Se janë kanë vështirë m'i rritë ni familje, fmitë e ni familje të madhe ashtu qysh jem kanë na...

Anita Susuri: Qysh ka qenë, për shembull, rrethi ku jeni rritë? Ai fshati si ka qenë? Shpija ku jeni rritë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Unë e mbaj mend, si shumë e vogël kur jem dalë n'shpi t're në kullë edhe është ndër kullat e para që osht' punu aty në katun. Kullë e madhe me tetë dhoma, kullë e gurit, si kala u duktë. Po në shpinë e vjetër ku jom le unë u kanë e drunit edhe e maj mend kur jemi bajtë me shku n'shpi t're u kanë emocion i veçantë. Sikur sot më kujtohet me vllaun e me motrat e me ashtu gjanat e fundit që i bajshim prej shpije.

N'kullë u le motra jeme që osht' mas meje, Ajshja, e para dhe u kanë, si me thanë, mirë shumë. Aty, qajo lagja ku jetojmë na Vunishta, nuk ka pasë shumë familje, me thanë nja... se dikur janë nda familjet e mëdha, janë ba ma shumë po janë pesë-gjashtë shpi, kështu të mdhaja. E masanej ato janë nda janë bo tash ma shumë se 30 shpi prej atyne. Po u kanë atmosferë disi e mirë edhe marrëdhانيت mes njerëzve janë kanë shumë të mira.

Si me thanë, në malësi gjithmonë nuk ka jetu kurrë fanatizmi, që u kanë në disa vise tjera ndoshta. Te na edhe gratë edhe burrat disi janë kanë si t'barabartë n'puntë e veta normal. Burrat puntë e veta normal ma të rana kuptohet po gratë janë kujdes për shpi, për fmi. Po si me thanë, raporti mes burrave

dhe grave disi u kanë shumë i çiltër. Këshillat për puntë e grave burrat i kanë marrë te gratë. Qishtu ka funksionu. Domethonë u kanë jetë e organizune si nifar' mini shteti në familje.

Anita Susuri: A keni qenë n'bashkësi edhe...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po na jem kanë n'bashkësi derisa ka dekë baba jem. Kur jemi da... se unë shtatë klasë të shkollës fillore i kom kry në Rugovë. Bile motrën e kom pasë msuse. Në klasën e tetë kur jom shpërngulë prej Rugovës, se kemi ble tokë se u kanë e pamundur ma me zhvillu jetën në Rugovë për shkak t'shkollës, kushteve tjera, shtëpive t'shëndetit që kanë mungu. Atëherë jemi da kur jemi ra në rrafsh këndeje në Graboc. Domethonë sa i përket fëmijërisë krejt çka e kujtoj nga fëmijëria m'doket e mirë, përveçse kur m'ka dekë baba pastaj u kanë pak ma ndryshe normal.

Anita Susuri: I sati fmi jeni ju me radhë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Unë jom e gjashta. I kom tri motra ma të mëdha edhe dy vllazën. Jom gjashtë vjet mas vëllaut. U kanë kështu, qysh m'tregojshin, këta ma t'mdhajt motrat e vllaznit edhe nana bash e përmenke shumë gzim kur jom le unë se gjashtë vjet mas vllaut. Ni javë para se me le unë ish konë pas dekë gjyshja. Lindja jeme nifar' mënyre u kanë nifar' përtrirje e familjes, u kanë nifar' gzimi kështu i veçantë.

Anita Susuri: A kanë qenë edhe këta ma t'mdhej se ju t'shkollun?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Motra e madhe, motra jem e treta me radhë se dy motrat e mdhaja s'i kanë çu n'shkollë atëherë se nuk i kanë çu kërkush n'katun çikat n'shkollë atëherë edhe baba s'ka mujtë me marrë vendim m'i çu vet i pari. Motra e tretë osht' e para vajzë e shkollune e katunit tonë. Qatyne që kemi jetu në Rugovë. Se Rugova s'ka që janë shpërngulë ma herët në Pejë e kështu në fshatra të Rrafshit të Dukagjinit shumë po prej atyne që kanë jetu në Rugovë, motra jem osht' e para që e ka kry Shkollën Normale atëherë edhe u bo msuse. U kthy në fshat aty ka punu derisa osht' mbyllë shkolla se s'ka pasë fmi ma, ka punu aty në fshat. Edhe vllaznit para meje ka Fakultetin e Maqinerisë, në fakt Shkollën e Naltë të Maqinerisë në Mitrovicë dhe djali i axhës Fakultetin Ekonomik. Pastaj unë, motrat tjera qishtu.

Anita Susuri: E kur keni, domethonë, kur jeni shkollu në shkollë fillore e kom fjalën ende, kur ka qenë ajo bashkësia. A keni pasë edhe ju si fmi punë t'caktune që keni kry n'shpi?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, po kem pasë edhe na. Na i kem pasë detyrat tona secili. Unë për veti po thom se e kom pasë shumë shok babën. Motra e madhe kur... se dy motrat i kom të martune për dy vllazën edhe janë martu për ni ditë. Masi janë martu ato, nja tri vjet mas martesës tyne ka pasë vdekë baba. Po po du me thanë qit' pjesën masi janë martu ato, kjo e treta u kanë në normale. Unë nifar'

mënyre e kom pasë detyrë m'i pru babës ujë të freskët prej gurrës. Ndër detyrat kryesore që i mbaj mend si fmi e kom pasë qita me bajt ujë.

Po na edhe ju kem ndihmu kur kanë pasë me korr ose me mbledhë sanë. Se atëherë kanë mbjell elb në Rugovë edhe këto gratë e kanë pasë me korr elbin na gratë me bajtë kajzit. Edhe kur kanë mbledhë sanë, fijet që kanë mbetë prej asaj sanës t'madhe që e kanë marrë t'rritunit, na fmija e kem pasë për detyrë me mbledhë. Rrallë jemi shku për boronica, për kaça kah pak se i kemi pasë boronicat larg. E kështu. Po ma shumë djemtë, djemtë kanë pasë detyra. Ata u dashtë m'u kujdesë për gja kështu. Na vajzat ma pak. Edhe unë pak ma pak (qeshë).

Anita Susuri: E shkollën qysh e kujtoni? A ka qenë shkolla...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Shkolla në Koshutan u kanë shkollë e vogël, u kanë paralele e ndame e Shkollës "Përparimi" në Drelaj, atëherë "Përparimi". U kanë shkollë me katër klasa, pesë klasa kur janë bo u kanë fitore e madhe se atëherë u kanë sistemi kështu katër vjeçar, katër plus katër. Prej t'pestës masanej janë shku në Drelaj. Për shembull, vllau jem u shku në Drelaj edhe bile shpesh herë ju ka dashtë me udhëtu n'kushte shumë t'vështira se në mot kështu t'egër dimrit, si me shi, si me erë edhe vetëm kaniherë.

Se ata shoktë që i ka pasë prej pjesës tjetër t'katunit janë kanë larg e shpesh herë besa edhe me frikë se edhe prej shtazve t'egra kështu. Unë kom pasë fat ken' ba nxanësit e kom kry deri të shtatën aty në Koshutan. Shkolla u kanë shumë e vjetër. Bile m'kujtohen ato drrasa t'zeza që lëvizshin, e bankat e drunit aty ato banka ashtu klasike të drunit. Po paralalejt janë kanë t'bashkune e para me të tretën, e dyta me të katërten. Se nuk ka pasë nxanës për me kanë ni klasë e plotë a s'po di pse. M'doket atëherë jem kanë fmi boll, s'o sikur sot që s'po ka po qashtu janë kanë klasët e kombinune.

Vishin edhe prej ni fshatit, fshatit Shkrel për me kry të pestën, të gjashtën edhe të shtatën që ka pasë mundësi për mos me shku në Drelaj se u kanë shumë larg. Ose ata, për shembull, mos me shku në Haxhaj. Ka pasë ndonjë edhe prej Pepajve, prej katunit tash unë jetoj, kanë ardhë qaty te shkolla jonë. Se e kanë pasë edhe ata larg me shku në Drelaj. E kështu vishin nxanësit prej shkollave tjera u bojke klasa edhe funksionojke. Po mos me pa pasë u dashtë me shku në Drelaj që u kanë shumë larg, ma shumë se ni orë n'kamë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe n'familje te ju, a keni pasë ndonjë traditë ose ndonjë festë t'veçantë që e keni festu? Qysh i keni festu?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, këto festat, festat janë kanë festat që janë festu rregullisht. Për shembull, Shëngjergji me ato traditat m'i nxjerrë çilimat jashtë e me pastru e me qit' pshesh e tamël me mëngjes e m'ju qit' djath bubrrecave. Shumë, domethonë, zakone që menoj që janë kanë pagane. Se nana u

kanë baqic⁴ edhe kryesisht nana i ka respektu këto; Bajrami, Ramazani. Edhe pse për qat' kohën kur jom kanë unë fmi, Ramazani fort nuk osht' respektu, e Bajrami po.

Se bajrami si festë kështu e ka pasë edhe atë gjallërinë e vet. Ni ditë shkojshin burrat, ni ditë gratë, na fmija. M'u veshë me tesha t'mira me shku deri te shtëpia e fundit n'katun atje naltë. U kanë festë e veçantë. E mirë, për shembull, i kujtoj këto si ngjarje të veçanta qito festat e katunit se edhe katunarët kanë pasë mundësi m'u pa me njoni tjetrin e me pushu besa pak prej punëve t'rana. Domethonë e kanë pritë nashti edhe ata me padurim m'u pa me njani tjetrin me kangë e valle. Valle nashti ma pak për festa po kangë po se po.

Anita Susuri: E a ka ekzistuar kjo Darka e Lamës? Se po m'doket kah ana e...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po bash kështu Darka e Lamës veç nëpër familje se tash te na n'familjen tonë këta kusherit që kanë jetu n'rrafsh e kanë pasë bjeshken ma naltë se fshati jonë. Ni javë në të dalun edhe ni javë në të zhdjergun, gjithmonë kanë nejt kah ni javë te na. Aty për shembull osht' bo atmosfera shumë e mirë. Se këta burrat dikur edhe me kështu me kapuqa me cic mic e me nejta e me kangë e. Se unë thashë në fillim të intervistës babën e kom pasë lahutar, po unë nuk e mbaj mend t'u i ra lahutës. Se kur unë jom bo me mbajtë mend baba veç u kanë i smutë e nuk ka mujtë ma m'i ra as lahutës as fyllit që i ka ra shumë mirë.

Fyllit e mbaj mend kah pak se n'fyll nuk ka pasë shumë, ka pasë nevojë m'i dhanë frymë po pak ma lehtë nashti u kanë sesa m'i ra lahutës. E kështu t'u knu me za e maj mend kah pak, a din, veç me za kështu për qef ndonjëherë. Po jo ashtu me knu në odë t'burrave si janë kanë këto nejat e mbledhitë e burrave se ma nuk e ka leju shëndeti. E n'familje gati secili prej anëtarëve t'familjes ka ditë m'i ra çiftelisë e fyllit e me knue. E sot e kësaj dite këta djemtë e familjes tonë kur mblidhen për vit t'ri e festa vazhdojnë qat' traditë.

Anita Susuri: E kështu për veshje deshta me ju pytë, a ka pasë nana juj veshje?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Nana jem veç n'luftë e ka hjekë veshjen kombëtare se thuja derisa u kanë gjallë kurrë s'e ka hjekë. Gjithmonë i ka majtë vnut pshtjellakët. E kanë punu vet veshjen, po jo gjitha pjesët e veshjes. Se veshjet e Rugovës kanë pjesë karakteristike t'cilat nuk mundet m'i punu çdo gru. Unë si studente kom maru veshje të Rugovës, kom bo veshjen e nuseve.

Motra që osht' lahutare, Ajshja, edhe ajo bon ka bo disa prej pjesëve të veshjes po edhe që osht' lahutare ajo i kushton rëndësi t'veçantë veshjes kombëtare. E mban kështu me xhelozë t'madhe, e man nëpër, edhe kështu nëpër tubime kudo që ka mundësi m'u shfaqë me lahutë e me çifteli e me kanë e kudo që osht' po edhe nëpër festivale. Prej Gjirokastres e në Ohër e Paris kudo që ka qenë në festivale, me xhelozë të jashtëzakonshme e prezenton veshjen kombëtare.

⁴ Zonjë e shtëpisë, që merret me punët kryesore të një shtëpie, gatuan.

Anita Susuri: E këto që po thuni s'munet me bo çdo grua, a osht' ndonjë qendisje e veçantë a çka?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po ka edhe qendisje t'veçantë edhe spiku osht' ni prej atyne elementeve t'cilat bohen kracat e veshjes së Rugovës edhe për shembull llaku i mram që nuk munet me bo gjithkush. Ajo bohet me ni teknikë të veçantë. Unë e kom pasë intervistë vet ashtu për qef ni gru të katunit aty që ka bo veshje kombëtare, ajo ka vdekë mas lufte. Po mu m'u kanë djegë tona ato shkrimet para lufte, domethonë edhe intervista me to. Osht' nifar' teknike e veçantë që bohet me kalema n'buri. Po tash nuk e di kush e bon në Rugovë me t'thanë të drejtën... e bojnë, ka plot gra që i bajnë spikët po nuk osht' që e kom pa ndonjanen t'u i bo veçanërisht.

Anita Susuri: E çka janë këto për shembull...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po buria osht' nifar' mjeti i drunit si në formë tinari po ma i vogël shumë. Sikur buria e ujit që u kanë. Lidhen ata kalamat janë nifar' pjesët e drurit në të cilët pshtjellet peni edhe shkojnë ato t'u u gjujt njana me tjetrën edhe t'u u lidh, t'u u bo bistek ajo. Bohet bisteki shumë i fortë me kusht që kur t'kepet me kanë e qëndrueshme ajo pjesa edhe me dalë edhe ma estetike. Është ni teknikë shumë e veçantë edhe kisha pasë dëshirë shumë m'u xhiru dikush t'u punu edhe m'u rujtë si teknikë se nashta sot ka teknika moderne po duhet m'u rujtë ajo tradicionale që ka qenë.

Anita Susuri: A ka ende shumë gra që e bojnë qat' punë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Për qat' teknikë nuk e di kush e bon edhe s'besoj që ka shumë. E kështu me ba veshje kombëtare ka plot gra që e bajnë nëpër Rugovë. Po si me thanë po e modernizojnë edhe mënyrën e punimit e po del imitim i veshjes kombëtare. Nuk po del ajo veshja origjinale, ajo që ka qenë tradicionale që u ba gjithmonë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë, e përmendet edhe babën që ka qenë smutë, çfarë smundje ka pasë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Smundje t'zembrës. Ka pasë problem t'lindur.

Anita Susuri: Sa po i bjen? Nuk ka qenë edhe shumë në moshë kur ka...

Zyrafete Muriqi Lajçi: 54 vjeç.

Anita Susuri: 54.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Ka vdekë i ri.

Anita Susuri: A e kujtoni pastaj qat' ndryshimin e mënyrës t'jetës t'juj pasi ka ndrru jetë baba? Se thatë edhe shpinë e keni ndrru.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po e kujtoj shumë. Se na masi ka dekë baba ka hi motra n'punë edhe qat' herë u nda familja e madhe. Tash megjithëse edhe mas dekës t'babës na ka përcjellë diqysh fati me pasë vdekje n'familje, grua e axhës, motra jem, do fmi t'axhës, a din, qysh me thanë, e kem pasë ni pjesë shumë t'zymtë t'jetës për nja dy-tri vjet na ka përcjellë veç qajo zymtësia e vdekjeve. Po nifar' mënyrë motra hini n'punë vllau madh pat' shku ushtar, vllau vogël student. Na u mbledhëm disi rreth nanës.

E fakti, si me thanë, ai elementi i parë për të cilin u deshtë na me u zhvendosë u kanë shkollimi jem. Se tash na tokën e kishim ble kështu në rrafsh edhe e kishim atë pjesën që na takojke shpija e vjetër që u ble me tokë. Po nana pritojke shumë me lanë Rugovën se thojke, "Qysh dojmë me jetu na n'rrafsh e na jena msu me jetu me gja", e kështu. Po vllau edhe motra ma e madhe, se vllau madh ish ushtar, edhe motrat e martune kanë ndiku po ma shumë këta që ishin n'shpi. Thojshin, 'S'bon çikës me ia hupë shkollën'.

Me shku në Drelaj vetëm ni vajzë ish shumë larg. Ni orë rrugë me ba, ndonjëherë ishe me dikon po ti nuk munësh me ditë për çdo ditë a të shoqëron dikush me shku n'shkollë. E prej familjes, djali axhës, dy djemtë e axhallarëve me t'cilët kam qenë në klasë edhe ata u patën shpërngulë në Pejë edhe m'bike mos me pasë me kond me shku n'shkollë. U dufke me ndrru vendbanimin për shkak të shkollimit. Qajo domethonë u konë arsyeja e parë.

Atëherë kur kem ra këndej në rrafsh mënyra e jetesës u kanë krejt ndryshe. Nga jetesa kështu, si me thanë, me të ardhura prej blegtorisë edhe normal na me rrogë të motrës, bile, po thom, kemi jetu ma mirë se familjart tjerë të familjes t'gjanë prej t'cilëve jemi nda. Se rroga e msusit atëherë u kanë rrogë e madhe. Po u deshtë me u msu me jetu tash prej tokës me bujqësi. Po u përshtatëm, domethonë, u përshtatëm shumë lehtë. E punojshim tokën, erdh vllau prej ushtrisë.

Vllau tjetër e ndërpreu, e ka pasë andërr me kry Fakultetin e Maqinerisë po u mjaftu me shkollën e naltë që e pat' kry në Mitrovicë dhe hin n'punë në "Zastavë". E kish rrogën e mirë, rroga e inxhinierit atëherë u kanë rrogë e mirë shumë. U ngjallëm diqysh ekonomikisht edhe fillum me ata hapat e parë t'ni jete, me thanë, minimaliste po mos me hjekë keq shumë.

Anita Susuri: Zonja Zyrafete m'tregut ndërkohë që keni ndrru shkollën, jeni shku me ni shkollë ma t'madhe me vazhdu arsimimin, qysh ka qenë ndryshimi?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Ndryshimi u kanë bukur i madh me kalu prej ni shkolle e ni fshati ku krejt janë kanë kushter edhe familje thujse na tre jemi kanë prej ni shpije ni klasë. Ni shkollë t'madhe me, për shembull, me nxanës të fshatrave të ndryshme po edhe komuniteteve të ndryshme. Për shembull

ballafaqimi jem i parë me pa kështu, a din, ni shkollë me mësim në dy gjuhë u kanë goxha interesant. Nifar' mënyre ajo fryma garuese mes nxanësve të dy komuniteteve u kanë shumë e theksune.

Tash unë për vete si nxanëse jom dallu edhe n'shkollë. Po e kom pasë nashta fillimisht nifar' treme a muj tash m'u dallu ktu n'shkollën e madhe. Ku klasa u kanë për shembull me ma shumë se 30 nxanës. Po me t'vërtetë jom rehatu meniherë edhe aty se mësimdhënësit e kanë vërejt nifar' mënyre përkushtimin tem për mësim. Po e veçanta u kanë kah fundi nashta i klasës të tetë se atëherë me tetë klasë e kryshim shkollën. Kur dojshin m'i lshu dëftesat tash ajo gara mes nxanësve që këta që po e thom të dy komuniteteve, kush me marrë epitetin e nxanësit ma t'mirë.

Deri vonë pak e kom pasë kompleks pse mu m'u ka pasë dhanë nifar' diplome që u jepke atëhere prej nifar' diplome n'krejt Jugosllavinë m'doket osht' dhanë. Me marrë ni diplomë që nuk u jep, për shembull, prej institucionit të Kosovës po ajo historia pas asaj diplome kish qenë shumë e madhe, dëftesë atëherë që u kanë. Se pse mos me marrë ni nxanës serb që po ashtu edhe ai u kanë nxanës i mirë po me marrë unë.

Po këta arsimtarët shqiptarë janë kanë tepër t'vendosun edhe me çdo kusht kanë bo ç'mos që përderisa unë e kom meritë, se atëherë sukseksi u kanë shembullor, a din, edhe shkëlqyeshëm po edhe shembullor. Me pesëshe n'dëftesë prej klasës t'parë pse mos me marrë une. E këto i kom marrë vesh krejt ma vonë, nashti edhe masi jom lëshu prej burgut që u bo histori n'shkolla jo kush me marrë atë vlerësimin si nxanësi ma i mirë i shkollës. Ni shkollë me shumë nxanës, tash po harroj, veç për besë ka pasë shumë.

Anita Susuri: Po qatë deshta me t'pytë a ka qenë si gjysë-gjysë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po si gjysë-gjysë, menoj si gjysë-gjysë se na nxanësit shqiptarë që kem shku aty jem kanë prej shumë fshatrave e te msimi n'gjuhën serbe, serbo-kroate atëherë i kem thanë, janë kanë edhe nxanësit boshnjak. Aty ka pasë edhe boshnjak edhe serb edhe malazez. Se s'e di a ka pasë naj dallim serb malazez për atë kohë, për neve janë kanë krejt njejtë. Po si gjysë-gjysë menoj që janë kanë. Se nashta u kanë edhe far' kriteri, s'po di.

Anita Susuri: Si osht' qujtë shkolla?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Valla "Janko Joviqeviç" në Grozhdevc. Atëherë edhe Grozhdevci si komunitet u kanë fshat me shumë serb e na kem shku aty. Domethonë prej Grabocit e fshatrave tjera, Poqestë e Kërstovc e Llozhan e plot fshatra. Plot fshatrave shqiptare që kem pasë shumë ma larg. Ata shkolla u kanë aty brenda fshatit ku komuniteti i tyre kanë pasë rehatinë me pasë shkollën afër.

Po çka osht' interesant se kur jom kanë në klasë tetë qatëherë kanë shpërthy demonstratat e '81-tes edhe tash unë i kom pasë n'klasë do vajza që kanë pasë vllazën e motra studente. Unë e kom pasë

djalin e axhës student në Prishtinë edhe vllau u kanë student në Mitrovicë. Por, ajo vala e madhe e demonstratave që u kanë u kanë në Prishtinë. Informatat e para që i kemi marrë na na kanë ardhë prej qityne studentëve të Prishtinës. Qikjo domethonë m’lidh pak ma shumë me qat’ klasën që e kom kry pastaj në Grozhdevc se disi ma kujton gjithmonë edhe ‘81-ten edhe shoqërimin me këta nxanës që kanë pasë lidhje me dikond që kanë pasë lidhje me këta të ‘81-tes...

Anita Susuri: A ju kujtohet ma saktësisht qysh kanë qenë qato ditë të demonstratave të ‘81-tes?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po m’kujtohet se na në familjen tonë televizori u kqyrë rregullisht domethonë. Megjithëse programi u kanë pas orarit t’punës, t’punve t’ditës po na e kemi kqyrë gjithmonë televizorin e Shqipnisë. Televizioni shqiptarë atëherë te mixha që e ka pasë shpijen pak nifar’ pozite ma t’favorshme ku e kapke ma shumë, domethonë, kurrë nuk u ndrru prej TVSH-së. Domethonë janë konë ato dramat e filmat shqiptarë që shkojshim u bojshim si n’teatër.

Televizori aty n’qosh t’dhomës n’odë atje e na krejt familja, familje e madhe derisa u kryke drama ose filmi nuk u nijke zani. Domethonë janë konë ato mramjet e bukura kur i kqyrshim edhe programet muzikore, lajmet e t’gjitha. Po tash kur patën fillu kto fjalimet e Enver Hoxhës për demonstratat e ‘81-tes ajo domethonë u konë si me detyrim me shku m’i pa na lajmet. E informacionin kryesor si me thanë për këto na e kem marrë qashtu, prej televizionit shqiptarë edhe prej lajmeve po edhe prej fjalimeve të Enver Hoxhës.

Këto informatat tjera prej qityne studentëve që vishin prej Prishtinës. Se tash djali i axhës që u kanë student i ekonomikut, Shabani, ai do ditë nuk mujke me shku në Prishtinë se u ba ora policore, u ndërpre rruga. Domethonë, i patën hupë edhe provimet për shembull po n’demonstratë e pat’ nxan puna me kanë në shpi, nuk pat’ arritë me kanë n’demonstratë. Po masanej kur filloj me shku tregojke për shokë e shoqe që i ka njoftë. Besa edhe për këta që janë burgosë.

Masnej burgosja e Ali Lajçit u kanë si me thanë ajo pika kryesore për t’cilën jemi lidhë na masanej. Se edhe i Rugovës edhe i njofshëm edhe masanej Riza Dema, e Sylë Mujaj e këta t’burgosurit e Rugovës. Edhe bisedat kryesisht edhe me të afërm edhe me rrethin e gjanë familjar janë kanë kryesisht rreth ktyne burgosjeve, rreth ktyne demonstratave.

Anita Susuri: E a keni marrë pjesë ju? A ka ndodhë ndonjë demonstratë aty?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Unë jom konë e vogël atëherë, për klasë tetë jo e dikur ni vjetorin e demonstratave si nxanëse e gjimnazit po. Atëherë organizojshim na me shoqni n’gjimnaz, atëherë po. Po sa i përket klasës tetë jo. Përveç i kishim qito biseda me shokë e me shoqe, “Çka osht’ t’u ndodhë? A e njuh dikond? Kush u ra n’burg? Kush u arrestu? A kanë dënu a s’kanë dënu?” Këto.

Edhe me motra që u kanë msuse kjo u kanë tepër e kujdesshme për me përcjellë informacionet a din krejt me ditë çka osht' t'u ndodhë. Lajmet bile sidomos kur janë kanë këto gjykimet e t'burgosurve politik i kem pasë kështu edhe me pre faqen n'gazetë e me rujtë ata. U kanë kështu tamon arkivi i gazetave të dënimeve politike.

Anita Susuri: Domethonë kjo ka qenë edhe si me thanë fillimi kur ju veç keni kuptu që ekzistojnë grupe?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po po si me thanë, une prej rrëfimeve të familjareve në përgjithësi prej mixhallarëve edhe t'nanës për grupet kaçake nuk osht' edhe që nuk e kem ditë që ka grupe t'organizune t'burgosun me dënim t'gjatë. E kem ditë që janë këta t'burgosurit e Rugovës në Goli Otok Sylë Mehmeti e të tjerët domethonë edhe kaçakët e Rugovës që janë përmend e janë knu kangë.

Se djemtë e axhës që janë kanë rapsod ata veç qato kangë i kanë knu. Si me thanë, informacioni nuk u kanë a din i mangët në këtë kuptim. Po sa i përket rrjedhjes së '81-tes edhe demonstratave u kanë qajo. Se kështu asaj rrjedhshmërisë së përgjithshme kom pasë informacione vazhdimisht se vazhdimisht n'familje osht' folë.

Anita Susuri: Po de edhe jeni rritë n'qat' frymë.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Jom rritë n'qat' frymë.

Pjesa e dytë

Anita Susuri: Sa i përket shkollës t'mesme po m'doket e keni vazhdu në Pejë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, shkollën e mesme e kom vazhdu në Pejë në gjimnaz. Atëherë gjimnazi u kanë i ndam me dy plus dy. Dy vjet gjimnaz i përgjithshëm e dy vjet i profilizun. Dy vjet e para domethonë i kom kry qashtu domethonë në gjimnaz të përgjithshëm. E tashti te gjimnazi karakteristikë kryesore që e kom për me kujtu edhe me përmend osht' profesoresha e gjuhës shqipe, Shege Kelmendi. Që u kanë edhe frymëzim i jemi edhe profesoreshë e veçantë e gjuhës shqipe që përmes rreshtave gjithmonë na ka mësu.

Për shembull na e kem pasë lektyrë 'Kunorën e Maleve' po përtej asaj ajo ka arritë me na tregu që përveç kunorës t'maleve osht' edhe 'Lahuta e Malsisë'. Edhe kujdestari i klasës, Fuad Miftari, që osht' i familjes të Emrush Miftarit që osht' ni patriot i Luftës së Dytë Botërore. E edhe arsimtarët e tjerë po këta dy i kisha veçu që janë kanë shumë të kujdesshëm për neve për mos me ra nashti në situata kur mujmë nashti m'u përcjellë prej njerëzve që na përcjellin si anëtarë të veçantë në familje të caktune edhe mos me ra për pak n'burg. Po nëse bojmë diçka me bo diçka pak ma shumë e mos me ra për dy shkronja,

“Kosova Republikë” e kështu për gjana t’vogla. Janë kanë shumë t’mirësjellshëm edhe shumë t’kujdesshëm me neve.

Anita Susuri: E ju a keni udhëtu gjatë shkollës t’mesme apo si?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, kom udhëtu me autobus. Shpesh herë besa se autobusi u mushke shumë me nxanës e ndonjëherë edhe në kamë jom dalë prej Grabocit në gjimnaz. Ora e parë nashti ndonjëherë osht’ shku. Bile na se edhe me shoqen e grupit që e kom t’grupit t’idealit, Safete Krasniqin, jom kanë në klasë n’vit t’parë edhe n’vit t’dytë.

Ajo prej Leshanit kur vijke kanihere vonë e dikush nuk ish i mirëkuptueshëm prej mësimdhënësve po ajo u kanë si tip kryengritës tana herët. Gjithmonë reagojke. Thojke, “Me çka me ardhë, shkijet⁵ me dashtë na organizojnë ma mirë”. Gjithmonë reagojke në këto situata kur nuk e arsyetojshin mungesat, për shembull, kur nuk ish faji jonë kur u vonojshim për mësim ose mungojshim në orë t’para.

Anita Susuri: Ju m’tregut domethonë që kjo ka qenë veç hapi i parë që keni fillu me u bo në grupe...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po.

Anita Susuri: Qysh ka shku krejt kjo edhe kush fillimisht ju ka organizu?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Unë jom organizu në grup ma vonë në vitin e tretë. Po n’vitin e parë edhe n’vitin e dytë veç kem bo qishtu aksione simbolike. Unë e kom pasë n’klasë ni djalë, Enver Saliq, që e ka pasë vllaun të burgosun politik Naser Saliqin edhe si me thanë jom kanë e informune mirë për fatin e familjeve t’cilat e kanë dikond n’burg. Na tash për... në rastin e 28 nëntorit, në rastin e përvjetorit të demonstratave nëse kurgjo nuk kem arritë me ba bile jem vesh kuq e zi e jem dalë nëpër oborr.

Kem knu kangë patriotike edhe e kem pasë kështu me ble libra që menojsim na që janë ma të ndalune. Po ato libra të ndalune s’ke pasë ku m’i gjetë m’i ble po bile s’paku naj libër t’naj autori që u kanë ma karakteristik edhe i këmbejsim. Atëherë kom pasë dëgju për librin ‘Gjarpërinjtë e Gjakut’ edhe pse nuk kom pasë arritë atëherë me lexu se s’kom arritë me gjetë. Po libra të tilla si ‘Shote Galica’, ‘Mic Sokoli’ e qishtu që i merrshin nxanësit prej njani tjetrit ose te fmailjarët edhe i këmbejsim.

Qikjo u kanë deri në vitin e tretë, mundësia e vetme për... po edhe kasetat, se harrova edhe këta. Kasetat e radios, kasetat me kangë të Fatime Sokolit, kanga e demonstratave, qito m’i këmby, m’i knu, m’i shkru, m’i përshkru nëpër fletore. Me shkru fjalë kështu aforizma që kanë karakter patriotik. Domethonë qito janë konë ato, si me thanë, aksionet simbolike deri në vitin e tretë kur pastaj jom njoftu me [Have Shalën](#) edhe kem fillu ni veprimtari kështu edhe ma të ngjeshun edhe ma të strukturune.

⁵ *Shka* (m.), *shkinë* (f.), shumë *shkijet*, term derogativ që shqiptarët e përdorin për serbët.

Anita Susuri: M’thatë që në vitin e tretë ka fillu angazhimi ju j ma serioz...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po.

Anita Susuri: Qysh ka arritë deri këtu?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po tash në gjimnaz vazhdimisht ka pasë grupe të nxanësve të organizun në veprimtari ilegale. Para neve kanë qenë t’burgosun disa grupe edhe pastaj grupi jonë dhe pas neve prapë. Domethonë në vazhdimësi po edhe ma herët domethonë personalitete që kanë dalë prej gjimnazit kanë dhanë ni kontribut në lëvizjen kombëtare në vazhdimësi. Po unë po flas për qita që i kom pasë, a din, ma afër n’kohë.

Domethonë grupi që osht’ dënu para neve, grupi i Shkelzen Muriqit e Gjemë Lajçit. Shkelzenin që e kom edhe kushter të afërm. Edhe vllaun e tij që ka qenë ma herët i burgosun politik, Ali Muriqi, profesor i universitetit. Kom vepru edhe masanej me ta, edhe masi jom liru prej burgut. Po domethonë u kanë frymëzim për neve atëherë se po burgosen njerëzit shqiptarë edhe nuk p’e ngrit zanin kërkush. Qashtu kem vendosë me Havën jemi afër kështu në saje t’qityne preferencave atdhetare ma shumë.

Se Hava ka ardhë n’klasë te na masi u kanë qikjo pjesa e gjimnazit e profilizune. Jem kanë drejtim matematikor. Dhe n’fillim domethonë jem fillu pak prej asaj se kemi qenë nxanëse t’mira te dyjat, me Havën edhe me të tjerat, edhe me Zogën. E kom rujtë shoqinë pastaj edhe me Safetin që s’e kom pasë n’klasë edhe me Hidajetin. Por, me Havën kështu pak ma detajisht.

Ajo gjithmonë ka knu, knojke kangë patriotike. E çelke xhamin e dritarës e kem pasë klasën në kat të tretë edhe kur ish pushimi i gjatë nuk dilke në pushim po e çilke xhamin e dritarës, u ulke në dritare e knojke kangën e demonstratave të Fatime Sokolit. Qashtu domethonë na u ka kriju ai besimi te njana-tjetra që meqenëse po ndodhin këto gjana që po ndodhin edhe ajo me atë përgatitjen e vet paraprake që ka pasë prej familjes e kështu në përgjithësi, “Osht’ mirë me ba diçka”, “Çka mujna me ba?” “Me shkru”.

Shkrujshim pamflete edhe me ndiku te nxanësit që kishim përreth me thanë që qikjo që po ndodhë nuk o’ mirë, që i burgosën nxanësit e kërkush nuk po reagon. Nuk po reagojnë, për shembull, as profesorat. Na u duke që ata ma t’pjekun, na u duke që ata duhet me reagu ma shumë. Patëm vendosë me shkru niherë e kem shkru kështu pamflete ma t’shkurta ose si parulla edhe me i shpërnda nëpër gjimnaz.

Kjo me kusht që nxanësit e gjimnazit m’u informu që osht’ t’u ndodhë diçka e mos me shku n’heshtje burgosjet e djemve e t’vajzave t’reja dhe mos me marrë vesh kërkush. S’paku ni reagim mrena shkollës ku ata janë nxanës. Kështu shkrujshim tekste, i kombinojshim bashkë. Pastaj, patëm vendosë, se kjo u

kanë kah fundi i vitit të tretë. Kur i bojshim hartimet na n'shkollë për shembull na imponojke me shkru ni rresht diqysh për Jugosllavi, për Titën, për vetëqeverisje. Gja që ajo neve na munojke edhe në arsye tjera...

Për shembull, landën e historisë na msojshim, e kem pasë si kusht, bile këta n'vit t'dytë e kem pasë si kusht me msu si skriptë po thom atëherë që na u shpërndajke, me mësu përmensh biografinë e Titës. S'mujsh me marrë pesë pa e ditë ata. Tash nëse ti ishe nxanës i mirë edhe pretendoshe me i pasë notat e mira me marrë pesë u dufke me thanë si bilbil biografinë e Titës niherë masanej me u pytë për njësitë tjera mësimore që ishin.

Ashtu historia ka pasë shumë informacione t'varfura për historinë e popullit shqiptarë. Se tash librat ekzistojnë patjetër, ne mundemi me gjetë edhe m'i kqyrë. E bile, mbetë merak që s'e përmenda pare, n'vit t'parë kur jom kanë profesorin Rexhep Podrima, masi ra fjala te historia. Ai u kanë profesor i vjetër edhe shumë patriot i madh. Ai gjithmonë na ka shpjegu neve historinë ilire. Vike vike me histori deri te Lidhja e Prizrenit e dikur kah pak edhe atë pjesën e historisë që e kishin për obligim për me shpjegu në program mësimor.

Për vit t'dytë që deshta me thanë që e kem pasë qishtu t'obligushme historinë e, edhe historinë e gjimnazit. E tash vitin e tretë kur arritëm na ish përvjetori i gjimnazit 70 vjetori, qishtu diçka u kanë. Kish marrë vendim drejtorja e shkollës, drejtori u kanë serb atëherë, ia kom harru emrin, me bo nifar' organizimi, nifar' programi me nxanës që m'u shënu 70 vjetori i gjimnazit. Kur e lexojshim historinë, ku delke roli i personaliteteve shqiptare shumë t'njohura që e kishin kry gjimnazin n'krejt qit' histori kërkund. Na patëm vendosë me reagua.

Hava u kanë kryetare e klasës merrke pjesë kështu me klasët e tjera n'kryesi të shkollës aty. Gjithmonë reagojke atje. Kah pak edhe kujdestari i klasës ia tërhjeke vrejten thojke, "Ti me qita kry që e ki qishtu ti shpejt ki me përfundu dikah se je shumë kokëfortë". Po ajo ka pasë vendosë qashtu me ngrit zanin edhe publikisht kur ish e mundshme. Vendosëm me kriju ni organizatë. Po erdh fundi i vitit e s'mujtëm me organizu kështu me ba grup po veç si treshe qashtu. A din, na dyja edhe ajo me ni shoqe t'ngushtë unë me ni shoqe t'ngushtë që kishim besim te njana tjetra.

E n'fillim t'vitit t'katërt atëherë patëm vendosë me bo tamon organizatë. Kem majtë takime t'rregullta, jem betu, kem pasë kriju nifar' statuti të organizatës po modest, nifar' statuti sa kem ditë na qato rregulla t'përgjithshme çfare duhet m'i pasë anëtarët e grupit edhe patëm kriju nifar' fondi me pak pare, sa kem mujtë, ça na kanë tepu neve kah ni grimë që na kanë dhanë për shkollë.

Me pasë arkatarin e caktun edhe me qato fonde me ble ni maqinë t'shkrimit, me ble letër për shembull edhe materiale tjera të domosdoshme që ju kanë dashtë grupit edhe m'i marrë pseudonimet e krejt ato çka lexojshim nëpër literaturë që duhet m'i pasë ni organizatë ilegale. Emrin e të gjitha këto tjerat. Po qito për me arritë me kulmu, si me thanë, me grup, me organizatë atë far' shoqërimin tonë t'qatyne

djemve e vajzave që vepronin bashkë kem arritë krejt pak para se m'u burgosë. Nashta ni muj a s'po di sa.

Tamon me ia dhanë atë fizionominë e grupit organizatë ilegale. Po aksione kemi ndërmarrë bukur shpesh. Domethonë kem shkru parulla, kem shkru pamflete, i kem ngjitur nëpër gjimnaz, i kem ngjitur nëpër qytet. Jem taku, i kem, si me thanë, i kemi këmbë ato tekste që i shkrujshim. U ulshim bashkë u merrshim vesh çka me hjekë prej ni teksti, çka me shtu, me cilën datë du me reagu, me cilën du me shty ma tutje pak atë far' reagimin edhe qishtu edhe kond me pranë n'grup, kond mos me pranë n'grup.

Tash na qato që u njëfishin s'kish kuptim me kanë treshe, se na tash u njëfishim mes veti. Po a me zgjeru grupin edhe me të tjerë a me kanë pak ma konspirativ. Qishtu domethonë. Qikjo u kanë për qita mujt e fillimit të vitit të katërt deri me 19 dhjetor kur jemi burgosë...

Anita Susuri: E më thatë që rregullat që i keni kriju i keni lexu prej...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Literaturës, po.

Anita Susuri: Ku u gjetë kjo literaturë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Tash unë me thanë t'drejtën, po, literaturë ilegale. Po unë konkretisht nuk kom pasë ni burim prej kah e kom marrë literaturën ilegale përveç ktyne shoqeve. Havës, Mirvetit, Hidajetit. Domethonë edhe ato nuk osht' që i kom marrë si gazeta m'i lexu po i kanë interpretu ato kur jemi taku. Për shembull, 'E kom lexu te Zëri, te Iliria', edhe na kanë tregu se sipas rregullave të organizimit ilegal qishtu osht' mirë me kanë edhe jemi pajtu me ato.

Edhe anëtarët, këta dy djem që i kem pasë anëtarë t'grupit, Roberti edhe Avnia edhe ata kanë dhanë kontributin e vet n'këtë aspekt. Po kryesore ka qenë Hava me na informu me literaturë ilegale për të cilën nuk e kemi vetë ku e ka marrë. Se nuk u kanë si me thanë logjike për kushte t'konspiracionit për me ditë burimin e materialit kah po vjen.

Anita Susuri: Po. E çfarë rregulla kanë qenë për shembull?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Mos me u zgjeru ma shumë sesa me treshin, a din, organizimi në treshe me mbetë për shembull n'treshen tem, dy anëtarë të treshes m'i njoftë une. Po ata m'i pasë anëtarët e treshes t'cilët unë nuk kom mujtë m'i njoftë. Edhe kontributet që kem pasë n'burg për shembull qato t'holla ose letër ose maqinë shkrimi ose çkado që kem pasë mundësi me organizu për grupin m'i ofru grupit edhe me kanë të gatshëm me marrë detyra çfarëdo detyre që t'jipet. Mos me refuzu detyrën përveç për ndonjë arsye shëndetësore ose arsye t'rrezikimit për shembull të konspiracionit.

Anita Susuri: E për shembull aktivitetet, keni pasë ni orar t'caktun që i keni bo ose vendet...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, orari na u ka imponu edhe prej orarit t'shollës. Se na për shembull unë u dashtë me dalë nashti prej shpisë kaniherë në 11:00 ora për me mujtë me mrrri në 01:00 në gjimnaz. Kaniherë kur u kanë autobusi i rregulltë në 12:00 se me autobus ke mujtë me mrrri mjaftushëm. Para orarit të shkollës nuk ka pasë gjasa. Mas orarit të shkollës e kem shfrytëzu rastin meniherë, ose edukata fizike ose serbisht kaniherë nuk e majshim orën, me dalë.

Qat' orar kaniherë e shfrytëzojshim m'u taku, po u takojshim afër gjimnazit qaty për mos hupë shumë kohë për me mrrri autobusin e fundit m'u kthy në shpi. Kaniherë rrugës për shembull deri në stacion kish kohë mjaft, prej gjimnazit deri në stacion osht' goxha larg, edhe rrugës u bashkojshim kah dy kah tri edhe përcjellshim informatën masanej te tjerat. Qishtu domethonë. Ose kaniherë u shmangshim pak prej rruge.

Kem pasë qaty te Shtëpia e Kulturës ku osht' sot kem pasë ni hapësirë si park, qaty u shmangshim pak prej rrugës sa m'u taku t'gjithë bashkë, m'i këmbu materialet, me marrë ato vendimet që kem pasë m'i marrë edhe m'u ngut me nxan autobusin e 07:00. Se me t'ikë autobusi atëherë arsyeya n'shpi, "Ku je kanë? Pse je vonu?" E qishtu.

Anita Susuri: E aktivitetet kanë qenë shpërndarja e ktyne trakteve apo edhe keni shkru parulla?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po na edhe parulla kem shkru po ma shumë, na jem kanë t'prira me shkru tekste ma të gjata me shpjegu ma tepër situatën. Se parulla na u ka dokë që osht' simbolike po pak e tejkallune. Ato kanë mujtë me bo edhe njerëzit e pa organizun, nxënësit e pa organizun. E na i kem vu vetit, si me thanë, qëllim na me qëllimet që kem pasë për të ardhmën edhe me nxjerrë ni revistë po ato masanej nuk janë realizu se janë burgosë herët.

Po bile së paku me shkru tekste ma t'gjata, me qit' emrin e organizatës n'fund me ditë kush p'e shkrun, a din, m'u ditë që osht' ni organizatë ilegale që qëndron pas tyne edhe me bo shpjegime pak ma t'gjata për atë aksion që kanë ndërmarrë...

Anita Susuri: Për shembull, çfarë përmbajtje kanë pasë [tekstet]? A ju kujtohen tash?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po m'kujtohen. Tash unë edhe ju ofrova traktin që ka shpëtu fatbardhësisht. Dy pamflete domethonë janë aty. Me rastin e 28 nëntorit ka qenë thirrje e nxanësve të gjimnazit me festu festën e 28 nëntorit e me bojkotu festën, kremtimin e 70 vjetorit të gjimnazit. Me i refuzu si me thanë do dukuri që na atëherë i thojshim negative. Që u organizojke diskotekë n'shollë. Na thojshim "Diskoteka e ka vendin diku tjetër, ni lokal që osht' për diskotekë jo n'shollë". Qishtu domethonë.

Edhe historik pak të historisë shqiptare përderisa na në landën e historisë nuk e mësojmë historinë tonë na duhet t'ë reagojmë, duhet t'ë kërkojmë që landën e historisë edhe landën e gjuhës shqipe t'ë ketë plan program mësimor që na mëson për historinë tonë, qishtë. Pak a shumë qikjo u kanë natyra e pamfletëve.

Anita Susuri: E afërsisht sa...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Edhe lirimi i t'burgosurve politik që u kanë thirrje e përhershme. Domethonë të gjitha traktet e pamflete që i kemi shpërnda kjo u kanë.

Anita Susuri: A keni shpërnda numër t'madh t'pamfletëve?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po n'gjimnaz nëpër çdo koridor ku kem arritë, nëse kem arritë, që secila klasë kur t'del n'koridor me gjetë si me thanë pamfletin, s'paku për çdo klasë me pasë. Po kaniherë kem dështu, nuk kem arritë me... se ka pasë kujdestari rigoroze nëpër klasa. Se qatëherë monitorimi u kanë pak i madh. Se qatëherë grupe vazhdimisht janë dënu prej gjimnazit. Masanej edhe kujdestaria u kanë shumë e rreptë. Po e shfrytëzojshim rastin. Se nxanës shumë, a din, qat' far' shumësi t'daljes t'nxanësve në pushim t'gjatë e shfrytëzojshim rastin edhe i ngjitshim. Masanej kush ka pasë mundësi i ka marrë i ka lexu, dikush besoj i ka marrë krejt me veti, i ka lexu, i ka studiu pak ma në detaje kur ka shku në shpi...

Anita Susuri: Po më intereson, a ka ardhë pastaj policia, kur i kanë gjetë ato?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po kanë ardhë te drejtori po jo policia e uniformume. Kanë ardhë inspektorët se masanena kur jom burgosë unë i kom pa qato ftyra që i kom pa n'gjimnaz disa herë me radhë. Kanë ardhë shpesh edhe bile Havën edhe e kanë marrë si kryetare klase. S'e di tash nuk e mbaj mend a ka pasë edhe naj përgjegjësi në kryesi t'shkollës, nuk e mbaj mend. E kanë marrë te drejtori në bisedë, po thom, informative te drejtori disa herë. Ajo na tregojke, thojke, qishtë, a din, po m'pysin. Po normal që ajo ka, i ka ikë, a din, jashtëzakonisht shumë mirë i ka ikë mundësisë për me dhanë naj detal i cili munet me na penalizu.

Po na menoj që si të ri që jem kanë e me shumë vullnet majshim takime shpesh nëpër qytet. Kur kem shpërnda me 28 nëntor në gjithë qytetin, u kanë e pamundur që dikush nuk i ka pa ato. Menoj qashtë. Tash shpesh herë e kem diskutu edhe masi dolëm prej burgut, cila ka qenë mundësia që jem identifiku pas nja dy-tre mujve veprimtari. Ti kur e qet' për shembull, organizata patriotike 'Ideali', aty janë menu që janë profesora, doktora, kumeditë kush janë. Kush e ka menu që janë ni grusht fmi që po shkrujnë asi pamflete.

Anita Susuri: Grupi ju, 'Ideali', ka qenë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, grupi jonë 'Ideali'.

Anita Susuri: E a keni qenë veç ju vajza n'qat' grup apo pastaj u zgjeru grupi që nuk i keni ditë treshet tjera?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Sigurisht që nuk i kemi ditë treshet tjera. Patjetër që nuk i kemi ditë. Se ka pasë edhe në aktakuzë që janë përmend që janë kanë treshë të dikujt që, po që nuk janë burgosë normal. Se ai që i ka pasë në tresh i ka mbrojtë, m'i mbrojtë gjatë hetimeve. Po i kemi pasë edhe ata dy djemtë. Domethonë na jem kanë shtatë vajza edhe ata dy djemtë. Po krejt emrat që janë përmend në aktakuzë asnjë nuk osht' burgosë me neve. E patjetër që ka pasë edhe të tjerë që kanë ditë pak a shumë për veprimtarinë tonë po që na me qat' qëndresë që kemi mujtë me ba brenda hetimeve nuk kanë dalë me i arrestu.

Anita Susuri: Ju domethonë në vitin e tretë thatë që veç ka fillu ilegaliteti...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po.

Anita Susuri: Pastaj ka vazhdu, po i bjen edhe në vit keni qenë në shkollë t'mesme?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po tash na jem burgosë me 19 dhjetor, domethonë gjysa e vitit. As pa u krye gjysmëvjetori i parë plotësisht në jem burgosë. Masanej vitin e katërt edhe masi dolëm prej burgut kështu.

Anita Susuri: Në vitin '84 ka ndodhë burgosja?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po.

Anita Susuri: A mundeni tash me m'tregu qysh ka ndodhë burgosja? Familja juj sigurisht nuk e ka ditë që keni qenë aktive?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Jo. Menoj që vllau i dytë edhe dy motrat e mija, motra që osht' msuse edhe kjo motra që thashë ma afër me mu që osht lahutare ma merr menja që pak a shumë edhe e kanë ditë. Se edhe kur i kanë gjetë... se na prej shpije u kanë e pamundshme me u mshef qaq fort. Na n'familje tem i kemi pasë dy dhoma, kur u martu vëllau në dhomë. Atëherë qato materiale qasajde kanë qarkullu nëpër shpi. Po nuk kanë folë, a din, për mos me m'qit' në siklet kështu për me m'thanë çka asi... edhe nuk u kanë fort çudi vallahi me folë për Shqipni e me folë për atdhe e për histori të shqiptarëve me përmend Enver Hoxhën e me knu kangë patriotike ajo asni grimë s'u kanë far' befasie a far' diçka e jashtëzakonshme për familjen tonë.

Bile tash masi e përmenda këta, m'kanë kallxu masanej masi jom liru prej burgut, familja kur janë shku me kontrollu n'familjen teme, krejt kasetat që i kanë provu m'i lshu aty n'kasetofon, secila Shqipni Enver, Shqipni Enver. Edhe qysh janë shpreh ata atëherë serbisht, "Ktu tek osht' Shqipëria e vogël". Domethonë ajo për familje u kanë krejt normale po për me bo kështu organizatë ilegale për të cilën arrestohesh edhe bjen në burg nuk besoj që ia ka pre menja bash për qatëherë.

E që m'pyte qysh jemi burgosë, domethonë, për mua për Havën edhe për Zogën prej klasës tonë se ato vajzat tjera, secila në mënyrën e vet qashtu prej shkollës na kanë marrë krejtve po ato nashta kanë rast të deklarohen vet. Kanë ardhë në klasë na kanë marrë në orën e dytë bile. Jom konë t'u pritë m'u pytë në astronomi e kom pasë renin, se jom konë me Z e fundit n'ditar e s'më vijke reni m'u pytë (qeshë) deri n'fund se gati u kanë me përfundu gjysmë vjetori po na nxanës shumë 42 a 43 jem konë n'vit të katërt.

Unë me gëzim kisha mësu astronominë, m'pëlqejke landa shumë edhe me gëzim për m'u pytë me marrë pesë. Hini bile ni profesor i matematikës edhe nuk di a janë kanë dy vet, kom harru. Po m'vjen keq që pasna harru. Edhe tha, "Have Shala, Zoge Shala edhe ti Muriq", a din po m'kqyrë kështu diqysh me çudi, tha, "je kanë inspektor i arsimit", edhe vazhdimisht gjatë gjithë shkollimit tem saherë kanë ardhë si inspektor kështu n'shollë ka pasë rast me m'pasë nxanëse që jom shqu kështu nashta sipas fjalëve që m'kanë thanë tjerët, si ma e qetë, ma e urtë edhe nxanëse e mirë.

Çudia e madhe qysh unë tash, se hajt ato dyja. Ajo rrebelja që po folë nëpër mbledhje po edhe ti. Tha, "Te drejtori me ardhë, ju ka thirrë në drejtori". Unë u çova me dalë qashtu qysh kesh. Tash nuk e di, po më doket janë kanë dy vet se po më vjen keq që paskem harru qit' detal. Tha, "Merre merre çantën edhe palltën". Tash unë shkova në fund të klasës me marrë palltën e shoqja jeme e bankës Bleona Shatri qëlloj jashtë. Tash ajo t'u hi edhe po ma bon kështu, {shpjegon me gjeste sillë kokën} a din, "Ku?" Unë veç bona qishtu {shpjegon me gjeste që nuk e din} "Nuk e di", a din. Ata, "Mos fol, hajde për dere menihere".

Na çun aty te drejtori. Ai drejtori serb. Aty te drejtori ish kanë ai udbashi që po thom, ai punëtori i SUP-it që i kom pasë ni dikur t'u i thanë Zoran, Zoran. Se tybe tash me kqyrë në dokumenta muj e gjej kush u kanë po nifar' Zorani që u kanë serb. Ishin kanë edhe dy-tre tjerë po kërkush n'uniformë. Domethonë tre vet tanë civila, m'thanën, "S'ke t'drejtë me folë, s'ke t'drejtë me thanë kurgjo", a din, edhe u ulëm qaty pritëm, pritëm, pritëm ra zilja pushimit.

Dikur po i thotë ai, "Kur doni m'i çu", tha, "Sa t'hijnë nxansat prej pushimit se mos t'na bohet tollovi". Tash si ka ra zilja e dytë janë çu n'kamë, "Hajde me mu edhe je e arrestune". Dy vet anash, shkallve teposhtë, n'kerr. U kanë m'doket ni veturë "Zastavë" e bardhë, mos t'harroj. Domethonë ata, a din, anash te dytë edhe kur shkum aty në, t'u hi shkallve të SUP-it m'u ka dhanë veç me kqyrë a p'e shoh dikon që me ditë, a din, që po na marrin.

Havën e Zogën nuk i pava unë se ato i kanë çu n'sallë ose dikun tjetër. Qaty te drejtori vetëm mua. Na çun atje në UDB-e. Ma s'pari mu përveti m'lanë ni zyre vetëm as nuk erdh kush. Veç dera çelën, tana dyrtë çelën. U nijshin t'u u en, a din, shumë anej, anej, anej. E dita se edhe ato dyja i çun nëpër dy zyre tjera. Po niherë për niherë sigurisht derisa e morën edhe këta Hidajetin e Safeten, a din, nuk filloj kurfar' procedure.

Masanej erdh ni udbash tjetër. Se ma u msum t'u ju thanë udbash. Ni punëtor tjetër i sigurimit. Malush, u prezantu si Malush Korhasani, atëherë që s'ia kom mbajtë mbiemrin kurrë veç Malushi e kom pasë mbajtë mend po tash prej dokumenteve e di kush osht'. Tha, "Unë jom punëtori i sigurimit që ka m'u marrë me ty, qito janë t'drejtat tua që je e arrestume, keni bo veprimtari ilegale", s'di çka m'tha se tash i kom harru edhe fjalët tjera edhe, "ke t'drejtë me marr edhe avokat".

A din, na s'kem ditë as cilat janë të drejtat as çka osht' me marrë avokat. Veç t'u pritë kur kërset dajaku. Po prap e kisha nifar' shprese se thojsha, "Neve nashti na majnë nja dy muj e na lëshojnë," a po din, çka kem punë për m'u... se organizatë, ajo u kanë e ditun që kanë me na dënu shumë. Po hajt, jo të mitura, nuk kom mujtë me marrë për fillim si shumë serioze që përnime vepra jonë te koka kanë qaq tronditëse për këto organet e sigurimit sa krejt Peja u çu n'kamë.

Masanej e kom pa kur e kanë pru Safetin. Për këta tjetër nuk kom mujtë me ditë, për djemtë. As për Eminin as për, kush u kanë tjetër, edhe Shkurtën e patën arrestu nime. Edhe çikën e mixhës të Havës se këto trija janë kanë t'ni familjes. Të katërtave. Masanej filloj qishtu procedura e hetimeve. Domethonë kjo u kanë sikur ora e masditës deri kah pramja.

Unë menoj që derisa janë kthy, s'paku për mu po flas, derisa janë shku, kanë kontrollu n'shpi, kanë marrë materialet, deri janë kthy veç u enshin këta punëtorët e sigurimit herë dikush herë dikush. Nuk osht' që më kanë pytë diçka t'veçantë as që më kanë torturu. Se sigurisht i pritshin rezultatet e procedurës hetimore që e bojnë në shpi a çka po di une.

Anita Susuri: A keni qenë në Pejë apo?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Jo, na familja?

Anita Susuri: Jo, jo në hetusi.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, po në hetusi në Pejë. Atë natë në Pejë. T'nesërmen mas 24 orëve thuajse i ka ra pak ma shumë se 24 orë na kanë çu në Mitrovicë.

Pjesa e tretë

Anita Susuri: Domethonë juve ju ka ra me nejt fillimisht 24 orë në ni zyre e vetme...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë qato 24 orë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Qato 24 orë menoq që janë kanë orët ma t'vështira për mua edhe për faktin se tortura psikike u kanë shumë e madhe. Herë t'u thanë që anëtarët e grupit krejt po tregojnë për juve, "Roberti krejt ka kallxu për juve edhe s'po i vjen marre atina burrë po kallxon për juve çika. Ju ka mashtruar tash ju ka qit' te tonave. Ai ju ka kallxu", qysh me thanë. Herë thojshin, vike ai, Xheladini, thojke, "Ata pa e rreh mirë ai gja s'kallxon". Veç për me t'qit' n'qasi pozite se ti diqysh edhe me dyshu në ata edhe me pranu veprën edhe m'u armiqësu me shokët e grupit.

Ni rast që a din që kështu m'ka mbetë peng tona herët, unë Safeten normal shoqe e kom pasë, Safete Krasniqin. Po fillimisht kur ka hi n'grup nuk e kom pasë ditë. Se ajo ka hi ose përmes Hidajetit ose Havës, nuk e di përmes cilës. Dikur kur kom pa n'grup a din, e mirëqenë, e ka pasë motrën e burgosun politike atë Hidajete Krasniqin edhe e mirëqenë u kanë. Po diqysh u kanë e re, ma e re se na edhe m'u dhimke diqysh. Thojsha, diqysh kjo e re.

Tash ata e kanë pytë, "A e njeh Zyrafete Muriqin?" Ajo ju ka thanë, "Jo", edhe më morën m'u ballafaqu me to. Tash mu m'veti ky, qiky, po harroj cili se ata veç vishin shpesh herë ai, herë ai, Jakup Llonqari. Tha, "A e njeh Safete Krasniqin?" Thashë, "Po", tha, "Qysh e njeh?" Thashë, "Jom kanë dy vjet n'klasë me ta", tha, "Po ajo po thotë që nuk t'njeh ty", thashë, "Po nashta ka harru që dy vjet jemi kanë n'klasë", tha, "Hajde m'u ballafaqu me ta".

Kur t'më shtin mu për dere ajo po ma bon me kry që mos thuj që m'njeh. Po ish jo logjike me thanë që nuk e njoh, ishte kanë dy vjet ni klasë. Tha, "A e njeh?" M'tha mu nërsy saj. Thashë, "Po", tha, "Qysh e njeh?" Thashë, "Jom kanë dy vjet n'klasë me ta". More ma përpara i ka ra Demë Muja shuplakë turive asaj sesa që m'kanë qit' mu përdere. Diqysh m'u ka pasë ba pikë se mu hala s'më kishin ra. E dikur thashë, që u bona unë, si sebeb që thojnë, u bona unë shkas që me rreh ata para meje. U bona pikë.

Qajo m'boni se diqysh me thanë, more a ke bo, kom me thanë kom bo e kom me bo derisa t'jom gjallë edhe kurrë nuk kom m'u largu prej qisaj veprimtarie. Se diqysh qaq shumë u mërzita se m'u dok diqysh se ia bona sherrin. Se ish diçka që ti s'mujsh mos me pranu. E qishtu. Ta ofrojshin, domethonë, dokumentin që ke vepru, për shembull, kto pamfletet që i kishin nxan. Masanej te shpija i kishin marrë do fletore me poezi. Po për poezi s'e kisha dert. Se poezi për Ali Lajçin, për demonstrata të '81-tes, ajo ish normale, a din.

Po këto pamfletin, "Kush e ka shkru qit' pamflet?" Njëherë u munojsha me thanë, s'e kom shkru, po dikur e kisha nifar' nxitje përmrena me thanë që po e kom shkru edhe pikë edhe çka. Le t'më mytin.

Qishtu dikur e kom pranu veprën edhe i kom pranu edhe pseudonimin edhe qito, domethonë, qito karakteristika që i kem pasë. Betimin e aksionet e qito të gjitha. Ata i kanë shkru deklaratat vet me thanë të drejtën, na veç i kem nënshkru. Po megjithatë kur i kom lexu në aktakuza e aktvendime që na kanë pru, nuk osht' që ka pasë diçka në deklaratë që e kanë shtu, a din. Qajo veprimtari e jona u kanë, qato aksione janë kanë, qato detaje që janë kanë tonat. Nuk osht' që me thanë kanë shtu diçka që me na dënu ma gjatë jo.

Anita Susuri: E ju s'keni pasë rast me lexu ata para se me nënshkru apo?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Valla me të thanë të drejtën qaq jom konë pasë lodhë e qaq nifar' mënyre se e mata unë tash punën ku ish. Na ishim zbulu si organizatë edhe ish e pamundur na m'u tërhjekë. Atëherë masi s'kish shansë m'u tërhekë, bile s'paku qëndro, qëndro qashtu qysh e ki qëllimin e saktë edhe pasoja le t'jetë sa t'jetë.

Anita Susuri: Pastaj thatë që ju kanë dërgu në Mitrovicë...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, dikur u kanë në orët e vona t'mramjes ditën e nesërme. Na kanë qit' prej zyres t'gjithave në ni koridor kah dalja e pasme e UDB-es aty. Na kanë lanë me prit qaty ni kohë, nja, s'po di gja, nja 20 minuta a gjysë ore, s'mun' e përcaktoj kohën. Jem pa me njona tjetrën po nuk kem pasë mundësi me komuniku. Kapak me sy, a din, diqysh si me vetë a t'kanë rreh shumë a qiso fjalve. Po qisi gjesteve por jo me komuniku në asni mënyrë.

Mu m'kanë lidhë me ni prangë, janë kanë do pranga plastike, jo kështu, zinxhirët që i kanë prangat këta që janë metalike, me Mirvetin e dy kah dy na kanë lidhë tanave. Na kanë qit' me ni kombi, janë kanë këta inspektorat me neve. Muj me pasë haru po m'duket që u kanë Dema, Demë Muja dhe Jakup Llonqari. Muj edhe me pasë haru, nuk e di kto çikat nashta e majnë mend edhe ma mirë. Na kanë çu në Mitrovicë. Rugës, se kombi u kanë kështu me hapësirë t'hapur përmbropa, janë kanë ata stolat rreth e rreth.

Jem pa me njana tjetren po nuk kem pasë asni mundësi me ia dhanë, për shembull, naj informacion njana tjetres qysh ka shku procedura e hetimit deri aty. Përveç se Hava niherë, a din, kështu ma boni me shenjë që e kanë rreh ata durve edhe me m'vetë mu a t'kanë rreh ty me shufër, a din. Qata sa për me kuptu pak qysh ka shku procedura e hetimeve. Po edhe u dike bre se aty i lejshin dyrtë çelë apostafat për me i ni njana tjetren t'u bërtitë. Aty u dike krejt situata qysh ka shku. Kah pak ka ni fjalë kur e folshin këta inspektorat, apostafat, njani tjetrin u kuptojke se torturat janë kanë...

Anita Susuri: A ka pasë ndaj juve dhunë fizike qato 24 orë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Qato 24 orë mu nuk m'kanë torturu fizikisht. Mu tek kur jam ardhë në Mitrovicë... pat' ra borë e madhe, nja pesë javë nuk kanë mujt me na marrë n'pytje hiç. Bile për qato

pesë javë kto katër vajzat që janë kanë t'mitur madhor i patën, tash me datëlindje nuk di qysh janë kanë, veç i kanë pasë liru. Qat' periudhë s'kanë ardhë as neve me na marrë n'pytje përveç niherë ka pasë ardhë avokati edhe niherë gjykatësi hetues. Jo gjykatësi hetues na ka marrë edhe në Pejë se mos te përzij, po edhe niherë ka ardhë edhe në Mitrovicë dikush na ka marrë n'pytje, në lokale t'burgut aty.

Po kur u kanë për m'i përfundu hetimet, na kanë marrë në, në organe t'sigurimit të Mitrovicës edhe qaty na kanë rreh për qef. Mu, për veti po thom, unë veprën e kom pasë pranë veç m'kanë rreh për me m'rreh me më demoralizu, me ma thy moralin, me si me thanë, me m'dëshpru, m'detyru m'u pendu, a p'e din. Se asni arsye tjetër. Me lexu aktakuzën tash e kom lexu edhe disa herë edhe masanej e kom lexu edhe në burg nuk ka pasë ndonjë arsye me thanë p'e pysim për me nxjerrë ni informacion. Na qat' vepër që qato dokumente që ishin nxan, qat' vepër e kishim pranë edhe nuk kish çka tjetër.

Qajo, qajo dhunë fizike në Mitrovicë u kanë boll e madhe valla. Me shufër gome durve, kamve. Bile durve diqysh e kom duru e kamve ish shumë e zorshme me duru. Po isha e lumtur që ma bile hetimet u kryen e detaje nuk kish shansë me dalë. Se presioni te unë u kanë shumë i madh për Shege Kelmendin. Për profesoreshën Shege që ta përmenda n'fillim. Edhe këtu në Pejë gjatë qatij presionit psikologjik e gjatë gjithë qasaj po edhe në Mitrovicë edhe përmes organeve kështu të burgut seneve kaniherë te Sherafedini [Ajeti] na merrke n'biseda informative.

Shega u kanë e burgosun pa shku na. Ka pasë t'shpallun dënimin kur shkum na shtatë çika të Pejës edhe u kanë edhe njo tjetër, jo në grup me neve po u kanë me vlla a s'di me kond u kanë e dënune. Ishim tetë çika të Pejës, nuk ki vend ma. Katër dhoma na krejt kah dy, plus edhe Shega me kanë profesoresha m'u bo organizatë mrena burgut. E patën liru për do kohë Shegën si mbrojtje n'liri n'shpi, kur na kanë arrestu neve. Domethonë, qat' presion që ma bojshin mu ish për, si me thanë, me ia lidhë vepër ata.

Megjithëse çdo njanin prej neve e kanë pytë për ndonjë profesor. Po mu konkretisht m'kanë pytë për Shegën shumë edhe për ni profesor të gjuhës shqipe. Po për Shegën shumë. Aty bile e kom tash e kom lexu bile masanej ktu në deklaratë që e kisha pasë thanë që, "Po kemi me ba qysh na ka eduku profesoresha Shege, ato që ka thanë Abdyl Frashëri", "Çka ka thanë Abdyl Frashëri?" "Me i bashku trojet shqiptare". E kjo i nervozojke shumë.

Se unë prej natyre pak qishtu si e qetë e thojke, "Ti don me m'kallxu mu m'i bashku trojet shqiptare Jugosllavinë s'ka kush e mun. Po kujtoni që veç ju jeni patrioti", thojke, "çu n'kamë". Domethonë veç shfryjke dhunë fizike se sa për me thanë që mujke me nxjerrë informacion diçka ish e kot ajo. Po sa me ta thy moralin kështu edhe qëndresën.

Anita Susuri: Sa kanë vazhdu tani hetimet krejt komplet?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Hetimet, po thom, hetimet tona janë kanë qiky 24 orëshi në Pejë edhe me thanë 24 orë në Mitrovicë nuk muj me thanë se u kanë ni ditë. Po kanë ardhë ndërkohë kanihere kështu aty në lokale t'burgut herë me avokat herë pa avokat, këta avokatët që i caktojke shteti. Mu ma ka pasë marrë familja ni avokat. Bile jashtë dëshirës time normal se e kom edhe deklaratën aty që nuk kom dashtë avokat. Po familja si familja, ju ka dokë që t'ndihmon diçka. Niherë me prezencë t'avokatit e di që janë kanë aty n'organe mrena lokaleve t'burgut. Domethonë qikaq u kanë.

Anita Susuri: E kontakt me familjen kur keni fillu me pasë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Vizitën e parë më duket mas ni jave a mas dhjetë ditëve, vallahi nuk e di. Kanë ardhë nana, vllau i madh, motra qikjo motra mësuse. Ato dihet ajo procedura qysh u kanë për me marrë leje për vizitë në Gjykatë të Qarkut në Pejë. Vizita u kanë as ni minut s'besoj që u kanë vizita e parë. Veç sa i kom pa si figura edhe që më kanë pa. Po u kanë ajo pjesa me grila, kështu, t'imta që u kanë ajo pjesa e vizitave. I ka pasë ni gril të dyfishtë. Se te grila e parë ku u kanë familja, u kanë ni hapësirë, pastaj u kanë ni grilë tjetër ku dilshim na.

U kanë ni koridor i errët aty. Na mujshim ata nashta pak m'i pa se ju bijke drita prej ni dritare t'vogël t'koridorit po ata neve s'di edhe qysh kanë mujt me na pa. Se edhe grilat e dyfishtë edhe terri bile veç zanin na kanë ni e kanë pa që jemi. Edhe vizitat masanej janë kanë për çdo dy javë. Familja gjithmonë m'kanë ardhë. Nana gjithmonë gjithmonë derisa jom liru, kurrë nuk ka ndodhë ni vizitë mos me ardhë n'vizitë, si ktu në Mitrovicë si në Lipjan. E këta anëtarët e tjerë të familjes herë dikush herë dikush, qysh kanë mujtë m'u kombinu a din.

Anita Susuri: A ka qenë vështirë për familjen me udhëtu kështu?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po u kanë vështirë valla se atëherë, për shembull me autobusa me shku prej ktuhit në Mitrovicë s'di qysh i kanë marrë lejet, nashta ni ditë përpara. Nuk di qysh u kanë ajo procedura. Po u dashtë herët me dalë. Niherë me dalë prej katunit në Pejë atëherë prej Pejë në Mitrovicë. Prej stacionit të autobusave me shku te burgu u kanë goxha larg. Me prit aty deri n'vizitë kumeditë sa i kanë lanë me pritë se tona herë i kanë lanë familjarët me prit shumë. Ata e kanë pasë kështu si metodë. Dikur për m'u kthye. Sigurisht, qysh jo, kanë heq boll.

Anita Susuri: E gjykimin kur e keni pasë? Pas sa kohe?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Gjykimin e kem pasë pas shtatë mujve. Na kanë pru prej Mitrovicës në Pejë. Qashtu mu me Mirvetin prap veç atëherë me këso pranga tjera, të hekurit. Po ajo periudha e burgut në Mitrovicë u kanë interesante shumë. Domethonë ditën e parë kur jom shku në Burg të Mitrovicës, po thom, edhe pse s'më kishin rrehë, e lodhne e kputne po hala e kisha nifar' elani shumë t'madh. Tash aty u kanë, nuk ka pasë të drejtë m'u ulë në kreveta. Janë kanë do shilte poshtë në tokë edhe u kanë ajo dyshemeja kështu si me pllaka e ftohtë gur.

Ditën u dufke m'u ulë në qato shilte po tash na sa shkum edhe nata e parë. T'ulna unë aty n'krevet edhe t'ja nisi me knu kangën e Fatime Sokolit. Veç kur u çelë dera. Erdh ni gardiane u kanë e vështirë ni gardiane, shqiptare u kanë po u kanë tepër e egër. Tha, "A e din ti që s'bon këtu me knu?" Tona ato të burgosnet që ken' u çun n'kamë aty. Nejse edhe unë për veti, se na dyjat në dhomë. E t'ma tërheku vrejtnen e t'na qiti atë rendin shtëpiak. U kanë fletë e madhe ni metër gati, shkrun serbisht e shqip ato rregullat. "Lexo qita edhe niherë me ta ni zanin", po s'më ra, qaty më ra s'më ra. Shkoj ajo.

Ajshe Gjonbalaj u kanë e burgosne për terrorizëm e akuzune, e dënune 15 vjet, kom harru a 15 a 20 kom harru sa vjet u kanë e dënune tash. Tha, "Kqyre çika e mirë, prej kahit je?" "Prej Rugove", tha, "Juve dje ju kanë arrestu a?" "Po", qishtu po i kallxojmë në pika t'shkurta pak. "Për çka ju kanë marrë?" Tha, "Njani ish konë pa korit, dy minuta para deke", tha, "a t'kanë thanë aty ku t'kanë marrë që këtu hyn me kry naltë e del me kry t'ultë", tha, "këtu duhet, këtu hin gjithqysh njeri veç prej ktuhit duhet me ditë qysh del", tha, "këtu duhet m'u rujtë shumë", tha, "se mirë shumë që po knon m'paska marrë malli me ni t'u knue. Po duhet m'u rujtë se veç me knu nuk osht' patriotizëm. Duhet me i mbledhë mendt, me ulë krytë, me kqyrë çka po bon".

Vet me veti e mora vesh unë këta. Nuk e kisha unë që mos me knu, nuk e kishte as ajo mos me knu po e ki për me kanë e kujdesshme mos me ia bo sherrin as t'burgosurve tjerë se aty dikush e bojke ni problem tanë i rreshin, i çojshin në vetmia. Me kanë pak ndoshta jo e re entuziaste ashtu po masi e burgosun politike m'u kanë pak ma e matun e pak ashtu serioze.

Anita Susuri: Domethonë veç n'gjykim, pastaj mo ato shoqet tjera mrena burgut s'i keni pa?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Jo mrena burgut na si me thanë e kem zhvillu nifar' jete të burgut edhe aty. Se tash me Mirvetin që jom konë ni vepër, na e diskutojshim tana detajet edhe u përgatitshim për gjygj edhe qato pesë javë për neve tash... borë u kanë nuk e di a osht' bora. Ni borë e madhe atëherë në '85-ten a u kanë arsye bora që s'janë ardhë me na marrë a kanë hulumtu mos ka përnime dikush ma e pjekun mas neve. Kanë përcjellë profesorat e familjarët patjetër që i kanë përcjellë. Edhe këto çikat që i kanë liru, normal që i kanë përcjellë edhe këto se anëtare t'grupit janë kanë. Emrat, pseudonimet i kanë pasë aty.

Për qato pesë javë na nifar' mënyre e kem pasë nifar' kohe m'u rehabilitu po thom mrena atij rrethi tonë. Me ditë çka, qysh më tutje. Se tash ishim ku ishim po tash e tutje qysh. Me Mirvetin po, tona i kem diskutu vazhdimisht. Po na kishim rast kaniherë me folë edhe me dhoma tjera. Se tash edhe gardianët, a din, do janë kanë t'egra shumë po do janë kanë pak ma t'mirëkuptueshme. Kanihere ose kur dilshin me qit' njanën dhomë në shëtitore ose kur na çojshin n'banjo, për shembull, që kem pasë m'u la ose diçka u krijojke nifar' mundësie që dhoma me dhomë sado pak me za t'ultë nifar' komunikimi t'lehtë me ba. Trokitshim n'mur kështu me nifar' krisme që u kanë e burgosurve politik...

Anita Susuri: ‘Republikë Kushtetutë’.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, ‘Republikë Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë’. Ato dritaret m’i derë t’burgut janë kanë kështu pa xham. Se janë kanë ato grilat m’i derë t’hapuna pastaj janë kanë ato dritaret e koridorit që për me hi ajri i pastër. Qaty hipshim në atë krevetin që u kanë afër asaj dritares dhe sado t’vogël pak bile s’paku me dhomën këtu që e kem pasë. Se na jem kanë gjashtë, Zogëja u kanë edhe Hidajeti pesë masanej u kanë Hava me Eminen ni kohë, tash m’paska dalë prej mendjes, me [Teuta Bekteshin](#) në katërsh.

E treshi u kanë shumë larg. U kanë banjoja, zyra e drejtorit e treshi. Me tresh thuja kurrë nuk mujshim me komuniku. Se s’ka pasë mundësi m’u ni zani aq larg se vishin gardianët. Qishtu kishim mundësi me çu naj mesazh, m’u marrë vesh për diçka, me t’vet për shëndet, m’u marrë vesh për greva kur e kishim ndërmend me bo naj grevë, me reagu për diçka. Qishtu...

Anita Susuri: Për çka keni bo zakonisht greva?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Greva kem ba, se na parapagujshim gazetën, nja e dy. Na parapagujshim “Rilindjen”. Po u merrshim vesh kaniherë kur kish mundësi kah dy gazeta. Njana për shembull “Rilindjen” njana ni gazetë tjetër, puna që me pasë informacion pak ma shumë. Ka pasë, kem pasë ni të burgosun për ni vepër tjetër t’komunitetit boshnjak edhe ajo parapagujke ni gazetë t’vetën. Qishtu kishim mundësi prej disa burgimeve me marrë informacion çka po del jashtë.

Kur i dënojshin grupet e djemve që zakonisht u dënojshin me dënime t’gjata. Të burgosurit e Mitrovicës gjithmonë kanë ndërmarrë kah ni aksion simbolik, e kah ni grevë, kanë reagu me ni formë. Sidomos u kanë qikjo me trokitje. Tash organizojshim dhomë mas dhome, dhomë mas dhome edhe me djem naltë e kështu kond e kem pasë poshtë e. Me qito trokitje edhe krejt burgu nashta përiherë e bojke qita, ‘Republikë Kushtetë ja me hatër ja me luftë’. E ajo tash i çmenke.

Tash ose kush e kish fat ose kond e kish n’plan Sherafedini i izolojke, i çojke nëpër ato dhoma vetmia e qishtu. Atëherë nëse dikond e torturojshin na bojshim grevë urie. E bile u kanë ni rast nihere, nuk e di a u lidh me grup tonë tash m’ka dalë prej mendve. Poshtë ish kanë ni zyre e policëve. Na tash për me reagu me ju thanë atyne m’i tregu, se tregojshim me krisma kah sa vite janë dënu. M’doket kur u dënu grupi jonë tash me ju tregu atyne sa vjet jom dënu, ni, nihere ni, atëherë i pari për shembull tetë vjet.

Tash veç s’kem ditë gja veç u çelë dera, janë ardhë këto gardianet me ni mbikqyrës u kanë malazez. E çelën derën, “Kush po troket poshtë?” Na normal që s’reagojshim. A din, kaniherë ka ndodhë edhe ka ni shuplakë qishtu turive na kanë dhanë neve gardianët, e kaniherë na kanë tërhjekë vërejtjen. Kaniherë e kanë marrë dikond, në dhomë tonë jo. Me na marrë Sherafedini me na çu atje n’pytje, jo.

Anita Susuri: E qysh kanë qenë kushtet e tjera t’burgut? Ushqimi, banjot që thatë...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Banjot, qajo u kanë, qajo u kanë kijameti i burgut edhe në burgje hetuese gjithkund qikjo u kanë problem shumë i madh. Se për shembull na i kem ato kiblat, i ke ni prej t'burgosurve krejt, ato kantat që janë kanë m'i kry nevojat fiziologjike në dhomë. Niherë gjatë ditës në mëngjes na çojshin n'banjo, niherë n'javë na çojshin m'u la. Na gjashtë veta për shembull, ni tush u kanë, i madh. Se kur e lëshojke ujin tushi për shembull na mrrijke tonave. Po sa u bojshim me shampoon, e lshojshin ujin e ftoft ndaq laju me ujë t'ftoftë ndaq rri me shampoon. S'na pritshin m'u veshë e qashtu na bishin n'dhomë.

Dhomat janë kanë shumë të ftofta. Ose na që shkum n'dhjetor e ai dimër u kanë i ranë. Veç a beson kaniherë na ndodhke me Mirveten edhe me ato tjerat. E kom pasë edhe Rexhie Malën në dhomë, gruaja e Hasan Malës. U mbshtjellshim qishtu {shpjegon me gjeste batanijen rreth trupit} me ato batanije të kqija po bile s'paku ishin batanije. Tanë ditën u enshim nëpër qat' dhomë t'vogël me na lëvizë pak gjaku se u mërdhishim. Domethonë tepër, tepër, tepër ftoft u kanë. Për shembull m'u ulë u dufke veç në qato ulset poshtë. Aty fryke përfuni atyne krevetave. Bile so çudi që sot secila prej neve ka reumë e ka probleme me eshna. Se fryke si me kanë çelun atje.

Anita Susuri: Sa ka qenë e madhe ajo çelia, dhoma?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Burgu i Mitrovicës është burg i rrumbullakët. Pjesa e ngushtë atje u kanë sa e nxen ni krevet. Tash po i bjen që u kanë dy metra e pjesa te dera duhet me pa kanë katër metra, besoj. Se sa u kanë dera edhe nashti as katër metra jo. Sa u kanë dera u kanë qaq hapësirë anej dere. Sa tri dyrë me kanë. E kështu u kanë sa dy kreveta gjatësia.

Anita Susuri: Sa veta për shembull ma së shumti keni qenë n'dhomë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: M'doket nantë janë bo niherë me do t'burgosura që i bishin për vepra tjera po na gjithmonë dyshojshim. Valla bishin për gjithfar vepre, dyshojshim që po i bijnë pak a shumë me na përgju çka po flasim. Se ish na, ish Rexhia e burgosun politike, Ajshja, une, Mirveti. Katër veta aty normal që ish e domosdoshme me pasë dikon që, që përgjon pak çka po flasim. Ato dy gra tjera që janë kanë për vepër tjetër, ato janë kanë t'mirësjellshme. S'paku sa i përket kësaj sjelljes mrena dhomës, nuk kem pasë naj problem me to.

Anita Susuri: Sa vite u dënut ju?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Unë jom konë pasë dënu me pesë vjet e gjysë.

Anita Susuri: Në Mitrovicë i keni majtë pastaj?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Edhe pesë javë mas gjykimit jom konë në Mitrovicë, gjithsej shtatë muj jom kanë në Mitrovicë e pjesën tjetër në Lipjan.

Anita Susuri: E a ju kanë, paraprakisht a ju kanë tregu që po ju ndrojnë për shembull...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po po neve na kanë tregu po edhe e kem ditë edhe prej t'burgosurave tjera. Se edhe ka pasë edhe t'burgosura për vepër ma t'shkurtë në ndërkohë që na kanë ardhë n'dhomë. Ilmaze Grainca e Ferizajit pastaj [Teuta Hadri](#). Se ra rasti qashtu që n'dhomë të Teutës u lirun vajzat, ajo mbetë vetëm edhe patën pru pastaj n'dhomë te na. Teuta edhe me përvojë pak ma t'gjatë edhe ma e pjekun kështu. Ajo na tregojke edhe këto detaje që nuk i dishim na si t'reja. Na orientojke, na msojke besa edhe na ka, si me thanë, na ka këshillu bukur mirë edhe për gjykim.

Edhe pse tash na n'gjykim e patëm, se s'e di sa t'ka rasti edhe me kto shoqet e mija me folë. Patëm vendosë edhe aty me bo ni aksion simbolik. Vendosëm m'u veshë tana vajzat bardh e zi. Djemve normal që s'kishim qysh me ju çu fjalë, se s'kishim përmes kuj' se ish e pamundur edhe përmes familjarëve. Qata e patëm ba domethonë për gjykim tonë. Se gjykimi ka zgjatë tri ditë. Na domethonë prej t'akuzunit t'parë kishim mundësi masnej na tjetër m'i dëgju deklaratat e njoni tjetrit. Po gjykimi u kanë interesant shumë edhe për qit' frymën bashkëpunuese, për qit' frymën, si me thanë të ni zanit që e kem transmetu si grup n'gjykim.

Anita Susuri: Kur pastaj ju ulën vitet e, po mendoj të dënimit?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Vitet e dënimit dikur nashta mas ni viti, a s'po di, se pa e kqyrë tash dokumentin kur u majtë seanca e Gjykatës Supreme. Ata nashti na kanë njoftu, tash kom harru, se na çojshin kah ni letër me na njoftu. Po aty s'kem marrë na pjesë. Veç i kishin pasë thirrë prindët. Bile vonë m'ka tregu vllau qysh u kanë me babë të Havës e me këta prindërit e tjerë. Kanë marrë vendim na kanë ulë dënimin. Se na jem kanë shumë kokëforta nuk osht' që kem shkru naj kërkesë për ulje të dënimit, a diçka. Po dënimi në raport me veprën te na si t'mitura madhore jem kanë tonat pse na kanë dënu si të rritura u kanë shumë i madh edhe dikur Gjykata Supreme e Kosovës na ka ulë dënimin.

Anita Susuri: Dy vite e gjysë pastaj.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Tri e gjysë, pesë e gjysë, tri pastaj edhe gjashtë muj shtëpia ndëshkuese, dy e gjysë i kom majtë.

Anita Susuri: Kur ju transferun në Lipjan, si ka qenë atje?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Lipjani me Mitrovicë osht' goxha ma ndryshe se kushtet janë kanë ma normale për me zhvillu ni jetë të burgut pak ma, me thanë, mrena kufijve të dinjitetit nëse munet m'u qujtë

qashtu. Edhe pse na kem reagu edhe aty se na detyrojshin me punu. E kem refuzu me punu se kishim qef me lexu. Po puna u kanë e obligueshme. Kem bo grevë, u kanë e pamundur m'i ikë asaj.

Kushtet edhe se m'vete për Mitrovicë për ushqim e për higjienë e për shtrat e për m'u pa me shoqe. Për tona në Lipjan janë kanë ma t'mira në raport me Mitrovicë kushtet e Lipjanit janë kanë kushte t'ni burgu normal të organizun n'qat' kohë në Kosovë. Se s'e di kush u kanë përgjegjës n'atë kohë për burgje në Kosovë po u kanë ma i organizun.

Anita Susuri: E kështu për shembull me vazhdu ni pjesë t'shollës mrena burgut a ka pasë kesi...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Na s'kem pranu. Po ka pasë po na të burgosurat politike... nashta e ka pranu dikush s'kom informacion po unë jo. E kom kry masanej qat' pjesë të shkollimit që m'ka mbetë, qat' vit të gjimnazit masi jom liru. Kem shku kështu me sistemin e provimit klasor.

Anita Susuri: E a keni pasë naj mundësi edhe pak ma gat me nejt me familjen në vizita?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, po. Në Lipjan vizita u kanë niherë n'muj edhe u ditë që osht' niherë n'muj po edhe aty s'ka pas t'drejtë me ardhë jashtë familjes të ngushtë. Kanë ardhë familjarët e ngushtë po për shembull që u kanë karakteristike që t'miturit në Mitrovicë nuk kanë ardhë, aty në Lipjan bile s'paku vijke motra që u kanë e mitura. Dy motrat. Jo naj djalë i motrës, jo naj çikë e motrës. E qishtu edhe familjarët, fmitë kryesisht të familjes tjerë që s'kanë pasë mundësi me ardhë në Mitrovicë.

E aty normal vizita u kanë e mbikqyrun edhe shumë rigorozisht e mbikqyrun edhe në Lipjan. Po s'paku ke pasë mundësi me vet qysh po kalojnë e qysh po jetojnë jetën edhe ata me na pa qysh jem me shëndet, e çka po lexon e qishtu naj libër. Libra prej shprijes na kanë pru. Se këtu e kem pasë bibliotekën aty, në burg që i merrshim edhe në Mitrovicë kem pasë libra në burg. Edhe pse literatura u kanë e përzgjedhun kështu tipike për mos me pasë çka me lexu po rrallë osht' ndodhë naj autor klasik që ke mujtë me gjetë vetën t'u lexu aty.

Anita Susuri: Zonja Zyrafete, deshtët me tregu edhe pak ma gjerësisht për grevat që i keni zhvillu?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Greva e madhe që e kemi zhvillu në Burgun e Lipjanit nja ni muj a pesë javë masi na kanë zhvendosë prej Mitrovicës në Lipjan, ka pasë t'bëjë me mbrojtjen e Ajshe Gjonbalaj që ka refuzu punën. E përmes asaj mbrojtje që i kem bo na asaj kem dashtë me refuzu punën t'gjitha. Po realisht pretekstin që ata me transferu Ajshen prej Burgut të Lipjanit në ni burg në Serbi, Pozharevc më duket, u kanë që ajo ka refuzu, t'u refuzu punën ka refuzu edhe me hekurosë flamurin e Jugosllavisë.

Atëherë qajo u ba shkas që na hym t'gjitha vajzat n'grevë. Po tash prej asaj greve i transferun edhe këto të burgosurat në dënime ma t'gjata edhe ma t'hershme se na. Nazien, Kadrijen, Trëndelinën, Havën e kthyn në Mitrovicë. Hafiden. Nashta po e harroj ndonjanen, m'vjen keq nëse po harroj. E na që mbetëm

aty në Lipjan na dërgun nëpër vetmia t'djemve atje t'burrave se aty te pavijoni jonë i grave në Lipjan nuk ka pasë dhoma kështu çeli, a din, për me të mbajtë në vetmi.

Po edhe atje te vetmiat kur na dërgun prapë nuk kish vetmia [çelia] për t'gjitha neve sa ishim. Prap u detyrun me na vendosë kah dy veta bashkë. Mu m'pat' ra, ata qysh zgjedhën, me Hidajete Kelmendin. Ata e kom kështu edhe si të afërme familjarisht. Ai ni muj ditë që kom nejt me ta osht' nifar' përvoje e veçantë n'jetë që e kujtoj, e kujtoj kaniherë edhe me mall. Se disi me Hidajetin edhe që jom kanë anëtare e grupit bashkë nuk na ka ra fort para burgut me nejt bashkë. Nashti në veprimtari naj mbledhje po jo kështu me nejt me tamon m'u njoftë mirë.

Për qat' muj kemi kalu atë pjesën e jetës me ato përshtypjet për njana tjetrën që tash i kemi t'përrjetshme. Që domethonë janë t'pazëvendësueshme për asni periudhë tjetër t'jetës. E mas ni muji edhe para se me na shpërnda edhe ni detaj që besoj osht' i rëndësishëm për me thanë. Na qat' ditë që hym në grevë kem pasë vizitë. Tash kishin ardhë familja e Havës kish ardhë edhe familja jeme. Aty normal ia kanë ndërpre vizitën edhe ju kanë thanë që s'bon m'i pa se e kanë thy rregullin e burgut, a nuk e di qysh janë shpreh, qysh ju kanë thanë.

E kishin marrë babën e Havës edhe vllaun tem te drejtori edhe po na thirrin neve. Tash na kur shkum aty, na shtinë aty n'zyre te drejtori. Ata anej ulun na knej. Ju kishin bo presion atyne me na thanë neve me thy grevën. Tash normal që ata asnjani s'kanë pranë. Po tash m'tregon vllau m'thotë, "Sa presionin na kanë ba sikur me na thanë s'keni qare pa i bind që ato me thy grevën". Tash ata, ai Seferi, u shpreh për veti edhe vllau jem tha, "Jo, kjo osht' e madhe tash ka ba 18 vjet. As s'më ka vet kur ka ardhë në burg as çka bon kjo, unë nuk muj me ndiku te kjo", tha, "ku t'kisha thanë unë për shembull me thy grevën tye krejt çikat në grevë".

Qajo vizitë përfundoj me qaq. Nana e kush u kanë, nana e Havës e familjarët e tjerë normal kanë prit kanë prit janë kthy, a din. Atë ditë u përfundu me qaq. Atëherë me Havën ma nuk jom pa deri... se qaty ata e çun për Mitrovicë, deri u liru prej burgut, vonë dikur. Deri në pajtim të gjaqeve. E diqysh m'ka pasë mungu gjithmonë ai kontakti me Havën. Se me ata, qysh me thanë, fillimisht e kem fillu veprimtarinë edhe brenda burgut s'kom pasë fatin me kanë me ta. Pastaj ni kohë t'shkurtë pak gjatë pajtimit t'gjaqeve ajo pat' dalë në Zvicërr. Ndarja që m'u ka ba me ta mrena burgut u kanë prej ndarjeve ma t'kqija që kom mujtë me përjetu me çika t'burgosura politike.

Anita Susuri: Atë ditë kur e keni, kur jeni liru prej burgut ka qenë data e saktë kur keni pasë me dalë a po?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Jo, mu m'i kanë hekë shtëpia ndëshkuese gjashtë muj. Domethonë u kanë nifar' lirimi që e bojke shtëpia ndëshkuese. Gjashtë muj ma herët sesa data që e ka caktu Gjykata Supreme.

Anita Susuri: A kanë ardhë sigurisht familjar me ju pritë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Familjarët kanë ardhë. E kanë marrë vesh, kom nisë me harru, nuk e di a e kanë marrë vesh ma herët a kom pasë t'drejtë me ju çu letër. Nashti ju kom çu letër ju kom tregu, krejt kom harru tash, nuk e di saktësisht qysh u kanë. Po kanë ardhë vëllau, burri i motrës edhe ni djalë i mixhës që e kom edhe tezak. Kanë ardhë m'kanë marrë, jom ardhë n'shpi. Emocioni kur jom ardhë n'shpi... se emocioni i parë u kanë nata e fundit që e bon me t'burgosura politike. Edhe tash diqysh unë me Mirvetin isha kanë shtatë muj në Mitrovicë e pandame.

Aty në Lipjan si me thanë, nuk u kanë kështu pavijon i mbyllur për mos m'u taku, aty u takojshim. N'dhomë t'qëndrimit e n'punë e kah na çojshin n'kuzhinë e kështu, ke pasë mundësi m'u pa për çdo ditë edhe kah disa orë. Për shembull, nëse ma shumë jo, në orar të punës përveç që je pa fizikisht kështu s'ke mujt me komunikuar. Po bile ato dy orët e qëndrimit ditor që i kem pasë, ke mujt me u pa. Po diqysh megjithatë ma shumë të vjen keq prej anëtarës të grupit.

Normal edhe tjerat janë kanë, Akile Dedinca, dikush prej vajzave tjera ma gjatë që patën mbetë. Ajo natë normal e bojshim nifar' përcjellje për kondo që u lirojke prej burgut e bojshim nifar' që, bojshim hajgare na thojshim kanagjegjin (qeshë). E po emocioni tjetër u kanë kur jom ardhë n'shpi. Ishin rritë fmija. E shisha, nuk u kanë kohë shumë e gjatë, dy vjet e gjysë nuk janë shumë, po te fmija osht', i sheh fminë që janë rritë nuk janë ashtu t'vegjël qysh janë kanë. Qaty diqysh e kom pasë ni emocion ma të madh.

Vllau qat' ditë kish me shku ushtar. Veç ka ardhë me më marrë mu atje prej Lipjanit edhe me shku qat' natë ushtar. Atëherë kur shkojshin djemtë ushtar, ia bojshim ni përcjellje sikur po shkon, nuk po dihet qysh po kthehet, a p'e din, u kanë mërzi goxha e madhe. Pavarësisht asaj gzimit që u kanë për familjet që u ktheva une, ish diqysh nifar' mërzie që e përcillshim vëllaun. Normal dihet që krejt kush ka shku ushtar që ka pasë ndonjë pikë në biografi, sipas ktyne, ka hekë keq ma shumë.

Normal, si nifar' parandjenje se tani vëllau ka hek shumë keq në ushtri. Ni emocion që kur jom liru u kanë edhe mixha i vogël kur pat' ardhë për me m'përqaf. Tash po më mërthen vaji (qan), i shkojshin lot. Se disa kohë s'ishim pa edhe thojshin, "N'vend se na burrat me kry qita që e ke kry ti", thojke, "t'ka ra hise ty". Po gjithkush e ka hisen e vet për ata, a din.

Pjesa e katërt

Anita Susuri: Pastaj pas burgut keni vazhdu me shkollën, me...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, unë jom liru në qershor me 20 qershor. E për atë vit u kanë e pamundur me vazhdu edhe me provime klase se s'ka pasë ma kohë, u kry viti shkollor. Pastaj, jom interesu, jom shku

në gjimnaz kom pytë, “Cila osht’ mundësia?” Edhe m’kanë thanë që, “Nëse ju lejojnë prej organeve t’sigurimit duhet me ardhë m’i paraqit provimet e klasës edhe me vazhdu me provime klase”. Dikur kah muji n’janar m’doket janë kanë provimet e klasës. Jom përgatitë.

E kom marrë paraprakisht, nëse po m’kujtohet, temën e diplomës, jo, s’e kom marrë paraprakisht temën e diplomës. Jom shku niherë n’provime megjithëse na secila prej neve u kanë nxanëse e shkëlqyeshme. Po tash aty te provimet e klasës unë menzi arrita me sukses shumë mirë me kalu. Se edhe drejtimi matematikor, nuk osht’ edhe që mson. Unë msojsha, po nuk osht’ që mujsha edhe m’i mrri. Me i mrri të gjitha njësitë mësimore që i kanë ba nxanësit e rregullt. Besa mas ni kohe as me i kuptu mirë.

Po vendosa me vazhdu, menojsa atëherë, ka me vazhdu atëherë me teknik ose me matematikë edhe u munojsa qashtu n’atë temën sa mujsha me msu matematikë. Po i përfundova masanej. Temën e diplomës e pata marrë në programim te kujdestarja e klasës. Po nifar’ ftohtësije. Nifar’ ftohtësije fort e madhe kur shkova në provime të klasës. Ata dashamir qysh me thanë na kqyrshin kështu me miradi, me mirëkuptim po nuk osht’ edhe që fort u lëshojshin me na përsëndet e mirë se keni ardhë e ishalla keni tash sukses, a din, n’këtë rrugë t’shkollimit, bile s’paku tash e tutje. Se a din edhe ata ishin t’përcjellun për veti.

Ata tjetër na kqyrshin me bisht t’synit, si kështu a, qysh s’ju kanë nalë edhe ma shumë n’burg. Që kom ni, do veç çka s’kanë thanë për neve që kem shpërnda pamflete. Çika e a din edhe me terma pozhorativ. Paragjykime po kush u mërzitke për atë pjesë. Masanej në korrik e kom regjistru Fakultetin Teknik, drejtimin e elektronikës. Po s’e pata kalu testin m’u pranu menihere po n’listën rezervë. Kur shkova me marrë dokumentet thashë s’të kokna pranu. Me shku në filologjik m’pëlqejke se qysh me thanë, filologjikun edhe letërsinë i kom dashtë edhe si fmi edhe gjithmonë.

M’bike motra libra me lexu prej shkollës, se jom kanë shkollë e ndame, gjithmonë kom pasë libra shumë edhe gjithmonë kom lexu. Po thojsha ku me punu, tash u dufke me menu edhe këtë pjesën. Pavarësisht asaj që ti po kryen shkollë e çka po t’pëlqen qysh m’u gjind n’jetë pastaj. Thashë, hajt se po e regjistroj Fakultetin Teknik. E që të tregova që s’u pranova po mbeta n’listë rezervë, kur shkova m’i marrë dokumentet po m’thotë ai referenti, “Pse po i merr?” “Po s’të kokna pranu”, tha, “Hajt le mos i merr”. Po m’shkoj dikur menja që edhe mos kem pasë na noj ndalesë, m’shkoj menja se nuk osht’ që m’tha. “Le”, m’tha, “se pranohesh me korrespondencë”.

Thashë pse jo masi po thotë edhe u pranova me korrespondencë. I ndëgjova dy vjet në fakultet të elektros. Vitin e tretë pata fillu po dikur masi u njoftova me Salihun, ky m’u tek, “Pse masi ki prirje për letërsi nuk p’e kryen letërsinë, e kryen ma kollaj. Qy atje po mbetësh mrapa me provime”. Pernime nuk mujsha me arritë sukses. Se ti Fakultet Teknik duhesh m’i kushtu rëndësi shumë të madhe, kohë shumë. Na shpenzojshim kohën kah pak edhe nëpër veprimtari e nuk mujsha me mrri sukses ashtu t’dëshirueshëm qysh e kërkojke profesioni.

E regjistrova Fakultetin e Filologjisë, drejtimi letërsi. Po tash ish e pamundur m'i përcjellë te dyja. Unë ashtu me mend t'rive menojsa që dyjat kom mujt m'i vazhdu po kur e regjistrova letërsinë, aty qysh me thanë, edhe lëvizja u ba, u intensifiku ma shumë. Edhe veprimet, veprimtaria u bo pak ma e dendur e nuk kish gjasë m'i vazhdu dy fakultete. Këtu me mësim pak ma t'thukët, i jepsha provimet shumë ma lehtë. Atëherë e braktisa krejt elektron edhe ju përkushtova plotësisht letërsisë. E vazhdova qishtë deri në prag të luftës, deri '97-ten. Kur u martova m'pat' mbetë pa e dhanë letërsia botërore, atëherë tek kom diplomu mas martesës, mas luftës.

Anita Susuri: E me bashkëshortin e ju si jeni njoftu si dy t'burgosun a në aktivitet apo si?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Bash jemi njoftu në aktivitet. E kom njoftë për herë t'parë në tubimin e parë publik të Pajtimit të Gjaqeve në Shtupeq të Madh në mars 1990. Domethonë ky me vllaun e vet Selmanin që osht' tash hero i Kosovës kanë qenë ndër organizatorët kryesor të atij tubimit. Edhe pse tubimet janë mbajtë kështu nëpër oda e ambiente gjysmë të hapura, këto me thanë, këto tubimet e fillimit të Pajtimit të Gjaqeve. Por tubim i madh gjithëpopullor, janë kanë normal raste të përgatitura ma herët, prej grupit të pajtimit të Havës e të Mirvetes e ktyne veprimtarëve t'parë.

Po për me dalë m'u falë publikisht gjaqet në ni vend ku mujnë me marrë pjesë shumë njerëz ma e përshtatshmja u kanë Rugova. Tubimi përgatitor ish konë pasë majt dikund nja ni javë ma përpara në shkollë të Drelajve. Po osht' pa si ma e arsyeshme me kanë me ni fshat edhe diku pak nashti ma larg prej mundësisë ku policia mujnë me ardhë me prish tubimin. E kanë përzgjedhë Shtupeçin e Madh, tash osht' ledina e Pajtimit të Gjaqeve, ajo ledina ku osht' majtë.

Aty unë pata dalë me vëlla edhe me motra edhe e kem pasë ni rast në familje, na ka pasë vdekë djali axhës, e ish pak si me thanë, herët me dalë nashti prej t'pamës t'familjes me dalë n'tubim. Po rëndësia e tubimit ish e madhe edhe vendosëm na me dalë, mos m'u shkëputë. Tash aty e kom pasë ni shoqe, Hasime Shkreli. Unë t'u folë me ta, po më thotë, "A p'e njeh qata, ai osht' nipash i jemi Sali Lajçi i burgosun politik". Unë edhe ma herët veç kisha dëgju për to se e kom pasë në klasë që thashë edhe ma herët vëllaun e Nasir Salihit që janë kanë këta bashkë në burg. Këta dytë ishin kanë bashkë edhe Nasiri edhe Salihi.

Tha, "A ke qef m'u njoftu me ta?" Thashë, "Po", i burgosun politik, a din, mezi pritsha m'u njoftu edhe të Rugovës nuk osht' që e kisha njoftë. S'kisha pasë shumë rast m'i njoftë t'burgosurit politik. U njoftum me to qaty po tash n'qat' tubim përveç pjesës të Pajtimit të Gjaqeve që ishin këta veprimtarët, grupi themeltar i pajtimit të angazhun edhe Salihi që u kanë me ta. Pas tubimit u kanë edhe ni pjesë tjetër Lidhja Demokratike që u kanë lëvizje gjithë populllore n'atë kohë, e ka pasë nifar' programi për me organizu tash edhe Lidhjen Demokratike.

Tash Salihi po m'thotë... unë t'u e shkru ni fjalim thashë, "Nëse m'jepet rasti me lexu n'tubim p'e lexoj", edhe me përfshi pajtimin e gjaqeve edhe në përgjithësi lëvizjen gjithëpopullore t'viteve të '90-ta. Edhe thojsha hera e parë edhe çka t'më jepet rasti me thanë, me shprehë atë ndjenjen tem mas burgut. S'kisha pasë rast ndonjë vend publikisht t'ja jepi vetit qat' mundësi, n'qoftëse ma lejojnë organizatorët.

Ai tha, "T'kom pa që je t'u shkru diçka edhe e kom ditë që je t'u pshtjellu", m'tha, "mos hi n'organizim kështu të Lidhjes Demokratike", thashë, "Pse?" Tha, "Ka boll kush merret me Lidhjen Demokratike, na kem detyra me t'rëndësishme", thashë, "Pse?" Nifar' mënyre pse bash ti po m'thu, kush je, n'atë kuptimin, kush je ti me m'thanë (qeshë). Tha, "Po qe, edhe me Naserin edhe me krejt këta shoktë e kem vendosë që me ndihmu sa t'mujmë edhe organizimin legal kështu edhe t'gjitha lëvizjet çka janë legale po na me qëndru pak ma anash. Se kur vjen puna për ndonjë veprimtari që osht' ma e vështirë edhe ni organizim ma thelbësor për kryengritje kështu t'jemi pak ma të anun".

Unë meta me Ali Muriqin me ni kusheri temin që e përmenda edhe niherë edhe me do të tjerë deri n'fund t'tubimit. Aty nuk jom pa ma. Dikur kom fillu m'u taku me ta masi u organizu këshilli i organizimit të Rugovës, [Zymer Neziri](#), Selman Lajçi edhe të tjerët kush janë kanë, Isa Nikçi e Mujë Rugova anëtarë tjerë që janë kanë të lëvizjes të pajtimit. Po aty normal që u kanë e mirëkuptueshme edhe u kanë noshta edhe e domosdoshme çdo grup, çdo këshill edhe ma i vogël i pajtimit t'gjaqeve me pasë vajza.

M'tha, Salihi tha, "Osht' mirë me ardhë n'grup tonë të Pajtimit të Gjaqeve", thashë, "Po unë kom pasë qef me Havën, kom pasë qef me grup t'atynë", tha, "Hajt ti Hava e ato kanë vajza boll. Tash u zgjeru grupi te ato. Na në Rugovë nuk osht' që e kem dikun kështu që i kish përfaqësu ni klasë t'vajzave edhe t'grave të Rugovës që me pasë mundësinë me hi nëpër oda edhe nëpër shtëpi, nëpër familje të Rugovës me lyp gjak". Aty me motrën Ajshen, me motrën tem me pajtu gjaqet. Me Sahadete Kelmendin ni shoqe që masanej s'jam nda edhe me ata edhe në aksione të tjera.

Me Havën Nikçin e me do vajza tjera kemi shku thujse në çdo aksion, në çdo rast. Kudo që ka qenë nevoja nuk ju kemi nda këshillit të Pajtimit të Gjaqeve derisa u pajtu gjaku i fundit. Derisa me thanë osht' mbyllë Lëvizja e Pajtimit. Po kryesisht jom konë nëpër raste që janë konë qito t'zonës, të Rugovës edhe qityne fshatrave përreth.

Anita Susuri: A ju ka mbetë n'kujtesë ndonjë rast specifik?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, rasti ma specifik t'cilat unë jom kanë e pranishme ka qenë rasti i faljes t'gjakut të Deli Muriqit, që e ka falë Qerim Muriqi. Tash osht' dëshmor i Kosovës që u vra në demonstratat e para në Pejë pas vrasjes së Jasharajve. Ai u kanë rasti ma delikat. U kanë rast i vështirë se edhe për arsye se u kanë vështirë edhe ata me falë gjakun edhe u kanë rast i vështirë pse kanë hezitu bukur shumë familja e tyne me falë gjakun. E këtë rast, bile Zymer Neziri e ka t'shënu te librat e

tij të Pajtimimit të Gjaqeve e domethonë janë bo shumë përpjekje derisa u kurorëzu me falje. Po edhe raste tjera ka pasë që janë kanë raste, a din, interesante edhe që janë kanë raste t'dhimbshme.

Anita Susuri: E ky që thatë paraprakisht a ka, a osht' vra i ri apo osht' vra... pse ka qenë i vështirë m'u falë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po u kanë i ri, po për familjen e tyne u kanë e vështirë me falë, u kanë i ri po u kanë rast që u lidhë me ni vrasje, me ni vdekje tjetër edhe me ni vdekje tjetër. Dy vdekje janë lidhë për qit' rast, a p'e din? Diqysh u shku si zinxhir edhe osht' menu si shkakëtar, me thanë, i vdekjeve. Ajo pala që ma s'pari e kanë vra këta, vllaun e ktina e kanë menu si shkakëtar këta edhe pse t'gjithë na si kusheri e kështu e kena konsideru që nuk u kanë fajtor. Po tash osht' vështirë me gjyku. Për atë rast u kanë shumë vështirë me gjyku po e mira osht' që osht' pajtu, a din. Osht' si me thanë histori n'vete rasti i tyne.

Anita Susuri: Për shembull çka ka qenë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Lidhje familjare, fejesa e tillë.

Anita Susuri: Raste për shembull kur ka ndodhë kjo, kjo në këtë fushë, Fusha e Pajtimimit, qysh ka qenë atëherë atmosfera?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, atmosfera u kanë shumë madhëshore. Ka pasë njerëz prej t'gjitha anëve të Kosovës. Ka pasë media t'huja edhe qato të Kosovës që janë kanë. Ka pasë nifar' frymëzimi u kanë i madh për diçka që duhet me ndodhë edhe osht' t'u ndodhë. Përtej Pajtimimit të Gjaqeve u ditë që po qëndron qëllimi suprem i pajtimimit për ni luftë e cila ka me na sjellë lirinë. Ka pasë profesor të universitetit e njerëz me ndikim e njerëz që kanë pasë gjaqe ma herët e të burgosun politik. Domethonë u kanë ni atmosferë madhështore që menoj që osht' e papërsëritshme.

Jom kanë te Verat e Llukës masanej, jom kanë edhe nëpër tubime kështu gjithëpopullore kudo në Kosovë. Po nashta ajo që u kanë tubimi i parë i fillimit edhe që njerëzit kanë mujt me thanë me gojën plot në ni vend t'hapur, "T'qoftë falë gjaku për hir' t'rinisë të Kosovës edhe tjerë të Kosovës edhe gjakut të demostruesve", që u vrajshin nëpër demonstrata, u kanë shumë madhështore.

Anita Susuri: Ka pasë shumë njerëz sigurisht?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, ka pasë shumë njerëz. Ma pak ka pasë shumë, shumë, shumë ma pak sesa në tubimet gjithë popullore që janë mbajtë nëpër Kosovë ma vonë. Po ky osht' tubim karakteristik se osht' i pari edhe osht' i pari i hapur edhe i pari që nifar' mënyre ka dhanë modelin edhe atyne familjeve që e kanë pasë vështirë me falë gjak se si duhet me tejkalu vetveten edhe me bo diçka për hirë të së përgjithshmes.

Anita Susuri: N'këtë kohë domethonë prej pas burgut vitet e '90-ta thatë që keni vazhdu me disa aktivitete edhe me fakultetin. Po a jeni angazhu edhe n'diçka tjetër, në punë ose...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Jo. Në punë përveç qishtu punëdore që kom pasë nevojë për pare, që kom kepë veshje të Rugovës, qisi veshje kombëtare edhe veshje të tjera kur kom pasë nevojë. Nuk kom bo naj punë kështu të tillë që paguhet. Po me aktivitetet po. Domethonë edhe para '90-tës unë kom marrë pjesë në të gjitha aktivitetet që janë organizu në Prishtinë, në Qendër të Studentëve, në Shesh të Prishtinës. Në grevën e madhe të studentëve që u majt në sallën "1 Tetori", domethonë të gjitha këto. Se këto janë para Pajtimit të Gjaqeve. Demonstrata e madhe e Prishtinës m'ka zanë si studente. Aty bile osht' interesant se ka qenë demonstratë shumë e madhe...

Anita Susuri: Vitin '89 apo?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Vitin '89, po diku në janar. Meniherë në janar demonstrata e madhe mos kofsha gabim është e 14 janarit.

Anita Susuri: Nuk p'e di. A ka qenë para grevës a mas grevës së minatorëve?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Jo mas grevës së minatorëve u kanë demonstrata.

Anita Susuri: E atëherë mas...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Se greva u kanë në dhjetor a shkurt?

Anita Susuri: Shkurt ka qenë greva.

Zyrafete Muriqi Lajçi: E nashta i kom përzi datat. Ka mundësi që edhe i kom përzi datat. Te dyjat, qito dy si ma kulmore se çdo aktivitet që u majt mrena Qendrës së Studentëve, pastaj demonstratat në përkrahje të liritimit të Adem Demaçit. Ajo demonstratë u kanë. Se ajo u ba si me thanë tubim i studentëve për me, si me thanë, me përshëndet lirimin e Adem Demaçit ose me thanë mirëseardhjen për lirimin e Adem Demaçit, po ajo u shndërru në demonstratë.

Ajo e tjera e tjera plot që janë kanë në Qendrën e Studentëve n'qat' kohë. Që u fillojshin si ni tubim i studentëve e na rrethojshin policia na gjujshin, qitshin gazin lotsjellës, na shpërndajshin. Ajo demonstratë u kanë. Po për qit' demonstratën që m'kujtohet ni rast për me tregu. Na dolëm me motrën edhe me cimere tona që i kem pasë, atëherë banojshim në banesë private, qit' shoqen Sahadete Kelmendi. Vendosëm na m'u kap dora dora se shumë njerëz edhe mos m'u ç'kapë. Nëse na shtyn turma na kurqysh mos m'u ç'kapë.

Kur kanë sulmu ata... e kom pasë edhe ni tezak vëllaun e Adrian Krasniqit, Ilir Krasniqin e, po ata janë kanë pak ma larg neve, ma afër tenkave. Tash kur kanë gjujtë ata me ujë, ato tenkat me ujë që janë kanë edhe turma ka lëvizë prej asaj ane knej kah na ku jem kanë. Tash u ba nifar' lëvizje e turmës e përnjëhershme edhe nifar' muri i vogël u kanë aty te sheshi. Tash na me kapërcy qat' murin nuk na lejoj turma. E nxun qat' çikën, Sadetin, i ranë gujt aty n'atë murin edhe kish rrezik shumë për me shkelë turma.

Na të shkretat t'u munu për mos me shkelë ata, nejtse edhe do djem plot i nimun, diqysh e nxirrën e shkun. Po u ndava unë prej tyne. Tash u përfundu demonstrata, u shpërndan. Metën si me thanë veç qata shallat kuq e zi edhe kapuqat e bardhë nëpër krejt ata lisat e Prishtinës që janë, që gjithë e kom atë pamje. Po u ndava unë prej tyne. Ato shkun dikah motra me atë shoqen. Na hijmë me demonstruesit çka kem me ni shitore qaty, ma e afërta që ke.

Tash kur hym aty, ai gazi lotsjellës që e kishim thithë na munojke shumë. Aty s'kish ajër edhe na shumë njerëz. Çka me ba? Me dalë, qysh me dalë u mush sheshi policë. Mos me dalë qysh me nejt, dojshim me kop. Ajo ish kanë shitore me kështu gjana tjera, nuk kish pasë bile me pasë naj kepë me gjetë po veç me këso tjera t'ngurta. A plasëm na t'u u kull prej atij helmit që kishim marrë me gaz lotsjellës. Edhe po thojnë do djem thanë, "Po dalim. Na marrshin na marrin le t'bohet çka t'don ma mirë se me kopë". Po dalim.

Tash do djem t'kujdesshëm se na shumë vajza, shumë djem edhe njerëz ma t'pjekun ka pasë po kryesisht ishim rini. Tha, "Nëse dikush kah Mahalla e Muhaxherëve unë po du me shku qatje, naj vajzë nëse tutet me shku vetëm që s'ka me kond me shku po dalim bashkë", thashë, "Nëse bon unë me ardhë se qatje e kom banesën se jom da prej shoqes e prej motres e nuk guxoj vetëm me shku", tha, "Hajde", edhe tha, "kapu për mu kishe jemi bashkë si çift edhe mos i kqyr".

Dolëm na qashtu as mos m'i kqyrë mrapa këta demonstruesit e tjerë a po dalin as anash. Ata do shkojshin, do polic, a beson, i shkelshin kapuqat e bardhë me kamë apostafat aty. Dulëm na qashtu bashkë, m'përcjelli deri te banesa e kurrë ma nuk e di as kush u kanë. Kështu ia kom pasë majt mend mbiemrin ni kohë po tash me pasë mundësi tash e kisha falënderu sa m'ka pasë ardhë mirë prej gjestit që e pat' ba. Se nuk ish veç me dalë n'demonstratë, del brohorit edhe shko. Po pasojat pas demonstratës janë kanë shumë t'mdhaja, tona herët, dihet.

Anita Susuri: E motra e shoqja?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Motra e shoqja kishin pasë mrri në Dragodan e masnej kah Xhamia e Llapit e atyne lagjeve anej e mezi me mrri te Mahalla e Muhaxherëve. Dikur kur mrrina une u ba merak ai i zoti shpisë edhe ajo gruja. U bonë tepër merak e thanë, "A t'dal t'i lypi?" "Jo more se po t'nxajnë ty", thojsha, "ato Prishtinën e dijnë pa ardhë nuk e lanë". Erdhën dikur ma n'fund. E qaq t'mirësjellshëm e t'kujdesshëm janë kanë edhe ata t'zot e shpisë ku kem banu që u kujdesshin meniherë me na ndrru

teshat se thojshin, “Mos po vijnë e ju hetojnë, i keni kpuat me lloq”, thojshin, “Ndrroji këto tesha mos t’ju hetojnë”.

Po ashtu nëpër shpija ata s’kanë pasë llogari se ashtu veç me marrë krejt Prishtinën me burgosë se nuk ka pasë shansë tjetër. E për Grevë të Minatorëve, grevën e studentëve që e kena majt pas Grevës së Minatorëve që e kem majtë në sallën 1 Tetori po ashtu e kom ni rast goxha interesant, që mu m’doket interesant tash se a din... na aty shkojshim, ni javë kem pasë nejt edhe veç shkojshim n’banesë hajshim bukë ose kaniherë besa blejshim bukë e hajshim aty edhe m’u ndrru edhe me ardhë me nejt non stop aty. Edhe natën rrishim, u ndrojojshim me ndrrime.

Tash aty na bike m’u njoftu edhe me student tjerë e me njerëz tjerë se aty ka pasë plot, a din. Tash aty afër ishin kanë do djem të Suharekës, që dikur ma vonë jom pasë njoftu. Bile me ni grup ma të ngusht të tyne edhe kom pasë vepru. Tash ata djemtë, a din, kur thanë po shpërndahe greva edhe duhet me dalë, a din, me dalë krejt, me lshu sallën. Na e ditëm që aty ndalje t’dyrve t’mëdha kontrollojshin policia. Ata djemt e kishin pasë ni allti me veti. Tash i kanë thanë motrës, “A ka mundësi me na ndihmu diçka?” Na i kishim aty afër po nuk osht’ që hishim kështu n’biseda po qito parulla, qito që ish m’i thirrë t’gjithë përihere.

Normal si n’grevë që je. Kjo ka thanë, “Po te shohim”, ka thanë, “Masi jeni vajza, nashta juve nuk ju kontrollojnë. Kem diçka me veti, a bon me marrë?” Kjo menon material propagandistik naj gazetë a diçka. Thotë, “Po more, s’ka problem”, s’po di edhe kjo motra jeme nuk osht’ bash e urtë, nuk po di, për me ua qit’ n’mend atyne që nuk osht’ që jem t’sigurta as na. Thotë, “Jo valla osht’ pak ma e ranë, ka diçka që osht’ pak ma. Veç nëse mun, nëse s’mun nuk ju rrezikoj. Po hini ju përpara, nëse p’e merni parasysh me ndihmu, na po rrim aty afër. Nëse diçka na marrim përgjegjësinë”.

Po m’thotë, “Qishtu, qishtu po m’thojnë qita djemtë”, thashë, “T’kahit janë”, tha, “Të Suharekës”, thashë, “Po more”. Nejshe pak u vetëm me ata qishtu e i vetëm për do njerëz edhe ata mu. Kjo i ka thanë dikur, “Po kjo e burgosun politike, mos p’e nxan”, tha, “Jo mos rreziko, mos rreziko”, thashë, “Po more, hajt se s’o kijameti. Nëse na kontrollojnë po shmangëm diqysh nëpër njerëz edhe p’e bajmë këta”...

Anita Susuri: Ju thatë që pastaj keni vazhdu edhe me Lëvizjen Popullore të Kosovës?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, me lëvizjen popullore jom lidhë, domethonë, përmes Salihit. Se ky i ka pasë të burgosurit politik që i ka pasë në lëvizje, i ka njoftë njerëzit. Po masanej masi jom njoftu me Salihin e kem fillu veprimtarinë në pajtim të gjaqeve, në shkrime për Republikën e Kosovës, në kuadër të Shoqatës Nënë Tereza aktivitete kur ka pasë normal edhe aty jom angazhu. Normal që unë te këta, te familja këtu edhe që s’jom kanë e fejune me Salihin kom ardhë shpesh.

Përmes Shoqatës së Intelektualëve në të cilën u kanë Selmani, Lëvizjes të Gjelbert, çdo aktivitet që ka qenë që u lidhë me këtë familje pastaj jom kanë në kuadër. Nuk osht’ që Shoqata Sanxhaku e

Kosovarëve ka pasë nifar' programi që m'i marr studentët shqiptarë m'i dërgu me studiu në, vise të përzgjedhura janë kanë, në Austri, e Turqi e kështu me kriju lidhje me Sanxhakun. Lidhje, si me thanë, pak të shkëputura. Këto aktivitete pastaj jom kanë si me thanë e njoftune jom kanë tona herët, kur kom mujtë me marrë pjesë kom marrë kur nuk kom mujtë nuk kom marrë. Po ose unë ose Salihi ose Selmani qysh me thanë patjetër ndonjani prej neve u kanë në aktivitet, u kanë e pamundur.

Bash bash n'mbledhjen e parë t'lëvizjes kom hy kështu, u kanë '91-ten, masi u liru Sylë Muja prej burgut këta anëtarët e lëvizjes i kishin pasë dërgu ftesë Salihit për mbledhje. U kanë mbledhja përgatitore e këshillit të përgjithshëm të lëvizjes. I kishin thanë, "Nëse munet dikush prej Rugove me ardhë me përfaqësu zonën në mbledhje po preferenca jonë ish kanë me ardhë Sylë Muja masi u liru prej burgut", edhe plus që osht' njoftë me t'burgosur politik të Nishit, me [Hidajet Hysenin](#) e me tjerë t'burgosur që janë kanë atje.

Po siç u kanë puna se atëherë komunikimi Prishtinë-Pejë u kanë i vështirë shumë ose përmes ni shokut. Për këto raste dikujt shumë t'besushëm. Ose naj telefonatë e njerëzve që kanë pasë telefon kështu t'shpisë, me shifra. Se ti s'ke guxu fort me thanë ashtu çeltas. Edhe tash i kish çu Salihi ni kusheri t'vetin edhe na si nipash e kem Mustafë Lajçin. N'konvikt po m'thirrë tha, "T'ka çu fjalë Salihi duhet me shku dikund", thashë, "Ku?" Tha, "Ti ki me shku te Shaban Muja", te Shaipi, unë e njifsha Shaipin se këto organizimet në kuadër të Unionit të Studentëve që u mbajshin.

Tha, "Te Shaipi osht' vëllau i tij Shabani, Magjupi [nofkë]", a din, besa s'më tha Shabani hiç po tha, "Te Magjupi, vllau i Shaipit. Ke me nejt qaty me prit vjen dikush me t'marrë", tha, "se qëllimi u kanë me shku Sylë Muja po ti atyne ju thu që ata të Pejës m'kanë thanë qishtu që me ardhë unë n'vend të Sylës". Shkova unë aty, po pres, po pres. U kanë dimër, ftoft. M'duket u kanë janar ose shkurt. Janë datat dikund, i kom gjetë edhe n'internet po qe tash m'ka dalë prej menve.

Erdhën Fadil Fazliu, Tahir Gjonbalaj, unë me ata u njifsha. Isha kanë te familja e Fadilit disa herë edhe për përvjetoret e djemve, atij të Fahriut edhe të Afrimit. Me Tahirin u njifshim se kishim organizu qështu në kuadër të Lidhjes Demokratike tubim edhe atje në Plavë po edhe ata ishin kanë mysafir në Rugovë edhe për 28 nëntor tubime kështu që majshim me rastin e 28 nëntorit në Rugovë. Njifeshim, ishim, si me thanë, kështu nuk e kisha frikën që nëse ata m'gjejnë aty tash thonë kumeditë çka osht', kah p'e lidhë ose kështu.

Erdhën ata dy, po thotë Fadili tha, "Ku o' Sylja?" Thashë, qishtu qishtu, "M'kanë çu fjalë ata të Pejës që unë me përfaqësu Sylën", tha, "Mirë s'ka problem, ti ki me ardhë me neve edhe kemi me shku". Fadili, Tahiri, Shabani me pseudonimin Magjupi që e ka pasë edhe normal Shaipi që e dike që jem na. Shkum atje në Keqekollë, ni fshat, jo Keqekollë, Prapashticë. N'qat' mbledhje mesa mua m'kujtohet jom kanë veç unë vajzë. A din, gjithë e kom menu nifar' fakti se thojsha me bo m'u nxan, veç unë vajzë aty, a din, qikjo që the ti me thanë tanë këta burra kjo nashta s'ka qëndru i ka qit' kjo krejt këta. Qat' brengë e kisha.

Se nuk e kisha brengë që burgosna e kështu se tash kisha përvojë e nuk e kisha atë kasavet hiç. Po thojsha me bo m'u zanë aty sa dokumenti e sa letra e sa njeri e. Sa ishin liru njerëzit prej burgjeve e çka, qysh me rezistu unë n'gjithë qat' rëndësi që e kish ajo. Po u mbajt edhe ajo mbledhje. Aty i pata pa edhe do njerëz që nuk e disha që janë n'lëvizje, Ibish Nezirin. E disha që osht' i burgosun politik edhe që ka majtë dy herë burg politik. Kisha kështu njohuri edhe rreth familjes e diçka po nuk osht' që e kisha njoftë që osht' anëtar i lëvizjes. Feriz Hotin që e kisha koleg të Fakultetit Teknik e që nuk e disha që osht' anëtar i lëvizjes.

E disha që osht' shok me ni djalë që m'kish ofru mu mundësinë me hi n'lëvizje. Po unë t'u e ditë që e kom me Salihin isha lidhë me lëvizje e ai Isa Krasniqi që m'thojke për m'u kyç nuk kisha qysh m'i thanë as po as jo. Me thanë që jom n'lëvizje dekonspirim, m'i thanë po, po hi unë veç isha hi përmes rrjetit tjetër...

Anita Susuri: Çka kanë qenë aktivitetet tash t'juja konkrete, puna juj në Lëvizjen Popullore të Kosovës?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Si me thanë, detyra jonë konkrete u kanë me organizu lëvizjen për Pejë, këshillin e rrethit të Pejës. Në kuadër të qatij këshilli me marrë detyra n'bazë të rrjedhës edhe dinamikave që i përcakton lëvizja në Prishtinë. Ose dega e lëvizjes për Kosovë ose mrena venit qysh u qujke atëherë. Që u kanë caktimi i celulave, sigurimi i celulave, caktimi i materialit. Jo veç propagandistik, se propagandistik atëherë u kanë, jo e tejkalueshme plotësisht, po munësh me qijtë nifar' mënyre edhe mos m'i kushtu rëndësi t'madhe qaq sa u kanë për m'i kushtu rëndësi, krijimit, si me thanë, sigurimit të materialeve t'cilat na përgatitin për kryengritje.

Domethonë naj fishek, naj armë e bile s'paku revole, qisi armë t'vogla. Naj dinamit, çkado qoftë. Materiale tjera që na qysh e planifikojshim atëherë, shëndetësore. Në rast se dikush plagoset në aksion ose diçka me mujtë me ia dhanë ni ndihmë t'parë pa pasë nevojë me çu në spital me dekonspiru. Me i hulumtu njerëzit, me i detektu njerëzit që janë besnik edhe që janë t'gatshëm për me vepru për veprime ma serioze. Se tash masi dul Lidhja Demokratike edhe këto lëvizjet legale që ishin publike që dolën n'skenë atëherë ma nuk kish nevojë me shpenzu kohë m'u marrë me ni lëvizje që u merrke krejt Kosova. S'kish ma sens ajo punë.

Për ato na patëm organizu pastaj... Hidajete Krasniqi që u kanë përgjegjëse kryesore edhe [Ibish Neziri](#), po Hidajeti u kanë kryesore patën organizu mbledhjen e Këshillit të Rrethit të Pejës. Që e kem majtë në shtëpinë e Agim Elshanit në Zgjim. Aty i kemi nda, si me thanë, detyrat edhe sipas rretheve ma t'vogla. Neve konkretisht, jom kanë unë, Salih edhe Nezir Nikçi që kem marrë përgjegjësi, edhe Shkelzen Muriqi se harrova, Mustafë Lajçi nuk u kanë n'qat' mbledhje po edhe ai e ka pasë qit' përgjegjësi për me organizu Këshillin e Rrethit të Rugovës.

Po paraprakisht na kem bisedu si shokë të burgosun politik edhe si shokë që jemi t'gatshëm me vepru për me bo ni Këshill të Rrethit të Rugovës. Kështu masi Rugova osht' ni vend me karakteristika gjeografike të caktuara, osht' n'kufi me Malin e Zi, osht' e mundur me shku në Shqipni prej Rugove, osht' e munshme m'u lidh me Mal të Zi ma shumë. Përmes Plavës e Gucisë po ashtu me kriju lidhje në Shqipni edhe kishim shokë anej t'organizun. Me kriju qito celula, qito baza edhe me pru sa t'kem mundësi me pru naj armatim diçka çka osht' e mundshme.

E kishim na qit' Këshillin e Rrethit të Rugovës po që nuk ish këshill i rrethit të lëvizjes për Rugovë, a din. Se qaty n'qat' Këshillin e Rrethit të Rugovës ka pasë edhe anëtarë tjerë, nuk janë kanë qita që i përmenda që jem kanë anëtarë t'lëvizjes. Po meqenëse ishim na, ish Selmani, ish Sali Muriqi që e përmenda profesori. Ishim na do që janë kanë edhe ma herët t'organizun me Salihin po që s'janë ra në burg me grupin 'Pavarësia'.

Atëherë na e kishim pak ma t'lehtë. Se e kishim thanë anëtarët tanë që kishim mbështetjen kryesore edhe përmes atyne, na konsiderojshim që s'ish fort e rëndësishme a po i thojnë a je lëvizje a s'je lëvizje. Po a ke ndërmend me kry qit' aksion, a munësh me shku, për shembull, te filan fisteku me kry qit' detyrë. Qikjo ish qajo strategjia që na e kishim planifiku me zbatu. Plus i kishim këta shoktë që i kishim jashtë. Salihi për shembull e kish Ujkan Nikçin, Naser Salihin, Ibrahim Nikçin që osht' tash po ashtu dëshmor i Kosovës. U vra n'fakt mas lufte në rrethana t'pasqaruara. Menjëherë pas çlirimit të Kosovës po ushtar i UÇK-së ka qenë edhe i burgosur politik.

Tash na i kishim lidhjet edhe me ata edhe në bashkëpunim me ata, Ujkani që ish i organizun për lëvizjen jashtë vendit, ishin organe kyçe jashtë vendit na i kishim shumë t'qarta pikat kah po dojnë me ecë. Plus ish liru Ali Lajçi prej burgut edhe Riza Dema e Sylë Muja. Nifar' mënyre i kishim mundësitë goxha të mira për m'u organizu që ni moment të caktun historik me kanë të gatshëm edhe me ditë me i marrë frenat n'dorë.

Me këta të lëvizjes të rrethit të Pejës pastaj me Ibishin edhe me Ganimeten e me Skender Krasniqin e me të tjerët, se s'po m'kujtohen emrat e t'gjithve krejt, i kem majtë lidhjet vazhdimisht. Domethonë edhe parapërgatitjen për luftën, luftën, mas lufte gjithmonë. Ndërsa për Prishtinë, lidhjen që e kem majtë me Lëvizjen për Republikën e Kosovës ka qenë Ramadan Avdiu. Domethonë vazhdimisht me ata po përmes tij normal që kemi njoftë edhe njerëzit tjerë edhe normal tash ti kur njihesh nuk munësh m'u paraqit me pseudonim para njerit që e njeh. Pavarësisht a e din a s'e di osht' organ i ngushtë i lëvizjes, ti je ai që je.

Anita Susuri: Pata lexu unë që shpija e ju j pastaj ka qenë si bazë për formimin e UÇK-së...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po. Shpija jonë...

Anita Susuri: Për Rajonin e Rugovës.

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, shpija jonë, shpija e Selmanit, se ai u kanë ma i madh se Salihi edhe na takon me thanë shpija e Selmanit. U kanë bazë prej viteve '90-ta e ma herët kur u formu Grupi 'Pavarësia'. Po për atë pjesë i takon Salihit me folë e Naserit e Ujkanit e ktyne tjerve. Po gjithmonë u kanë bazë. Po unë prej që i njoh këta edhe prej që kom ardhë për herë t'parë, që thashë mas Pajtimit të Gjaqeve në Rugovë, gjithmonë n'këtë shpi kom gjetë njerëz plot.

Domethonë t'organizun për t'gjitha lëvizjet. Për Shoqatën e Intelektualëve, për Lëvizjen e të Gjelbërve, për nënshkrime për Republikë të Kosovës që ka nisë në odën e Selman Lajçit, për lojra tradicionale të Rugovës, për qit' Shoqatën Sanxhakët Kosovare. Megjithëse atë ma shumë ka vepru motra edhe vllai jem, meqenëse edhe janë marrë me muzikë. Kanë pasë mundësi m'u organizu n'qato takimet që i kanë majtë me ata të Sanxhakut. Domethonë të gjitha e kanë pasë si me thanë fillesen në qit' odë.

Tash këta njerëzit kaniherë kanë nejt këtu, kaniherë kanë nejt në shpinë e Naser Salihit e Halil Arifit, te baba i tij që u kanë ni patriot shumë i madh. Vllau tjetër po ashtu që ka dekë prej kancerit që u kanë po ashtu i burgosun në Grupin 'Pavarësia'. Kaniherë te familja e Ujkanit, kaniherë te familja e Mustafë Lajçit, e Mustafë Lajçi tjetër. Domethonë te familja e Shkelzen Muriqit të burgosun politik e kështu. Po si me thanë strumbullari i tona strumbullareve u kanë në familje.

Bile unë kaniherë thom, na, unë edhe Salihi, shumë i hijmë në hak figurës së Selmanit se t'u pasë frikë që prej afërsisë, a din, mos po flasim n'atë kuptimin që prej afërsisë mos p'e përmendim veç Selmanin veç Selmanin jom munu diqysh për m'i ikë kësaj, kom thanë le t'folin tjerët. Po kaniherë s'duhet me kanë modest, duhet m'i thanë gjanat qashtu qysh janë. E pastaj Shtabi Rajonal i Rugovës, bisedat e para për Shtabin Rajonal të Rugovës janë majtë në shpinë e Selmanit. Unë atëherë jom kanë nuse po njerëzit i kom njoftë.

Takimet e para me Sylë Muriqin e me të tjerët e me Avdi Halilaj e me qit' Enver Saliaj që thashë vllau i qatij Naserit që thashë i burgosun me Salihin, qitu në odë të Selmanit janë majtë. Njerëzit, këta, kanë folë edhe nëpër intervista kanë thanë po mirë osh' me folë edhe ma shumë edhe me tregu. Unë e kom thanë aty te libri "Leksikoni i Grave", e kom thanë nashti me modesti, po unë jom kanë pjesë e qisaj familje që i kom pa me sytë e mi. Prandaj, me t'vërtetë familja, kjo shpija e Selmanit e meriton me kanë shpi muze në të cilën kanë nisë shumë lëvizje edhe legale edhe ilegale edhe kanë nisë fillesat e para të organizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Rugovë.

Pjesa e pestë

Anita Susuri: Pastaj vitet '97 thatë jeni martu, '98-ten veç janë vra Jasharajt...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Na jem martu në '96-ten, '97-ten ka lind vajza Uridia.

Anita Susuri: E '98-ten veç kanë qenë domethonë kjo ngjarje...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po.

Anita Susuri: Qysh ka ndiku kjo pastaj n'levizje t'juj?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po këta, se unë nuk jom kanë anëtare e shtabit rajonal, qitij shtabit t'parë, ceulës t'parë të organizimit të Rugovës edhe pse e kom ditë. Se unë e kom pasë tezak Adrian Krasniqin. Me Adrianin përveç që motra e ka pasë anëtarë t'grupit ilegal, Grupit 'Besa'. Motra ime Begija u kanë e organizune me ta, Grupin 'Besa'. Na jem taku në Prishtinë. Ai saherë shkojke në Shqipni, atëherë si i organizun për armatim e për çkado që ka shku, na jemi taku masi u ardhë.

Veç biseda e parë serioze që e kom ba me Adrianin u kanë kur u vra Armend Daci, kur u majt mbledhja e grupit të tij, për me shënu me demonstratë vrasjen e Armend Dacit. Në mramje ata ishin taku, grupi i Adrianit me Gzim Sejdiun e Nysrete Haxhij e Alban Neziri e t'gjithë këta që na t'gjithë njiheshim. Erdh te banesa jonë edhe po m'thirrë. Tash, dikush, s'e di kush e çeli derën tha, "Adriani", ajo motra msyni me dalë se ajo edhe moshatare n'klasë me to edhe n'grup.

Ai tha, "Jo po kom punë me Zyrafetin", m'thirri, "Tezake a bon deri te dera?" Thashë, "Hajde", se na ishim veç na tonat. Tha, "Jo, po kom ni punë me ty", tha, "a bon me na vu n'lidhje me Ali Lajçin", thashë, "Pse?" Tha, qishtu qishtu, "Puna ma serioze, e kanë vra ni student nashti ke ni", nuk po m'kujtohet a pata ni a s'pata ni, s'o t'u m'u kujtu. Tha, "Na e kem ndërmend me ba demonstratën ma radikale. Nuk e kem njet me nejt qysh kem nejt deri tash po po du me marrë mendimin edhe t'dikujt pak ma t'pjekun se nuk du me marrë përgjegjësinë. Vrahet dikush në demonstratë që me thanë qe çka bojnë. Boll u vra njo e m'u vra edhe dikush tjetër".

Thashë, "Tash natën ku me ardhë prej Prishtine në Pejë", ish e pamundur, thashë, "Unë lidhjen muj me t'i vu po për sonte jo", tha, "Ani hajde me mua", tha, "hajde", a din, "hajde në mbledhje, e kem ni mbledhje", tha, "edhe ki me ndigu krejt çka po flasim të nesrit me shku për Pejë edhe me folë me Alinë. Thashë, "Po po vi", edhe shkova. Secili i kish propozimet e veta po gjithqysh qëllimi ish që vrasja e Armend Dacit m'u shënu me ni demonstratë të madhe edhe me ni demonstratë ma radikale me rezistu forcave policore me ju tregu që boll osht' boll.

Po tash aty e lanë që t'nesrit dikush m'u taku me dikond, dikush me dikond. M'doket e përmenden Hydajet Hysenin edhe dikond, tash nuk osht' t'u m'u kujtu krejt. Po ke fjala, unë me ardhë në Pejë me taku Ali Lajçin. Nuk e di qysh, pse nuk erdha unë në Pejë. I thashë, "Jo ti në Pejë duhesh me shku vet", po m'duket që i thashë që nuk muj me ia prezentu mirë qëllimin a nuk e di qysh u kanë puna, tash e kom haru pak. Thashë, "Ti me shku në Pejë vet edhe nuk besoj që munësh me gjetë Alinë", se ai e ka

pasë shpinë në Treboviq edhe pshtjellt me gjetë edhe ti kur s'ke kerr, atëherë n'atë kohë me autobusa t'hupke dita.

Thashë, "Ti me shku te Salihi, te Selmani në Vitomiricë e kanë shpijen ngat rruge edhe qashtu i takon". Po edhe ashtu ish humbje kohe. Ai dojke me ardhë m'u taku, me marrë mendim m'u kthy. Thashë, "Po dal p'e thirri Salihin". E thirrsha ni telefon kështu t'shpisë që e kanë pasë. Thashë qishtu, qishtu, "Tezaku", e dike ai për kond o' fjala, "ka nevojë me bisedu me ty", tha, "Vallahi unë nuk muj me dalë po qe del Selmani edhe takohet me to".

Ish konë dalë Selmani e ka pritë në stacion të autobusave edhe e ka marrë janë shku te Ali Lajçi në Treboviq. Kanë folë e kanë bisedu e i kanë, çka kanë bisedu, diku besoj osht' e shpjegune nëpër librat e Adrianit. Edhe u mbajt ajo demonstrata. Mas atyhit dikur me Adrianin mbet i lidhun edhe Salihi, bile shumë ma tepër se une. Se u takojshin ma shpesh. Bile niherë i kish pasë thanë kështu çeltas, "Me na liru shpijen në Rugovë", "Pse çka po don?" Ky t'u e nguc, se ai... thotë, "Po m'vyn, mos m'vet veç me m'i dhanë çelsat". Vjen ai i merr çelsat këtu.

E tash ata e kom pasë tezak t'nanës ai tezake po ai i ka konsideru dajhtë tonë, t'mit edhe t'nanës tina dajhtë. E thotë, "Du me shku te dajhtë në Bralaj se ata s'rrijnë rahat, kanë diçka". Salihi e merr vesh e thotë, "Po more, s'ka problem", ia jep çelsat. Ai del me ni shok e shkon bjeshkëve, dajhtë atje në Bralaj, qatje te dajhtë e mi edhe furnizohet me tamon çka ka pasë njet ai me marrë. I bjen i len n'shpi tonë. Që nisa diçka me thanë, ma herët, çka ke pyetja për, për UÇK-në n'vitin '98. Po du me thanë fillesat i kom pasë pak para '98-tes përmes Adrianit, qita deshta me thanë.

Plus vrasja e Adrianit normal që u kanë ushtari i parë që u vra në uniformë edhe mërzia që e kem përjetu na mas vrasjes t'tij u kanë e madhe shumë edhe për shkak t'lidhjes familjare (qan) po edhe për shkak t'shoqnisë që kem pasë me ta. Tash kjo Salihin e ka pasë godit vrasja e tij shumë. Po tash na që kem pasë lidhje edhe me Lëvizjen për Çlirimin e Kosovës, me Bari Fazliun. Kur u vra Adriani, Bariu pat' kalu... se kjo osht' prap edhe ni temë tjetër, kjo pjesa me Bariun edhe lëvizja. Po kur u vra Adriani, Bariu pat' kalu këtë zonën e Dukagjinit i organizun.

Normal ndihmesa jonë u kanë e domosdoshme për me kalu ai në qat' zonë që e lidhë me Shqipninë. Tash na e kishim lidhjen me Tahir Gjonbalën. Unë isha kanë niherë në Shqipni me Tahirin edhe me ni të afërm t'tij të Tropojës atje, Rexhë Dollapi. E disha rrugën. Po tash me shku dy here për zonë kufitare ish pak e zorshme edhe isha martu. Atëherë po kom pasë edhe çikën kur u vra Adriani, ish e pamundur domethanë. Jo s'bohej fjalë domethonë gru me fmi t'vogël me shku edhe niherë nëpër kufi, nëpër mal. Ish e pamundur tash, po ish e mundur, me ia kriju lidhjen.

Tash unë përmes Bahrisë krijojsha lidhje e nëpërmes Salihit me Tahirin. Tash ai patëm dëgju përmes ni djali tjetër që u kanë në LKÇK që Bahriu osht' në zonë të Dukagjinit edhe konkretisht në Broliq, te këta Lulajt. Bile qitash p'e tregoj ni rast se m'lidhet me LKÇK. T'u shku unë n'takim me Bahriun, se unë jom

konë në treshe të Bahriut. A din, i kom njoftë edhe do shokë tij po atëherë me pseudonime nuk e kom ditë kush janë. Po kështu n'familje jom kanë disa herë e motrën e tij e disha që rrijke në ilegale me Bahriun e kështu. Po për m'u taku kështu me dy sy që thuhet, nifar' mënyre e kom pasë të drejtën veç me Bahriun.

Tash t'u shku unë n'takim, ai Ragip Lulaj, edhe ai i organizun në LKÇK, ai veç ish kanë. Tash atje na t'u shku, ku shkojmë kah Taslixhja, kur kalojshim n'fund të Velanisë ajo rruga që t'çon kah parku, tash unë dojsha, e kisha ngjit' nifar' rrugice majtas m'u taku me Bahriun. Ky, tash s'e di a ish taku me Bahrin se s'e kom vet, po me dikond të Lëvizjes për Çlirim po. Ai t'u dalë rrugës kështu përpjetë. Tash unë t'u e pa ata, ai t'u m'pa mua. Zona ish ku nuk ish normale me kanë. Se as s'ish zonë e banimit, na e dishim ku banojmë te dytë. As s'ish zonë e ligjeratave që i majshim nëpër shpija as kurgjo.

Ai po m'sheh për së largu edhe tash t'u menu ai që ma vonë kur folshim m'tregojke, a me përshëndet a mos me përshëndet. Ai u kthejke prej banimit ilegal, unë t'u shku n'takim ilegal me përshëndet a mos me përshëndet, na u njifshim. Thashë, po more po e përshëndes, edhe ma keq ish mos me përshëndet. "Çka po bon Ragip? A je mirë?" "Qe ti?" "Çka dole?" "Qe valla, qitu deri te ni shoqe", "Po qe edhe une deri te ni shok". Dikur ai me atë rrugë, Salihi m'pritke ma larg se ish rrezik m'u burgosë a diçka bile me ditë çka po ndodhë.

Tash ai t'u shku ma naltë takohet në Salihin edhe keshin këta. Thotë, "Qysh bre u bom t'panjofshëm njerëzit e njofshëm? Gjithë ditën po rrijmë bashkë", edhe dilshim nëpër ato lëvizjet e studentëve që janë kanë në Kodër të Trimave, në Kodër të Diellit. S'e di a i ka shpjegu dikush. Janë kanë takime për çdo natë. Korza u konë mbyllë, korza n'qytet poshtë edhe u majke si shëtitje e studentëve në Breg të Diellit. Nisshim te Furra e Qerimit edhe shkojshim rreth e rreth e deri n'fund atje te banesat e Bahriut e të Fahriut. U kthejshim prap qasaj rruge, e vishim deri te Furra e Qerimit, shëtitore. Po ajo ish për m'u takua. Ish me lëvizë. Thjeshtë karakterin e ka pasë me lëvizë, mos m'u nalë studentat.

Tash thojke, "Na për natë po dalim bashkë në ato takimet e mbramjes e tash s'po njihem", e keshnim qishtu me atë Ragip Lulin. Qishtu, që e lidha tash, tash kur ke puna me dalë për UÇK që deshta me lidh, tash kur kish çu fjalë Ragipi Salihit, "Hajde se kom atë shokun ktu". Na e dishim kush osht', që osht' Bahriu. Shkoj Salihi ish taku me Bahriun aty. Se kjo pjesë i takon Salihit me shpjegu, po masi ra fjala p'e përmendi. Bojnë bisedë qysh me dalë tash për kufi.

Salihu tregon thotë, "Unë vet nuk e kom shkel kufinin knej", kah kërrshi i ujkut që i thojshim ni pjese e me dalë atje, për Plavë e Guci, thotë, "Zyrafeti u kanë po tash e ka çikën e vogël s'bohet fjalë për këtë punë. Po muj m'i çu fjalë Tahirit edhe muj m'u organizu". Tash organizimi ka vazhdu. Ajo pjesa qysh ka vazhdu përmes ktyne djemve, nuk e di bash mirë. Nuk ka shku shumë gjatë u vra edhe Bahriu.

Tash qito dy goditje me Adrianin edhe me Bahriun që për te dyve, po thom unë, Adrianin e kom pasë tezak normal që m'u ka dhimtë edhe ka kjo ana familjare. Po Salihin e ka goditë shumë si shok e si

djalë i ri. I pari m'u vra në uniformë të UÇK-së shumë u konë pa mërzit. E kur u vra edhe Bahriu atëherë ma s'ka pasë të ndalun. Atëherë thojke, "Unë ka me dalë çeltas, nuk ka ma..." veç uniformat s'janë kanë ardhë e kështu, "Po krejt njerëzit që i besoj e që i njoh ka me ju thanë që veç kur të takohemi ni ditë në Rugovë edhe ta bojmë kështu çeltas organizimin".

Atëherë jem dalë na në '98-ten kah fundi i majit, a din, këta me Selmanin qysh i kanë kontakti njerëzit e qysh i kanë gjetë e... i kanë pasë ba do baza këtu nëpër Fushë të Pejës te do t'njofshëm që i kanë pasë. Familjen e Ibrahimit Nikçit që e përmenda pare, te do njerëz. Ato i takon ma shumë Salihit m'i thanë se masi nuk jom kanë, nuk i njoh, nuk osht' që m'takon m'i përmend. Dhe na patëm vendosë me dalë në Rugovë. Tash unë e Salihi edhe ni nipash i tina, u kanë, s'di a u kanë student atëherë a nxanës m'doket u kanë edhe dikush prej shokve t'tij që lëvizshin, u enshin. A din, herë në Rugovë herë në rrafsh.

Patëm vendosë me dalë në Rugovë me çelë derën edhe me thanë që qitu osht' shpija e filanit që po merret me qit' punë. Salihi e ka pasë kontakti edhe Ramushin, a din, edhe e kishim si me thanë, ato, si me thanë, udhëzimet e sakta edhe t'sigurta qysh me fillu. U vendosëm aty n'shpi. Atëherë Besnik Lajçi e këta të parët fillestarët e organizimit çeltas, se në Rugovë aty e ke marrë pushkën ke dalë për ledinë veç uniformat s'janë kanë ardhë hala.

Atëherë u kanë dera çelë për çdo ditë për kon do që ka dashtë për m'u organizu në emblemë të UÇK-së. Në qoftëse veç edhe ni kapuq e ke pasë me emblemë ose thjeshtë ni emblemë me uniformë kështu, pa uniformë po me rroba civile, ti je llogarit i organizun në UÇK. Atëherë qashtu, fundi i mujit, fundi i mujit maj ka shku qashtu, fillimi i qershorit masanej ka dalë edhe Selmani me familje. Se e ka pasë nanën plakë e derisa e ka tërhjekë edhe nanën, nuk ka mujtë me dalë me nanë plakë edhe 82 vjet i ka pasë edhe që ka pasë pak problem me ecë, me dalë bjeshkëve. U dashtë m'u organizu me ni formë, me post blloqe të policisë qyshdo koftë, me dalë në mënyrë kështu me automobil.

Kur u dalë edhe Selmani naltë pat' ardhë edhe Ujkani prej Gjermanisë, Ujkan Nikçi, atëherë ma veç pat' dalë legalisht kjo Ushtria Çlirimtare për Rugovë. Po atëherë nuk e ka pasë emërtimin e organizimit brigadë. Atëherë ka qenë e organizune si shtab rajonal i Rugovës edhe patën shku masanej për armët e para, armët e dyta. Se qashtu na e njehim, armët e para, armët e dyta, armët e treta. E dikur ka vazhdu kur u formu brigada në nëntor, atëherë Salihi veç u kanë pasë plagosë. Ka nejt i plagosun në Spitalin Ushtarak në Shqipni ni muj e diçka. Masanej ka ardhë qashtu i plagosun.

Masanej u bo riorganizim e mas asaj paqes së Holbrooke⁶ që u kanë ajo e ashtu quajtura paqja e Holbrooke, atëherë u formu brigada 136 Rugova. Prej aty pastaj ka vazhdu kjo pjesa ushtarake me gjithë organizimin me bataljone, me njësite qysh i takon organizimit ushtarak. N'atë pjesë t'organizimit

⁶ Richard Charles Albert Holbrooke (24 prill 1941 – 13 dhjetor 2010) ishte një diplomat dhe autor amerikan. Ai ishte i vetmi person që kishte mbajtur postin e Ndihmës Sekretarit të Shtetit për dy rajone të ndryshme të botës (Azia nga 1977 deri në 1981 dhe Evropa nga 1994 në 1996).

unë nuk jom kanë pjesë aty e strukturune. Unë normal që e kom ndihmu se Selmani u kanë zëdhendës i brigadës edhe Salihi edhe pse u kanë komandant ai ka ardhë naj herë n'shpi se na jem kanë zonë e lirë. Ushtria ka nejt në kazermë po janë kanë njësitet që e kanë mbrojtë prej të gjitha pikave zonën.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ishe t'u na tregu për fillet e luftës '93-ten...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po prej pjesës të organizimit të luftës të shtabit rajonal të Gjakovës unë përveç ndihmës që ka dhanë secila grua njësoj si unë, nuk osht' që jom angazhu kështu drejtpërdrejt në struktura të UÇK-së ose që kom dalë, për shembull, siç ka pasë shoqe që kanë dalë në front. Por, kom ndihmu për aq sa kom mujtë me ndihmu aty n'shpi. Meqenëse, thashë edhe niherë, që ka qenë, pothujse nifar' shtabi shtëpia jonë.

Për periudhat kur ka pasë shumë refugjat t'cilët kanë dalë nëpër Rugovë prej zonave të rrezikune, prej Dukagjinit e prej zonave tjera, edhe prej Pejës, të gjitha gratë e fshatit tonë edhe krejt Rugovës, ditë e natë janë munu që me ju kriju kushte bile s'paku derisa janë aty në Rugovë e prej Rugovës kanë kalu nëpër zona tjera në Shqipni e në Mal të Zi kudo që kanë shku. Çikën e kom pasë t'vogël, Uridijen. Djalnin Dritanin ende s'e kom pasë lind, osht' lind me 6 tetor pastaj në vjeshtë.

Me aq sa kom pasë mundësi me ndihmu qishtu n'qit' nivel siç ka ndihmu kunata jem, për shembull, kunatat e mia po thom edhe vjehrra, nuk osht' që jom angazhu diçka enkas. E vërtetë osht' që jom kujdesë për çdo dokument që e kanë pru ose Selmani ose Salihi ose shoktë e tyne. Për çdo letër që e kanë pasë t'shkrune, për regjistrat që i bojshin të ushtarëve, për ato jom kujdesë deri në ofenzivë. Në ofenzivë pastaj kur kemi arritë me dalë m'i marrë fminë dokumentet të gjitha kanë mbetë edhe janë djegë ose i kanë marrë kur kanë hi ushtria serbe nuk e dimë çka osht' fati i dokumenteve.

Anita Susuri: Ofenziva n'prill ka qenë?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Ofenziva ka qenë në prill. Në Rugovë ka fillu n'fillim t'prillit niherë me granatime në disa fshatra. Por luftime të mëdha janë zhvillu me 18 prill në Qafë të Hajles. Përpjekja e parë e forcave serbe që ka qenë e ushtrisë me ardhë kah Qafa e Hajles dhe zbrapsja e parë që ju ka bo prej UÇK-së dhe me 19 prill kur janë zhvillu luftime t'rrepta kur u vra Selmani, u vra Besnik Lajçi, Ramush Lajçi, Xhavit Lajçi dhe dëshmorët e tjerë të asaj beteje. Për Grykë të Rugovës kanë hy kanë hy edhe për Qafë të Qyqes.

Prej t'gjitha anëve, pikave ku ka pasë mundësi gjeografikisht kështu me hi. Se zona si zonë malore osht' e vështirë për me hi këmbësoria e ushtrisë armike kanë arritë me hi në Rugovë. Rezistenca u kanë boll e madhe po raporti i forcave u kanë shumë i pa barabartë edhe ka qenë e pamundur me mbrojtë

frontin pa u thy. Ni faktor tjetër që ka ndiku që nifar' mënyre rezistenca në Rugovë me marrë kahje tjetër kanë qenë të plagosurit e zonës të Dukagjinit që kanë qenë në Rugovë.

Në mes të territorit të lirë, kushtimisht të lirë, në atë kuptimin të mbrojtur prej Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe mbrojtjes së ushtarëve të plagosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u dashtë m'u marrë vendimi me i dërgu ushtarët e plagosur në Shqipëri. Ushtar ka pasë pak, ata ushtar që janë kanë u dashtë disa m'u kujdesë për popullatën civile. Disa m'i dërgu t'plagosurit kështu që ka ra territori si zonë e lirë. Jo krejt territori, ka ra ni pjesë e territorit po na si popullatë civile që jem kanë aty jemi detyru m'u zhvendosë.

Anita Susuri: Si jeni largu?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Ditën e, me 18 prill.

Anita Susuri: '99.

Zyrafete Muriqi Lajçi: '99-të kur filloj msymja kah Qafa e Hajlës që ish plagosë Xhavit Lajçi. Na në familje e morëm vesh që u plagosë Xhavit edhe pastaj vonë kur dolën ushtarët prej shtabit me marrë e me dërgu në mjekim të matutjeshëm diku në Mal të Zi, se në Shqipëri u kanë e pamundur përmes bjeshkëve me borë. Janë kanë edhe do mjekë të Pejës që kanë qëllu aty, e kanë konstatu që plaga e tij në kushte të tilla të luftës m'u trajtu edhe e dërgun Xhavitin atë natë në mbramje.

Na jem kanë aty në shpi edhe kem pasë edhe familjarë tjerë të familjes ma të gjanë që patën dalë ditëve të fundit pasi filloi m'u braktisë Peja pas sulmeve të NATO-s. Të nesërmen gjithë ditën ka pasë luftime në Qafë të Hajles. Këta, Selmani u kanë atë natë që e kanë përcjellë Xhavitin, u kanë në shpi, dul me Adnanin edhe me do shokë tjerë në front. Se fronti prej venit ku kem nejtë na... na kem nejtë me ni shpi, jo shpi tonë se u kanë shumë zonë të egër kështu malore edhe u kanë e pamundur në kushte të dimrit me nejt atje. Kem pasë dalë me ni luginë në shpinë e vllaut të Dritan Lajçit, që osht' ky Dritan Lajçi jurist që osht'.

Na kem nejtë aty edhe tash atë natë masi kanë përcjellë Xhavitin, Selmani u kanë aty natën. Në mëngjes herët kanë dalë te njësi i fshatit Pepaj për me pa si kanë shku luftimet e ditës përpara. Ndërkohë ka dalë edhe Salih me Besnikun edhe me këta ushtarët e tjerë, edhe ato luftimet që janë zhvillu atje janë ma shumë se ni orë verës me ecë në kamë, larg prej shpijave ku jem kanë na. Na i dëgjojmë e kishim të qartë që tanë ditën janë zhvillu luftime.

Po tash Besniku u vra shumë herët në mëngjes, Ramushi u vra pak ma vonë. Na morëm vesh, erdh lajmi në fshat që janë vra ata dy. Po deri në pramje na nuk e kem ditë qysh janë zhvillu luftimet, nuk na erdhën lajme tjera. Ato tjerat të kushërive krejt na familjarët që jem kanë, kryesisht gra me fmi se

burrat krejt janë kanë në front. Tash prej mramje erdh Salihi me ni shok të vet, me Avdi Lajçin, edhe po tregojnë që ai nuk e kish pa se ish kanë nda me Selmanin në front gjatë luftimeve.

Nuk e ka pa që u vra Selmani po masi u kthy prej ni pike ku ka vëzhgu mos po hijnë forcat serbe prej nifar' vendi që i thojmë na Hajla e Vranovcit, tash i ka thanë dikush që ai grupi që janë kanë t'u tërhjekë Ramushin, e Selmani u kanë me ta. Janë ardhë tanë veç Selmani nuk u ardhë. Aty na e morëm me mend që ka mujtë m'u vra. Bile, Salihi a din, ish mërzi e lodhë e luftime me borë në shokë që thuhet tanë ditën. E plus edhe përgjegjësia shumë e madhe për mos m'i lanë me hi forcat armike.

Po erdh hini mrena, i tha nanës të vet, qishtu... niherë na i shprehëm ngushëllime për Besnikun edhe për Ramushin e këta që e ditëm sigurt që janë vra. Tha, "Sipas fjalëve që m'i thanë ushtarët që janë ardhë, edhe Selmani osht' vra", po na tërheku vërejtjen mos me kajt kërkush. U kanë moment shumë, shumë i vështirë (qan). Nana vet i tha, "Deka osht' për burra", kom harru cilën fjalë, po ky, sa ish lodhë shumë e qysh ke pshtetun aty, a din, e qiti kryt qishtu {lartë}, normal i mërziun po kështu t'u u majtë e zuni gjumi.

Nja ni minut me thanë, erdhën e thirrën. Thanë, "Po të thirr in atje naltë në shpinë e Sylve", në shpinë e qitij Besnik Lajçit, "se kanë ardhë prej shtabit e duhet me qyrrë qysh me ia ba, se forcat serbe kanë shku ka ni fshat tjetër edhe duhet me ditë qysh me ia ba me popullatë civile". Ai shkoi, dola deri te dera me përcill. Thashë, "Çka me ba?" a din, "Çka me ba, qysh osht' fati i familjes tash?" Diqysh si në besim, thashë hajt te ves. Se ish motra e Selmanit e gruja e fmija, nana plakë e. Po nanën e ka pasë gru burrnore që ajo hiç, hiç nuk u tregu që po mërziut, u majtë shumë. Po prej qasaj që u majtë shumë besa u smu e vdiq mas lufte shpejt.

I thashë, "Çka me ba?" Tha, "Çka të bajnë krejt katuni edhe ju, mos luni prej shpije". Tash ajo, "Mos luni prej shpije", ish goxha e pamundur se tash ato situata u zhvillojke ndryshe, jo qysh e kishe planifiku ose qysh dojshe ti. Kem nejt na gjithë natën t'u pjekë bukë se thojshim vijnë ushtarët e s'kanë çka me hangër. E mërziut, si ajo natë mos u harroftë. Kem pasë edhe mesat aty, çikat e dëshmorit, Sokol Nikçit. Dilshim herë dy veta, herë dy veta te kodra me kçyrë mos po vjen Selmani (qan).

[Këtu ndërprehet intervista]

Tash na gjithë ditën kajtëm atë ditë për Besnikun se ishim edhe afër me familje të tij. Ai në fakt familjen e ngushtë nuk e ka pasë në Rugovë, po i ka pasë do mixhollar e do gra të mixhollarëve kështu. Shkum na me i shprehë atyne ngushëllime, u kthym. Tash kur erdhëm këtu në shpi te na, nana s'mujke me dalë, se të kallxova që ajo pak e kish problem me ecë. Na u ulëm qaty te nana, ka pasë qef gjithë kur vijshim prej dikahit me ju ulë afër e me i tregu.

Tha, "A ishin mërziut prej Besnikut?" U mërziut edhe ajo se ju dhimke, se si djem të vet m'i pasë. Na t'u i tregu qishtu, qishtu erdhën qito kunata e Drita Lajçit që thashë. Ato me na shpreh ngushëllime neve

tash për Selmanin. Po tash ato e panë që na s'jem t'u e ditë. Se na për Selmanin s'kishim nie. Nejtën pak u çun. Pijnë kah ni kafe, u çun. A din ishim kështu afër me shpija po s'thanë kurgjo. Na t'u thanë, "Qysh more na kqyrin qaq çuditshëm ato gratë?" Ato krejt t'u ditë e t'u ju ardhë zor, t'u pa që na s'jem t'u ditë. Na krejt bisedën, qysh u vra Besniku, qysh u vra Ramushi.

Qysh kur mirret vesh që u vra Besniku, diqysh familjen e ki dikond në Prishtinë e dikond, s'u dike kah e ki familjen. Na s'e dishim se ai nashta e ka ditë. Na qashtu s'mujshim m'u pajtu. Unë për veti personalisht s'mujsha m'u pajtu që osht' reale që u vra Besniku. Tash shkoj dita, ra terri, pritshim me ardhë këta djemtë, këta të ritë. Këta ma të ri që ishin ose ata të fshatit ose këta nipat tonë të familjes, s'vike kërkush. Tek kur i ra terri tokës erdh Salihi me qat' Avdinë që na tregoj. Tash na deri në mëngjes masi shkoj Salihi t'u shpresu mos po kthehet Selmani.

Motra e Selmanit që u kanë edhe kjo kunata jem, gruja e vet, dy llavora të mëdhej bukë i patën gatu. E gatu j bukë e qiti aty. Thojshin, "Edhe nëse dalim", se qysh tha Salihi, "Nëse del katuni, dilni", thojshin, "Vijnë ushtarët e le të ka bukë për ta". Qashtu fminë i zuni gjumi. Ai djali, se i madhi u kanë në Shqipni, i Selmanit, i dyti Arbëri s'kish kush që e pajton. A din, s'mujke m'u pajtu.

I kish veshë teshat e UÇK-së edhe tash thojke, "Nuk i heki". Ai i ka pasë 14 vjet po armë kem pasë boll për gra e për fmi e për... e kish ni automat, e majke qishtu para durëve edhe para se me shku Salihi naltë p'i thotë kjo gruja e Selmanit, Nexhmia, i tha, "Fol me Arbërin se s'o ka don me hjekë uniformën". Salihi nashta edhe s'mujti kështu m'i thanë edhe, a din, s'i tha kurgja. Ai gjithë ditën të nesërmen derisa jem shku për Shqipni s'e ka hjekë atë uniformë. 14 vjet i ka pasë. Po ju doke vetja qe ka metë përgjegjës për neve.

Tash që nisa me thanë parë, na tanë natën herë dy veta, herë dy veta del deri te kodra e kqyr mos po kthehet Selmani. Se na erdh ni lajm prej ni ushtari, tha, "Kanë nisë m'u tërhjekë anej kah Drelajt". Na thojshim, "Nëse ai veç gjallë osht' nuk e len ja pa na çu fjalë, ja pa ardhë diqysh", edhe thojshim, "Mos po nihet naj kah kodrave t'u thirrë, e qëllojmë bile jashtë te nijmë për me shku m'i dhanë ndihmë". Qashtu erdh mëngjesi, na kush pa vu gjum n'sy, normal të mërzituna si na ma. Na vike zor prej gjyshes shumë, prej nanës. Po ish e pamundur me mshefë dhimbjen brenda vetës.

Kur u ba mëngjes erdhën do burra të katunit, Shaban Balia edhe, tash po harroj edhe kush u kanë, edhe thanë, "Ka vendosë katuni me dalë në shpellë". Osht' ni shpellë në dalje të fshatit kah shkojmë për Hajle e në qet' nifar' venit. Osht' nifar'... edhe fort si shpellë nuk osht', po ni guri ku munësh m'u strehu. Edhe tha, "Me ardhë edhe ju me neve". Tash qysh me dalë na, e kishim nanën plakë që nuk mujshim me lanë. Tash na patëm vendosë mos me dalë. U kanë nifar' qëndrimi i familjes kështu që mos me lëshu shpinë.

U kanë shembull familja e Jasharit, shumë shembull i madh për neve që me qëndru deri në fëmijun e fundit edhe mos me lëshu venin. Po erdhën dy-tri herësh, erdhën qita burrat e fshatit, thanë, "Krejt po

dalën, mos u boni tash ju me i metë peng pastaj juve që nuk janë dalë fshati për shkak të juvin”. Atëherë erdh ni nipash i joni, Rafeti, që ish kanë me tërhjekë familjen e vet me ni zonë shumë të largët. Kur ka ni që ka fillu ofenziva, nuk ish shku m’i marrë hiç prindërit e vet atje, po kish ni që, tash, po duhet m’u tërhjekë fshati e kështu.

Tha, “Krejt katuni po thojnë që duhet me dalë, duhet me dalë edhe ju”. Gruja e Selmanit edhe motra e Selamnit thojshin, “Jo na s’dojmë me dalë, pa ardhë Selmani s’dalim”. Tha, “Jo duhet me dalë”. Tash e bom dert edhe çka me ba puna e gjyshes, qysh mujmë me çu gjyshen. Tha, “Ose e gjejmë ni kalë ose unë gjyshen e marr në shpinë”. Ia prunë ata të katunit dikush ni kalë, e murr’ gjyshen. Unë me dy fmi të vegjël, qito mesat, krejt fëmi. Na qysh me thanë, ma i madhi u kanë nashta s’i ka pasë 17-18 vjet, djalë ose vajzë. Djemtë janë kanë të ri, qita dy djemtë që na metën neve kah 14 vjet. Po vajzat janë kanë pak ma të mëdha.

Shkum në shpellë edhe tash u përshëndeta me Nexhminë edhe po më thotë, “Hajt se bukë ju çojmë na, se unë pa marrë vesh për Selmanin nuk e lëshoj shpinë”. Shkum na atë ditë nejtëm gjithë ditën në shpellë. E kisha zor tepër se nifar’ mënyre u dit që Selmani ma nuk osht’, po e kisha zor prej vjehrrës teme (qan), shumë e kisha zor me paraqitë vetën sikur osht’ gjithçka t’u shku mirë. Se më vetke kaniherë, se djalën e kisha të vogël, a din, e kështu të pshtjellun në pelena. Çikën e patën marrë çikat.

Thojke, “Qysh osht’ ai djalë? Ai ka me u mërdhi”, thojsha, “Mirë”, e kthejsa krytë knej. “A dite gja ma? Kah janë ata, kah o’ Selmani? Kah o’ Salihi?” S’kisha qysh m’i thanë, a din, e kisha zor m’u mshefë. Ma zor e kisha para saj sesa krejt, krejt pjesa tjetër e vështirësive që ish, krejt ish e vështirë. Nejtëm gjithë ditën qaty në shpellë. Në pramje prap janë shku do burra të fshatit edhe iu kanë thanë këtyne dyjave, “Ose me dalë ju ose krejtve po na merrni në qafë”. Nifar’ mënyre i kanë bindë.

Besa ju kanë thanë, “P’e marrim telefonin satelitor, folni me Salihin edhe në qoftëse thotë Salihi me dalë me dalë”. Atëherë fjalë mas fjale nuk p’e di bash mirë. Se kjo kunata kallxon shumë mirë. A ju ka thanë Salihi, “Delni mos i merrni n’qafë katunin, mos t’bohët dikush që për shkak t’jujin me mbetë aty”, nuk p’e di mirë qysh u kanë situata po ishin pa dalë edhe ato. Po ato janë shku te ni shpi e ni fshati tjetër atje, fshat Kushtan, prej qatjehit ku jom une. Kanë nejtë qaty deri n’mëngjes me ditë çka po ndodhë n’mëngjes.

Atë natë granatojke NATO-ja, o’ thojsh ti që po don m’u ça qaty shpella sa shumë u nijshin ato detonime të fuqishme. Ata normal që kishin pa granatu nëpër pika t’forcave serbe që janë kanë nëpër Grykë të Rugovës e kah janë kanë forcat serbe po u nijke shumë, e bijke gryka. Tash prej pramje po vijnë dy kusheri me, normal ata, t’armatosur, pjesëtarë të njesisë aty edhe thanë, se i kish pa çu ni kusheri i jemi, Selezi që osht’ lahutar tash shumë i njohur. I kish pa thanë, ‘Kush del e që shkon i merr fminë e Sali Lajçit e nuk i len m’u mërdhi n’shpellë’.

Ata vijnë, ata dy. Zefë Shabani edhe ai Pajaziti a s'e di cili u kanë. Thanë, "Na kanë thanë me ardhë m'i marrë fminë". Thashë, "Jo s'muj me lanë nanën, qysh me lanë grun plakë". "Qe janë mesat e çikat, e janë këta dy djemtë", 14 vjeç që ishin njani i Selmanit njani nipash, "me shku atje gjithqysh". Thashë, "Nanë qishtu po m'thojnë". "O", tha, "shko se", tha, "na qit' djalë mezi kem pritë me pa, e qiky bile mos t'mërdhiet". Se ish tepër ftoft aty, shpellë ma. E dhezshin do zjerm, ni grim zjerm e dhezshin n'fillim të shpellës, ni grimë në fund. Kërkush s'kish shansë aty me përjetu t'nxehetit.

Shkova unë me ata atë natë, t'nesrit filloj me ra borë. O' sa bora. Bile m'u bojke shtresa e borës, djaln që e kisha n'gryk kështu m'u bojke shtresa e borës kah qikaq {shpjegon me duar afër 10 cm}. Si duket ju lagën teshat. Se ai fëmi i shëndetshëm u kanë për gjashtë muj, s'ka pasë... u ftof. T'nesërmen na thanë me shku për Rozhajë. Mrrim na atë ditë gjithë ditën t'u ecë nëpër male, borës, përpetë. Ma vështirë ish me ecë, a din, borës se kumeditë çka.

Ata kish do burra që e çelshin rrugën po ni anë ish, nanën këta e bajshin kah dy kah dy, qita ushtarët, qiky nipi e djali mixhës, u ndroreshin me do ushtarë tjerë. Fmija ishin t'ranë. Edhe do tesha na u pa deshtë m'i marrë. Çika e Selmanit e vogla, s'kish kush e nalë. Kajke, kajke, kajke, kajke. Derisa ma kur dul me nifar' qafe aty që thojmë Qafa e Dromodolit, thamë, që diq. Ju nal fryma. Edhe fryma që fryke, bora që bijke edhe ajo prej vajit që s'mujke hiç m'u nalë, thamë, edhe kjo shkoj e hajt.

Po dikur na ra me ecë teposhtëze nifar' vendi, nifar' teposhtëze e thellë. Na krejt çka u bom, edhe t'ni katuni tjetër do banor po nuk janë kanë fort shumë ashtu banor po qata që janë kanë. Ramë në Bugjov dikur po ajo teposhtëze ish e vështirë se rrshitshim rrugës, ish drojë m'u rrzu vet edhe kur rrzohemi me ia thy qafën fmive. Po qisi rini që e kem, na merrshin kaniherë fminë, kaniherë çantat, diqysh e kalum ata. Kur ramë në Bugjov, qita familja e Ujkan Nikçit dolën goxha larg ato gratë me na pritë. Tona t'mërzituna. S'e dishin tash cila familje p'e din për ata t'vran, cila familje s'pe di.

Ishin edhe këto dy gra, njanës ju kish vra djali e njanit burri dhe nana. Ato bile u patën kujdesë shumë për nanën e Salihit, për gjyshën, për vjehrrën. T'mërzitne për veti që thuhet. Atëherë na aty veç nejtëm pak, sa m'i ndrru çorapët e ni grimë ça na ofrun bukë, s'po m'kujtohet bash mirë. Na pritën si mujtën ma mirë ata po na s'e kishim qëllimin me nejt. Atëherë prej atyhit na me shku në Rozhajë në xhami, ku janë krejt. Krejt refugjatët qaty ku shkojshin. Unë i kisha dajhtë në Bralaj, po nuk ke mundësi ma me shku te dajhtë, se ata ishin t'përcjellun për veti.

Shkum, a din, rrugës atje për Rozhajë, n'kamë na. Erdh ni njeri aty i katunit tonë edhe tha, "Qito gratë me fëmi edhe këta", domethonë qita që e kishin dikond t'vran, na murr nja dy-tri familje që kishim t'vran me shku me ni automjet, me ni kombi me shku deri në Rozhajë. Hym na qaty, u ngushtum qysh mujtëm. Ndalje t'katunit na nalin ushtria jugosllave. Tash qiky nipi që e pat' qit' gjyshen n'shpinë thuja, e kish djaln e Selmanit t'voglin n'krah. Po ai kish edhe armë me veti. Tash puna mos me nxan me armë, me djalë n'krah hini n'mal, a din, për m'i hjekë ato armët. Na t'u prit kur te vrainë ata. Na u ba tutë, a po na pshton tash ai edhe djali vogël që ish.

Po kjo ushtri jugosllave po, po nuk ishin kanë kështu prej kësaj pjesës të ushtrisë që ku t'zajnë t'vrajnë. Ata thjeshtë t'nalshin, të identifikojshin, si popullatë civile të lëshojshin. Atëherë sa e kalum qat' post ai u pshtjellua diqysh nëpër mal edhe dul n'rrugë prapë, ata s'e panë edhe na erdh zemra neve në ven. Tash sa i kalum ata, posta policore tjetra. Ata e kishin nalë ni ushtarë të UÇK-së. Ai me numër të telefonit... janë kanë numrat satelitor me 15 numra ose me mbi 15 numra s'po më kujtohet tash, po me shumë numra janë kanë.

Ai ni numër satelitor, t'ushtrisë ma, me veti. E pytshin për qat' numrin satelitor, ai diçka ju munojke me ju thanë që e ka të dikujt të vetin. Po nejse, ata e patën nalë po neve na lëshun. Ata edhe dikond, nja dy-tre vet qaty i kanë nalë, qajo posta. E neve na lshun. Kur shkum në Rozhajë dikur... te ni familje boshnjake pak ni kohë kem pushu që na kanë ofru qështu ni strehim t'përkohshëm. Atëherë në xhami nja katër ditë. Erdhën këta pjesa e familjes teme, djali i mixhës tem që ish te dajhtë atje t'u nejtë.

Tepër edhe ai i mërzitun. Dojke me na marrë po edhe ata e kishin ndërmend me dalë prej atyhit e s'kish qysh me na marrë. Unë shumë e vendosun mos m'u nda prej popullatës civile. Krejt kah t'janë shumica e popullsisë edhe na. Atëherë thanë që janë autobusat e gatshëm që ju çojnë për Shqipni. Prej xhamisë qaty, n'kushte mizerje, si n'xhami. E keni pasë rastin nashti m'i pa filmimet ndonjëherë qysh janë kanë kushtet në xhami në Rozhajë. Aty dikur morëm vesh që Xhaviti që u kanë i plagosur nuk ka pasë metë n'vend, e qaty morëm vesh që kish dekë n'spital. U mërzitën edhe familja e tij e krejt na kush e njifshim. E mërzi mas mërzi.

Atëherë rrugës kah shkum prap patëm dëgju që këta kanë nisë m'i çu t'burgosurit për Shqipni bjeshkëve këtu kah Hani i Magjupit që i thojnë ktyne bjeshkëve t'nalta knena. Kah Bjeshkët e Nemuna që osht' kjo rruga, kah shtegu i armëve. Po janë vra edhe disa ushtarë. Tash aty dikush ish djalë hastreti, dikush ish dy vllazën, dikush ish që sa ju ka vra dikush n'front. Ish nifar' stresi, nifar' mërzi, po qashtu çka kishe me ba. Na me qita fëmi e me pleq e qysh ishim qashtu mrrijmë në Shqipni.

Na dikur nuk dojshim m'u vendosë në Shkodër kah u vendosshin krejt, kah Hani i Hotit anej. Po erdh motra e Salihit që u kanë në Shqipni me ni dajë tina, Shaban Shkrelin osht' pilot, erdhën na morën aty në kufi e na çun në Krujë. Atëherë ajo periudha e Krujës ma. Selmani u pa varros në Rugovë. Salihi e dishim që ka metë në Rugovë me ni grup shumë të vogël të ushtarëve, po i plagosun, i kish hala plagët e pa shërune. Mërzi e madhe, veç qashtu. Atje, ata të Shqipërisë na kanë pritë, ma mirë nuk ka qysh.

Domethonë na jem kanë te Sahat Kacanja, ni, ni burrë, ni familje e Shqipërisë, ai ka dekë tash. Po jem gjithmonë falënderues për familje të tina. Nuk kem pasë shumë rast m'i pa gjatë luftës, ni vizitë e ka bo djali te familja e tij po kem komuniku kaniherë. Po tepër, tepër na kanë pritë mirë. Domethonë ndoshta shpesh herë e kom menu me na u pasë dhanë neve rasti, m'i ndihmu ata a kishim mujtë m'i pritë qysh na kanë pritë ata neve. Qaty kem nejtë derisa u shliku Kosova. Masanej jem kthye.

Domethonë, nuk kishim fort mundësi as m'i përcjellë lajmet, se as na në Rugovë, qaty n'familje s'kem pasë, veç ni radio ku i dëgjojmë kaniherë Kosovën e Lirë po u dufke me dalë ni vend ku kish valë, shumë larg diku me dalë. Ose këta kur vishin prej shtabit që na tregojshin kaniherë. Po nuk osht' që ishim shumë mirë të informum çka osht' t'u ndodhë. Unë për familjen tem asni fjalë nuk e disha. Qajo motra që e kom në Zvicërr burri i saj kur folke kaniherë me Salihin, për ata t'jashtës e disha që ata edhe ishin jashtë, nuk osht' që kisha brengë.

Po nanën e motrën që i kom pasë ktu n'zonë t'luftës edhe dy motra t'mdha me familje t'tyne po ashtu në zona t'luftës nuk disha kurgjo për ta. Kaniherë kur nijsim çka s'ndodhke për përdhunime për të gjitha këto tjerat. Qaq u kanë atmosferë brenda vetës e zyrtë e shpirtnisht je kanë e ngushtune gjithmonë. Po dikur masi dulëm në Shqipni kish mundësi pak ma mirë m'u informu derisa dikur morëm vesh që u nënshkru marrëveshja për daljen e forcave serbe prej Kosove edhe vendosëm për m'u kthy.

Pjesa e gjashtë

Anita Susuri: Qysh e gjetët pastaj vendin? Qysh u ribashkut me bashkëshortin?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Atë ditë që e kom pa për herë t'parë Salihin masi jom taku mas lufte, patëm ni që nuk u djegë shpija e qityne nipave, qasaj motrës t'vogël të Salihit, Pembës. Shkum aty niherë ma së pari. Salih kish marrë vesh që jom ardhë edhe erdh aty. Mërzi e madhe kur jom taku. Ma së pari (qan) po veç tha, "Pushoni pini kah ni gotë ujë na duhet me shku n'shpi". Ku me ardhë n'shpi? Shpija rrafsh me tokë. Po nuk ish ajo që ish djegë shpija, ish djegë gjithçka çka kem pasë kujtimet e dokumentat e librat e jeta në përgjithësi ish ba rrafsh me tokë. Po ish qëllimi m'u kthy na në shpi tonë.

Ni arrë e kem pasë në oborr. Rrënojat e shpisë normal, qato muret kishin metë edhe ni pjesë e depos ish metë pa djegë. Ajo pjesa e bibliotekës që e kem pasë plot me libra ni dhomë, librat ishin djegë krejt edhe dyshemeja që u kanë e drunit ish djegë po deri n'gjysë. Ni pjesë ish konë metë dru qashtu. Na tham, 'Qito, qito'. Na prunë ni çadër që bishin ndihma gjatë luftës. Çadrën e qitëm n'oborr, qaty, qysh me thanë e ngrehëm t'pamën për Selmanin. T'pane nuk ngrehëm, po njerëzit vishin me na ngushëllu. Thuajse nja ni vit kanë ardhë, pa da.

N'qato gjysa t'dhomave krejt zi prej timit, u munum m'i la s'u lajke ajo, zhigu s'po lajke hiç. Në qat' pjesë të depos... dikush prej familjarëve ose prej njerëzve t'rrethit kush, kush ka pasë nashti pak ma shumë mundësi se na... se na t'zhvendosun prej ktuhit në Rugovë, këtu rrafsh me tokë, në Rugovë krejt çka kem pasë rrafsh me tokë. Na në Shqipni veç qato tesha fmive, se tjetër gja s'kem pasë me veti. Pak dikush naj shpuzë, dikush ni diçka filloj jeta prej fillimit. Qishtu.

Atëherë kulmi i parë në Pejë që u vu, ju ka vu dikuj me ndihma ndërkombëtarëve sigurisht osht' vu kulmi i shpisë tonë, për nderë të emrit të Selmanit. E kanë vu në mënyrë simbolike kështu. Qashtu ka fillu kah pak kah pak jeta. Po u smu nana atëherë nga gjashtë muaj ajo e smutë me kancer. U smu valla se deri në rivotrim u majt shumë. Po këta rivotrimi i dëshmorëve u ba nga domethonë ata janë vra me 19 prill, rivotrimi i ba me 29 gusht. Sa po i bjen? Prill, qershor, korrik, gusht, nga katër muaj a sa po i bjen, gati.

I kish pasë thanë Salihit, "Unë dalë në vorrim veç me një kusht, veç nëse ma çelin Selmanin me pa", edhe ky ia jep besën, thotë, "Ka me ta çelë". Tash aty ku u ofrum, a din, ia çeli pak. Po çka m'i çelë, njeri në rivotrim. U mërzi si duket shumë. T'nesërmën tha (qan)... niherë ma që e kom pa t'u mërzi tha, "Edhe unë jom nanë", a din, se u majke u majke. Bile kush u mërzi për para saj thojke, "Qysh s'po ju vjen marre prej meje". E ka pasë kështu këtë fjalorin e vjetër, këtë gegnishtën, thojke, "S'po ju vjen mbarre prej meje, unë jom nanë".

Po aty u mërzi edhe si duket qatë t'u majtë n'veti, t'u majtë n'veti s'mujti ma me përballu. Mas vdekjes t'nanës qishte ka vazhdu dikur jeta. T'u u munu. Kapak, kapak, kapak. U shtu familja. U lind djali jem i pari Urani mas lufte masanej vajza. Qishte...

Anita Susuri: Keni përfunduar edhe fakultetin pastaj?

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po, fakultetin pastaj e kom përfunduar. Gjatë luftës Selmani gjithmonë m'bijke libra. E ka pasë një baxhanak në Shkrel që kish libra edhe një në Drelaj. Se familja jem dikur janë konë pasë zhvendosë në familje të dajve e nana motra janë kthyer. Se qatë në Kushton i kom pasë afër, nuk i kom pasë larg. Po nuk osht' që ish me pasë libra. Thojke, "Mëso se e ki një provim". Thojsha, "Aii Selman, kush mson ma, çfarë provimi". Thojke, "Mëso mëso", thojke, "se lufta kryhet, duhet me krye fakultetin".

M'shtike kaniherë me lexua. Po thojsha, kur shkojke ai dikur i thojsha Nexhmisë, "Po çfarë të msuni, po çfarë të msuni le të kryhet lufta", thojsha, "se ka kohë, mësoj mas lufte". Dikur për besë kaniherë edhe motiv e kom pasë edhe për hatër të tij se n'luftë u interesojke me m'gjetë libra me msu, a din, me lexu e m'i kry. Po mas lufte me literaturë m'ka ndihmu Zymer Neziri shumë. Krejt librat që m'u kanë dashtë m'i ka prurë prej Prishtinës e kado që i ka pasë. N'temë domethonë krejt çka kom pasë nevojë për literaturë m'i ka ofru.

Nuk vonova shumë e kreu fakultetin. Atëherë m'u dha rasti me punu meniherë mas lufte. Salih u kanë profesor para se me dalë n'luftë. Ka punu profesor i inxhinierisë të maqinerisë në Shkollë Teknike. Prej atyhit e ka lanë ditarin e ka kapë pushkën. Atëherë kur përfundoj lufta, ata kolegët e tij e lutën m'u kthyer edhe niherë. I thanë, "Hajde, hajde osht' nderë për neve me na ardhë prej frontit, prej malit", kështu qysh u shprehshin atëherë. Po tha, "Jo, unë me ushtri e kom nisë tash, du me metë në TMK". U organizu përmes TMK-së edhe dhjetë vjet deri në pensionim të parakohshëm qysh kanë dalë këta.

Dikur masanena pas TMK-së prap ka vazhdu në Shkollë Teknike po për qat' vit du me tregu mas lufte. Dikur i kishin thanë, "Nëse gruja jote ka diplomën, lirisht për hatër që ti ke dalë prej qisaj shkolle e ke kapë pushkën le të vjen". Atëherë mas lufte nuk e di edhe mirë qysh ka shku puna, se nuk ka pasë konkurse, s'po di. Veç kryesorja unë kom shku kom punu qaty në Shkollë Teknike ni vit.

Atëherë normal kur kom hi në proces kom pasë mundësi me punu. Atëherë ni vit veç kom punu atje, dikur kom punu me klasë të nanta qitu në Shkollë Ekonomike, e kom afër. Masanej jom aty prej atëherë, domethonë, punoj qitu me nxanës të shkollës të mesme në shkollë profesionale. Jepi landën gjuhë shqipe, nashta e thashë n'fillim të intervistës, nuk po di a e thashë.

Anita Susuri: Zonja Zyrafete, ju kisha falënderu! Nëse s'keni edhe diçka me shtu për fund...

Zyrafete Muriqi Lajçi: Po m'duket që e kom harru ni detaj, s'osht' fort detaj po ni aspekt të veprimtarisë që menoj që meriton m'u përmend, viteve '90-ta. Tash në kuadër të Pajtimit të Gjaqeve, u munova me përmbledhë me pak fjalë po, po thom, në kuadër të qasaj degës të Rugovës nuk osht' që jom kanë naj figurë e dallune se aty jom kanë, si me thanë, për me përkrah lëvizjen edhe me dhanë atë aspektin që edhe vajzat e sidomos t'burgosurat politike janë t'u dhanë kontribut në këta.

Bile dikur vonë e kom lexu që e kisha pasë shkru diku që e kom citu kur ka thanë Salihi në odë aty, "Na me qito motra tona", motra krejt aty s'jem kanë se dikur jem martu po nejse (qeshë), "jem kanë bashkë para tankseve, para gjykatësve, para prokurorëve, me këto deri në lirinë e Kosovës kemi me kanë qishtu bashkë. Njëpër oda, njëpër tubime, kudo që t'na qet' puna". Po tash aty po du me thanë u kanë Zymer Neziri e para tina bile na t'ritë edhe unë me thanë t'drejtën edhe me m'u drejtu me folë, m'vijke marre, pritojsa. Se thojsha, me folë para personalitetit që osht' i thirrun për atë punë.

Ni aspekt që nuk e përmenda osht' qikjo për me qujtë aksion për mbledhjen e nënshkrimeve për Republikën e Kosovës, muj me qujtë nashta aksion. Këto kishin pasë marrë vendim, Salihi, Selmani, Zymer Neziri... unë mora vesh dikur ma vonë ose erdh Salihi t'nesrit me më marrë, nuk p'e di bash mirë qysh u kanë puna, kom harru. Tha, jo, e kishim na me dalë, ish shënimi i përvjetorit të arsimimit të Rugovës me 20 maj në Haxhaj. Në këto tubime publike dilshim. Dilsha unë me vlla e me motër, me motra, me djem t'axhës, dilshim krejt.

Ata e kanë pasë atë pjesën artistike ku ishin të programit me knu e me fyll e me, motra me çifteli e kështu po dilshim. Tash me ndodhë ni ngjarje në Rugovë e p'e çun vetën si veprimtare e s'po del, nuk ish normale. Tash rrugës t'u shku u takum me Salihin. Më doket nashta jom ardhë unë në shpi, se s'pe kom shumë qet' pjesë m'u ka fshi, nuk p'e kom bash t'qartë. Tha, "Kemi me lexu ni kërkesë për Republikën e Kosovës, kem vendosë", "Ku?" "N'tubim", thashë, "Ani mirë, me lexu une".

Kështu në aspektin shok shoqe me Salihin, kurrë fjalën s'ia kom kthy. Ai bon hajgare thotë, “Tash shefi vetët”. Po kështu si veprimtarë që jem kanë, çka ka thanë Salih fjala e tij për mu u kanë ligj. “Me shku në Zvicërr për armë”, jom shku. Fjala e tij ligj. “Me shku në Shqipni për me hulumtu terrenin me pru armë”, jom shku. Bile as nuk i kom bo dy, ni mëdyshje nuk e kom pasë. Edhe pse me mend t'sotit kurrë nuk isha shku. Me shku, mos me ditë familja nëpër teren aq të ashpër, nëpër mal, nëpër kufij që i run ushtria jugosllave, kurrë s'isha shku. A din, n'qit' aspekt po thom.

Po atëherë jom kanë e re edhe veprimtare si unë si ai, çka kom unë pse nuk shkoj. Jom kanë shumë e bindur, çka ka ni vajzë që nuk vepron njësoj si ni burrë. Po sot nuk e kom qat' mendim, janë pak ma të ndame puntë, a p'e din. Tha qishtu për me lexu ata, thashë, mirë me lexu me lexu. Po nuk e bom kështu bash plan kush me lexu e qysh. Tha... as n'fund të tubimit as në fillim të tubimit. Tash u majt ai tubimi, u folën ato fjalët e zakonshme që folen për përvjetor. Arsimimi i Rugovës i rëndësishëm e të tjera e të tjera. Për çdo vit osht' shënu kjo si ngjarje.

Se me të vërtetë u kanë shumë i rëndësishëm përvjetori i rëndësishëm. Se u kanë ni zonë që u kanë që s'dojnë m'i majtë shkollat e hapuna për shkak të kushteve në përgjithësi. Edhe për shkak të presionit të pushtetit po edhe kushteve tjera që janë kanë edhe gjeografike edhe të motit, që janë kanë dimrat e vështirë atëherë e krejt. Po tash u mbajt tubimi, po m'doket, nëse unë nuk e kom harru qata u dashtë me lexu Isë Nikçi, qat' letër. Qat' letrën çarkore që e kishin pasë qujtë këta. Bile m'doket vet Isa ia ka dhanë, Isë Nikçi u kanë kryetar i Lidhjes Demokratike të Rugovës në atë kohë. I burgosun politik.

U kry tubimi krejt, tash ai udhëheqësi i tubimit po don me mbyllë tubimin. Salih tash pak a din, u revoltu kështu mrena vetit, qysh me mbyllë tubimin. Ama për me shkru po m'thotë Selmani, “Shkruje ti me dorë tane se Salih e ka shkrimin e keq. Bile kushdo që e lexon le t'munët me lexu”. Unë e shkrova me dorë temën po nuk e patëm bisedu kush me lexua. Tash ai po don me mbyllë tubimin, “Mirë u pafshim në tubimin e ardhshëm”, e kështu.

Salih po del prej tubimit tap, tap, tap {onomatope} tha, “M'falni e kem edhe ni çështje”, tha, “prej këtij tubimi kemi me ba kërkesë Kuvendit të Kosovës që me ba publike kërkesën për Republikën e Kosovës”, qishtu me qito fjalë. Tha, “Kërkesën do ta lexoj Zyrafete Muriqi”. Tash unë e kisha të shkruje se unë e kisha në dorë atë letrën. Po dalë. Prit, prit t'u kqyrë a mos o' Isa a dikush a mos po e lexon dikush tjetër. Po kur ma thirri emrin tamon dola. Po e lexoj ata. U ba aty ni duartrokitje se njerëzit diqysh u gëzun.

Kërkesa Kosova Republikë po thuhet haptas nuk ka ma barriera. Meniherë i qitën do fleta të bardha, nisën njerëzit m'u nënshkru. Po tash ish çështja masi u nënshkru edhe u ba prej tubimit të hapur çka me ba me atë kërkesë. U nënshkru, çka? Me lanë në arkivë a? Jo, me ia çu Kuvendit të Kosovës. Nejse Kuvendit të Kosovës iu kemi drejtu. A me çu, ish puna në media me lexu mediat a me ia çu drejtpërdrejtë. E vendosëm për media po se po, po në kuvend gjithqysh.

E qitëm ata në zarf, e fotokopjum, i bom nënshkrimet përfundi edhe e vendosëm të nesërmen me çu në Prishtinë. Shkum unë, Salihi, Naser Salihi edhe e çum në Kuvend të Kosovës. Po tash dojshim me ditë kond e kem dikond të besushëm që na tregon realisht a po e protokolojnë. Se ti majshe me çu, ata me shky me qit' në shportë. Po tash kush osht' dikush aty mrena Kuvendit që osht' edhe ma atdhetar po edhe që na mujmë m'i besu që nuk na mashtron që nuk e zhdukin atë kërkesën.

[Adem Mikullovc](#) u kanë atëherë një prej deputetëve që ka pasë kështu ni za të fuqishëm popullor në parlament. Thamë, "Dojna me iu drejtu Adem Mikullovcit". Po atë ditë nuk mujtëm me taku. Ose nashti e kem taku masi e kem dorëzu. Masi e kem dorëzu edhe i kem tregu që e kem dorëzu në parlament. Na ka thanë, "Njo në parlament, njo e dërgoni me postë që mos me mujtë ata me ikë qitij fakti që mos me protokolu edhe njo ma dërgoni mua". Na qashtu ia bam, qysh tha ai.

Kur erdhëm na në Pejë, kish pasë marrë hov kjo dëshira e njerëzve për m'u nënshkru sa na nuk kishim ma formular. Na nuk i patëm ata as formular, shkrimi i dorës fleta të bardha të nënshkrune me laps. Dikur na ofroj mundësinë dikush me i fotokopju. E shkrujti me shkrim të maqinës, e pave ti ata, atë letrën qarkore, edhe m'i fotokopju. Po më doket te Hetem Çeku i kem fotokopju me qindra mijëra atëherë. Veç në "Zastav" tregojke vëllau jem që u angazhu masanej për me i ba qito nënshkrime nja 1000 nënshkrime mrena ni dite a dy dite janë grumbullu.

Kur u banë shumë nënshkrime tash na nisëm me ni përgjegjësinë. Tash ti i ki emrat e njerëzve aty, mos po burgoset dikush edhe me ni vetën fajtor dikur edhe s'din me mbrojtë çështjen. Se ai që burgoset e burgosin, ia jepin dy-tri shuplaka ata u rrehshin për çdo ditë pa kurgjo. Po me mbrojtë, me mbrojtë aksionin, me mbrojtë çështjen. Tham, "Tash duhet me shtri si aksion". Bisedum edhe me këta të Pajtimit të Gjaqeve, Havën e Hetem Çekun e [Adem Grabovcin](#) edhe këta edhe nisëm m'i kriju grupet e punës.

Tash unë, Salihi, Avdi Shkreli, Sehadete Kelmendi u bam ni grup i punës. Me ni veturë të Avdi Shkrelit që deri në fund të aksionit asni moment nuk jemi ndalë. Po këtu te shpija baza u kanë. Se thashë që u kanë shpija jonë bazë. U kanë Selmani edhe me ua dhanë ato letren qarkore formularët po problemi kryesor u kanë ato të plotësunset kur i merr ku m'i lanë. Domethonë ai m'i marrë ato, m'i siguru, me i çu në vende të sigurta edhe m'i caktu njerëzit kush kah me shku, kush me kond me bisedu e kështu.

Na dy u munum me shtri rrjetin përmes të burgosurve politik edhe shumë patëm sukses. Domethonë e patëm organizu ni mbledhje në banesë të Selmanit në Prishtinë. Ka banu në banesë të Bajram Kelmendit. E ka pasë banesën me qira po te shpija e Bajram Kelmendit ni shtëpi e vogël u kanë aty, nuk e di u kanë pronësi të atij a të kujt po aty afër. E organizum na ni mbledhje me të burgosun politik e që deshta me thanë parë që thashë, jo gjithë të burgosurit politik janë kanë anëtarë të lëvizjes. Po kush ish anëtarë i lëvizjes aq ma mirë, kush nuk ish edhe ashtu mirë se kish rreth.

Patën ardhë Ramadan Avdiu e Ismet Kryeziu ose qysh e ka pasë emrin Kryeziu i Prizrenit. Halil Koliçi e, Çadraku, Dervish Çadraku. S'e di a u kanë në qat' mbledhje se tash mos t'i përzij se m'i përmend emrat e mos me kanë i sigurt po e shtrijmë rrethin na qishte përmes të burgosurve politik. Atëherë edhe me këto çikat përmes tjerave të burgosurve politike dikush ish liru dikush s'ish liru po edhe në familje të tyne. Na patëm shku në familje të Nazifes Xhemajli që kisha nejtë me Nazifën në burg e Salihi i njihke kështu si emra Bajrushin e Mustafën e Emrushin e këta. Patëm shku pa kanë asnjani prej atyne aty.

Nana e tyne u kanë, vllaznit ma të ri shumë. Ia patëm dërgu këto formularët edhe pas do ditëve pastaj patëm shku m'i marrë. Që thashë Këshilli i Rrethit të Pejës i lëvizjes me Agim Elshanin disa prej atyne udhëtimeve me nënshkrime i kem ba. Masanej me këta të burgosurit politik që kanë nejtë, këta djemtë e pavarësisë me Mustafën, Islam Mustafën nipash i Jusuf Gërvallës në Glllogjan e. Te Isa Dërmaku jom kanë në Kamenicë e te Hafidja e te Naseri në Kaçanik e. Nëpër plot vende në Gjilan edhe dikah jom kanë e po tash kom nisë m'i harru emrat.

Po kem bashkëpunu edhe qaq u kanë i frytshëm si aksion sa që ma rrezikun nisëm mos me përfillë. Domethonë kah pak i mshefshim në veturë, a din, kur i merrshim. Se kështu edhe me na nxon formularët e shprazët nuk e kishim dert. Po kur i merrshim të plotësuar e kishim nifar' përgjegjësie mos po i burgosim njerëzit. I mshefshim kah pak po edhe u bom njo, deri në përfundim të aksionit. Kur u bom goxha ni numër i madh nënshkrimeve patëm vendosë me shku me bisedu me personalitete. Me Rexhep Qosjen, me Adem Demaçin.

I patëm çu fjalë edhe Ibrahim Rugovës, atëherë si figurë e LDK-së që u kanë i adhurun prej popullit në Kosovë. Me informu saktësisht kush jemi na që e kemi, e kemi nisë qit' aksion. Mos me na paragjyku. I patëm dërgu fjalë përmes ni gazetari që na e kishim edhe kështu të njofshëm edhe shok. Mixha i qisaj vajzës që u kanë në aksion me neve, Sehadete Kelmendit. I patëm thanë, "A munësh me informu paraprakisht çka osht' t'u ndodhë me qit' aksion edhe me ia bo pytjen publikisht në konferencë për media që a je i informun çka osht' t'u ndodhë me qit' referendum që osht' t'u ndodhë me nënshkrime të hapura për Republikën e Kosovës".

Ai e ka pytë, osht' bile edhe gazeta, e ka rujtë osht' e rujtne kështu si shkrim. Ka thanë, "Na si Lidhje Demokratike e Kosovës nuk qëndrojmë, por i përkrahim të gjitha iniciativat pas të cilave qëndron populli". Te Qosja kur shkum, megjithëse te Qosja unë nuk jom kanë, u kanë po më doket motra jem edhe këta kush janë kanë. Po Qosja ju ka thanë, "Shumë mirë, e keni fillu aksionin kjo osht' shumë mirë. Por kur t'i boni 100 mijë nënshkrime merrni tavolinat edhe delni në qendër të Prishtinës edhe le të nënshkruhen njerëzit shlrë. Se atëherë kjo e ka bo të vetën e ka arritë efektin që u dashtë me arritë. Pastaj ato nënshkrime duhet m'i përdorë si mjet demokratik në diplomaci. Se osht' njo ndër mjetet ma demokratike për kërkesën e ni populli".

Te Adem Demaçi shkum. Te Adem Demaçi jom kanë unë, Salihi, Isa Nikçi edhe Agim Elshani dhe Avdi Shkreli. Ademi tha, Baci Adem, respekt shumë. Tha, "Qyre", tha, "shumë mirë, kjo osht' e mirë shumë.

Po a e din, kush t'u ka nënshkru i pari n'listë?" "Zymer Neziri", "A e din more që shkojnë ta burgosin Zymer Nezirin, çka do me thanë ti masanej? Po masi e paske nisë, e paske vullnet punoni sa të muni mos u nalni. Po duhet me marrë parasysh kond e keni aty t'u u nënshkru mos me marrë", jo m'i marrë në qafë njerëzit në atë kuptim, "duhet me kanë të përgjegjshëm nëse veproni me dikond për me rujtë edhe ata me të cilin keni vepru".

Kur u bonë ma shumë se 400 mijë nënshkrime vendosëm pastaj m'i dërgu përnime atje ku munët m'u pa ni hajër prej tyne. Normal edhe në bisedë vazhdimisht me Zymer Nezirin, Ali Muriqin e me këta intelektualët e Shoqatës së Intelektualëve të Rugovës. Patëm vendosë m'i çu në Shoqatën Migjeni në Slloveni edhe i mushëm paketat. Bile janë kanë të rana si me bajtë bomba. Isha nashta t'u e shpjegu qysh i kem çu qato nënshkrime në Slloveni edhe rruga deri në Slloveni u kanë boll me rrezik. Na i kem dërgu me tren, me veturë na ka përcjellë deri në stacion të trenit Avdi Shkreli. Prej aty e kem marrë qat' paketën e ranë e jem hi në tren.

Treni ekspres që shkojke për Slloveni në atë kohë. Po u kanë tollovi e madhe. U kanë tepër problem edhe me gjetë vend se u kanë problem edhe me peshu ata. T'ranë për me qit' deri dikund. Atëherë ulë unë në paketë deri në Slloveni për merak. Se s'kishe ku m'u ulë në ulse. Ose në plato ose në paketë. Bile më kujtohet qitu ni rast në Beograd dul Salih me ble diçka me pi, ni gotë ujë a diçka e treni u nis. Mu m'kapi tash frika që u nis treni, çka me bo tash unë vetëm me nënshkrime. Po fati ky ka vrapu e ka hy në tren. Kur e kom pa që ka hy, bota e jeme u ba. Se thojsha ka shkoj unë, nuk i disha venet.

Na e kishim qëllimin me pushu niherë te ni dajë i Salihit që u kanë pilot në Brezice. Prej atyhit me shku pastaj në Lublanë. Se ish e pamundur me shku ndryshe se qashtu ishin lidhjet. Edhe qashtu ndodhi. Domethonë na pushum ni natë aty te ai atëherë na përcjelli ai me veturë deri në Lublanë. Aty shkum në shoqatë. Aty gjetëm Ukshin Hotin me, u kanë, tash për mos me ju hi në hak u kanë Rexhep Hoti edhe Halil Koliçi që janë aty me to. Bisedum gjatë me to, na boni muhabet edhe na kthej bukë. Na përcjellën prap deri në stacion të autobusave m'u kthy na për Kosovë edhe u kthym shnosh e mirë.

Rreziku u kanë boll i madh po aty dikur pjesa e Salihit osht' çka ka bisedu ai me Ukshin Hotin e qysh u marrë qëndrimi ato m'i dërgu jashtë gjithqysh e, cila osht' rëndësia e tyne përderisa janë emrat e gjithë atyne njerëzve të Kosovës që e kanë vu firmën e tyne aty. Ajo pjesë masanej mbetet edhe me studiu me hulumtu edhe me sqaru ma mirë. Domethonë qikjo pak që m'u dokë pare që e lash nashta si aksion që meriton m'u përmend e që nuk e pata përmend.

Anita Susuri: Faleminderit shumë dhe njëherë edhe ju kisha falënderu për intervistën, për kohën që keni gjetë!

Zyrafete Muriqi Lajçi: Faleminderit prej juve shumë! Puna juve shumë ka rëndësi në dokumentimin e historive edhe t'imta të njerëzve të Kosovës të cilët kanë ndihmu për me pru lirinë.